ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 2 TETOR 2021. NUMËR 150 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Romancierja më e fshehtë e botës shkëmben letra me artisten më publike të botës

KAM SHUMË PYETJE PËR TY

Elena Ferrante bisedon me Marina Abramović

FT Weekend Magazine ka ftuar romancieren italiane me identitet të fshehtë, Elena Ferrante, një fanse prej kohësh e veprës së artistes performuese Marina Abramović, për të diskutuar mbi artin, shkrimësinë dhe shumëçka. Ferrante ruan me kujdes anonimatin e saj, kështu që biseda është zhvilluar në një seri e-mailesh.

SHËNIME PËR LIBRAT

"PARAKALIMI"- NJË FRAGMENT DRAME E ANTON PASHKUT

Nga Behar Gjoka (fq. 6)

Trashëgimia letrare e dramatikës së Anton Pashkut, përfshin edhe fragmentin e dramës "Parakalimi", një tekst relativisht i shkurtër, krahasimisht me dy tekstet e tjera të autorit.

Shënime për "Lamtumirë Gabo dhe Mercedes"

MARQUEZ PËRBALLË MARQUEZ

Nga Arta Marku (fq. 20)

Rodrigo Garcia, njëri prej djemve të shkrimtarit, shkruan skenarë, por është kaq e natyrshme që kësaj here t'i kushtohet një tjetër lloj rrëfimi, që e vë birin përballë atit. Një rrëfim i nevojshëm, i domosdoshëm.

Në "Princi i gjurulldisë" i Endri Vajella

KOHA LETRARE DHE KOHA HISTORIKE, NË NJË NOVELË

Nga Namir Lapardhaja (fq. 10)

MEDITIM PËR VATH KORESHIN

Nga Olta Gaçe (fq. 13)

KAFJA E FUNDIT ME PJETËR ARBNORIN

Nga Uran Butka

Një ditë para se të shkonte nga kjo botë, Pjetër Arbnori më mori në telefon. Pimë një kafe, më pyeti. Te Kullat. Mirë, i thashë dhe u nisa.

(fq. 7)

Luan Starova e të tjerë romancierë

Kujtimet burimore – mjet çlirimi dhe individualizmi krijues

Nga Virion Graçi (fq. 4)

Luan Starova është tipik romancier i shkrimit autobiografik. Në letërsinë shqipe është vështirë t'i gjesh një të ngjashëm për nga prurjet dhe cilësia në këtë lloj shkrimi, prandaj do ta vendosim në shoqërinë e shkrimtarëve Margerit Dyras, Albert Kamy, Zhan Pol-Sartr, autorë të pranishëm e me ndikim në sistemin tonë letrar...

DALLGA E MADHE NË KANAGAWA:

Mona Liza e Japonisë

Dr. Bledar Kurti (fq. 18)

TEDDY BEARS

Ese nga John Green (fq. 17)

Shkrimtarja kroate

MAŠA KOLANOVIĆ:

Është më e lehtë të përfytyrosh fundin e botës sesa fundin e kapitalizmit

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Muç Xhepa (fq. 19)
Në bibliotekë

Rexhep Ferri (fq. 8)
Kush e rrëzoi lirinë nga kali?

Ballsor Hoxha (fq. 14)
Paqëndrueshmëria e hanës

Mehmet Elezi (fq. 15)
Pendël zogu

Istref Haxhillari (fq. 11)
Danishi

Franca Rame (fq. 16)
Përdhunimi

Anton Papleka (fq. 12)
Mbrëmje prilli

PYETËSORI

"LIBRAT E JETËS SIME"

FRANO KULLI

Libri me të cilin dua të mbahem mend?

Fjalori i veprës së Fishtës, me fjalë dhe shprehje frazeologjike nga kolana e veprës së tij.

(fq. 9)

Performanca "Artisti është i pranishëm", MoMA 2010.
E ulur në heshtje përballë një karrigeje bosh, ajo pret pranë tryezës së drunjtë njerëz që të ulen në karrige para saj dhe të fiksojnë sytë me të. Për gati një muaj, për tetë orë në ditë, ajo ndeshi shikimin e 1000 të panjohurve, shumë prej të cilëve nuk i mbajtën lotët.

FT Weekend Magazine ka ftuar romancieren italiane me identitet të fshehtë, Elena Ferrante, një fanse prej kohësh e veprës së me artistes performuese Marina Abramović, për të diskutuar mbi artin, shkrimësinë e shumëçka. Ferrante ruan me kujdes anonimatin e saj, kështu që biseda është zhvilluar në një seri email-esh. Rezultatet publikohen për herë të parë më poshtë.

"KAM SHUMË PYETJE PËR TY": ELENA FERRANTE BISEDON ME MARINA ABRAMOVIĆ

Romancierja më e fshehtë e botës shkëmben letra me artisten më publike të botës

Elena Marinës

Përgjithësisht, në një diskutim, kam prirjen të theksoj ndryshimet. Në rastin tonë, ndryshimi më i dukshëm është ky: për më shumë se 30 vite unë kam vendosur të shfaqem vetëm në shkrime; ju, për 50 vite, e keni vendosur veten me gjithë trupin tuaj, gjithë personin tuaj, me kurajë në qendër të skenës. Dhe sërish, që kur kam filluar të reflektoj mbi performancën tënde të jashtëzakonshme "Artisti është i pranishëm", më është dukur sikur konkurrenca mes trupit dhe veprës që krijon nuk është dhe aq e largët sa unë që shkëputem nga libri im i botuar.

Por dua të shpjegoj se në ç'sens. Te "Artisti është i pranishëm", edhe më me forcë se kudo tjetër, ju e bëni Marina Abramović-in – artisten – vetë veprën. Dhe ju ja ofroni atë vepër publikut për ta soditur jo më ndryshe, sipas meje, nga mënyra se si një tekst i punuar me kujdes i ofrohet lexuesve. Dua të them se trupi gjithashtu, me gjithë përjetimet e tij, është material i papërpunuar, po aq sa guri, druri, letra, boja. Ajo që është e rëndësishme është se si ky material punohet poetikisht, si e shpikim, si bëhemi autoret e tij. Pjesa që mbetet është industria e madhështisë, marketingu, suksesi, fama, detajet biografike dhe autobiografike: gjera që nuk janë aspak të parëndësishme dhe të cilat mund t'i shijojmë ose – me një vetëkontroll që ta siguroj nuk është i lehtë – t'i braktisim.

Marina Elenës

Dhe një ndryshim mes nesh është se, në një diskutim dhe në punën time në përgjithësi, në fakt më pëlqen të gjej elemente që i bashkojnë njerëzit dhe i bëjnë të lidhen me njëri-tjetrin. Kur shkruaja kujtimet e mia, *Walk Through Walls,* shihja ngjashmëri mes të shkruarit dhe performancave afatgjata. Të dyja praktikat i qasen redaktimit për sa kohë që i shohim gjërat me kuriozitet dhe zemër të hapur.

Gjatë "Artisti është i pranishëm", për shembull, kuptova se tavolina që më ndante nga personi i ulur përballë meje po bllokonte rrjedhën e shkëmbimit të energjisë mes meje dhe atij personi. Kjo energji është kaq e rëndësishme për mua kur bëj komunikim joverbal, dhe arsyeja pse, në një pikë përgjatë performancës tre mujore, vendosa ta heq tavolinën për të favorizuar një vendosje më thelbësore.

Vetë titulli, "Artisti është i pranishëm", thekson një nga aspektet kryesore të artit performues: diçka që ndodh këtu dhe tani, në praninë e artistit. Nga ana tjetër, pas performancës time te MoMA, kuptova shumë e më shumë se publiku kishte një rol shumë më të madh se sa të qenurit thjesht spektator.

Përpjekjet në vazhdim në praktikën time i janë drejtuar pjesëmarrjes së publikut dhe, ndërkohë që nuk e shkëpus dot vetën tërësisht nga performanca, kam gjetur padyshim një mënyrë për t'u përzierë në mënyrë që audienca të bëjë rrugëtimin e saj.

Por gjithsesi, keni të drejtë, unë jam gjithmonë në qendër të punës time. Duhet të filloj me veten time pasi veten time njoh më mirë. Trupi im është universi im dhe është fillimi i gjithçkaje.

Arti performues mund të jetë radikal nëse e hap veten ndaj zgjedhjeve të guximshme, siç keni bërë ju me shkrimin tuaj dhe vendimin për të mos u shfaqur në publik. A mund të pyes pse?

Elena Marinës

Si vajzë jam ndierë si një nyje e ngatërruar, e paprezantueshme. Dhe më vinte turp nga çdo gjë, sidomos nga dëshira për të shkruar. Shkrimi më dukej si një akt krenarie, sikur po deklaroja se mbaja botën brenda vetes. Por pasioni im ishte i fortë, dhe e trajnova veten ta udhëhiqja jetën si një person i ndrojtur, duke e ndarë radikalisht nga kohët kur trupi lirohej për të shkruar. Sa më e mprehtë kjo ndarje, aq më e lirë ndihesha.

Suksesi i komplikoi jo pak gjërat. Njerëzit afër meje më thanë: "Shijoje; nëse nuk e shijon, pse shkruan?". M'u desh të punoja më tej me veten time. Isha kurioze, dhe spektakli i famës më tundonte, por në fund m'u ngulit bindja që trupi im i vërtetë, i aftë për të shkuar jashtë kornizave me energjinë e nevojshme, është të shkruarit. Vetja ime që shkruan është atje, pjesa tjetër duket me kuptim vetëm në jetën time private. Nëse do ta ekspozoja veten, do të bëhesha një personazh, një trillim publik i cili do të kushtëzonte gjithashtu trillimin në të shkruar.

Do të doja t'ju pyesja, a njihni këtë ndarje? A ka një pjesë të vetes tuaj të cilën nuk e keni ekspozuar dhe që ndonjëherë ju duket më e gjallë, më e gëzueshme se sa pjesa që i keni dhënë kuptim me performancat e juaja? Kam shumë pyetje për ju. Arti i grave nuk ka një traditë të fortë të vetën. Ju jeni përpjekur ta ngjisni femëroren te mashkullorja – po flas për veprat në bashkëpunim me Ulay – për t'i dhënë jetë një elementi të tretë, dhe ju desh të deklaronit dështimin. A ka ndonjë dhunë të pashmangshme në takimin-përplasje mes mashkullit dhe femrës siç përcaktohet ende historikisht? A mundet që kreativiteti ynë të shpërthejë vetëm me një përkushtim absolut – pa fëmijë, për shembull – dhe në vetmi? Dhe ta dedikosh veten tërësisht në artin tënd, duke derdhur gjithë jetën në vepër, nuk prodhon një lloj ankthi të mbetjes dhe mosqëndrueshmërisë?

Marina Elenës

E di, njëherë më kanë kërkuar të ilustroj një libër për fëmijë të cilin do ta zgjidhja vetë, dhe pa e menduar dy herë, zgjodha *Rosaku i shëmtuar.* Si fëmijë i vogël dhe adoleshente në rritje, kam ndjerë një identifikim të plotë me këtë histori. Edhe unë isha rosaku i shëmtuar. Që kur isha shumë e re dhe ndihesha si e papërshtatshme. Kështu vitet e mia të adoleshencës ishin dëshpërimisht të sikletshme dhe të palumtura. Kisha këmbë të holla, këpucë ortopedike, dhe syze të shëmtuara. Mamaja ime më priste flokët shumë mbi vesh dhe i kapte me një karficë dhe më vishte me një fustan të rëndë leshi. Dhe unë kisha një fytyrë foshnjore më një hundë tmerrësisht të madhe. Në mendjen time, unë isha fëmija më i shëmtuar në shkollë.

Kur gjeta mediumin e performancës përmes të cilit shprehja veten, çdo gjë ndryshoi. Momenti që dola para publikut për performancën time të parë, përjetova menjëherë transformimin tim, sikur të isha duke dalë nga veza. Lash pas dyshimet dhe vetëvlerësimin e ulët dhe zbulova veten time më të lartë. Kur performoj, ndihem e bukur, rrezatuese dhe e fuqishme. Çdo gjë është e mundur, dhe bota rreth meje shkëlqen.

Kjo është gjithashtu arsyeja pse, në rastin tim, ndarja mes jetës publike dhe private ka pasur gjithmonë vija të turbullta. Si një artiste performuese, kam nevojë për vëmendje dhe energji nga publiku që të lidhem me ta, dhe një mënyrë për ta arritur këtë është të inskenoj frikërat e mia, brishtësitë dhe dhimbjet që audienca të lidhet me to. Nuk mendoj se ka një pjesë të vetes time të cilën nuk e kam ekspozuar, edhe pse ka padyshim gjëra të cilat njerëzit nuk i dinë për mua. Një prej tyre është se mund të jem qesharake. Adhuroj të kaloj kohë me miqtë e mi, i tregojmë njëri-tjetrit shaka politikisht të pasakta. Ndonjëherë njerëzit kanë një imazh timin i cili pasqyrohet nga performancat e mia të rrepta. Por nuk është kështu.

Nga ana tjetër, nuk do të thotë se nuk kam sakrifikuar shumë për punën time, siç përmendët, amësia nuk ishte opsion për mua pasi zgjodha t'i jepja vëmendje të pandarë performancave të mia. Në shumë raste, zgjedhjet e mia profesionale kanë krijuar gjithashtu largësi mes meje dhe burrave në jetën time, duke përfshirë Ulay-n. Intensiteti i energjisë që gërshetohej në performancat tona mund të ishte po aq i fortë sa ndryshimet në jetën tonë private, ku mbizotëronin egot tona.

Mendoj se dhuna që përmendët si rezultat i dy botëve që përplasen, mashkullorja dhe femërorja, ka të bëjë më shumë me natyrën tonë si qenie njerëzore se sa artistë. Mbi të gjitha, kam përjetuar vetminë shpesh në jetën time, dhe më korrigjo nëse e kam gabim, besoj se edhe ti. Sidoqoftë, si ndihesh vërtet për vetminë? Thatë që e keni trajnuar veten ta udhëhiqni jetën si një person i ndrojtur. A do të thotë kjo se e keni bërë vetminë pjesë të jetës suaj?

Elena Marinës

Kam qenë shumë vetëm; më vonë kam pasur një jetë të ngarkuar, por sot, jo shumë veta ma kanë nevojën, dhe e kaloj kohën duke shkruar. Përveç kësaj, të shkruarit është një punë të cilën e bën në vetmi absolute të rrezikshme, edhe nëse koka jote është e mbushur me shumë njerëz, shumë zëra, shumë objekte. Gjithashtu, publiku gjithmonë hyn në momentin kur gjërat kanë mbaruar, dhe duke qenë se kam zgjedhur të mos i takoj lexuesit, të mos kem angazhime letrare, ose të mos jem pjesë e botës letrare, në bindjen që gjithnjë e më tepër shkakton polemika se librat do të jenë të mjaftueshëm në veten e tyre, ja ku jam, në një vetmi që do ta quaja absolute.

Kështu kam qenë gjithmonë e interesuar te kreativiteti juaj, i cili është i anasjelltë, i shpikur dhe ndodh në publik dhe me publikun. Jam veçanërisht e habitur, më duhet të them, nga krenaria me të cilën ju deklaroni se jeni artiste. Unë nuk do ta përdorja kurrë termin "shkrimtare" me aq krenari, do të më dukej e tepërt. Dhe akoma, kur procesi krijues shkon mirë është njëlloj përfshirës, nënkupton të njëjtën zhytje të plotë me kurajë, të njëjtin rrezik të humbjes së vetes, të njëjtën përpjekje për ta gjetur sërish veten. Përse e konsideroni artistin një qenie njerëzore të veçantë, që nuk njeh limite, që për artin mund ta ekspozojë veten e vetë deri në pikën e vdekjes?

Më magjeps gjithashtu fakti që ju e largoni artistin nga veçantitë mashkullore apo femërore. Ne jetojmë ende në një botë të dominuar nga meshkujt, ku janë meshkujt të cilët përcaktojnë kanonet estetike, që na kërkojnë ta nënshtrojmë veten në çdo manifestim të jetës tonë, mbi dhimbjen e përjashtimit ose dëbimit për në tregun femëror. Ju nuk mendoni se, artiste apo jo, ne jemi ende shumë larg mundësisë të të shprehurit autonom të vetes tonë, duke iu arratisur kafazit të traditës mashkullore të fuqishme e të jashtëzakonshme?

Marina Elenës

Më duhet të them, më magjepsin shumë ndryshimet mes nesh dhe ndiej se nëse do të kishim shansin për t'u takuar, do të mësonim shumë gjëra nga njëra-tjetra.

Në shumicën e rasteve, nuk besoj se vepra e një artisti është e mjaftueshme në veten e vet. Një vepër arti mund të mbajë shumë shtresa kuptimi, dhe, kur mundet, artisti duhet të përpiqet gjithmonë të vendosë një urë në hapësirën mes veprës dhe mënyrës se si publiku e sheh. E di që mund të duket si një deklaratë e fuqishme, por kam ndierë gjithmonë se artisti është një shërbëtor i shoqërisë. Nëse ke dhuntinë e krijimit, duhet ta ndash pasi nuk të përket vetëm ty. Dhe krijimtaria duhet të ndahet nga veçantitë mashkullore e femërore. Për mua, ka vetëm dy lloje arti: arti i mirë dhe arti i keq.

Bota e dominuar nga meshkujt është një strukturë te e cila kontribuojmë të gjithë. Muajin e kaluar po bëja një rezidencë artistësh te Modern Art Oxford, në bashkëpunim me Pitt Rivers Museum. Gjatë kësaj kohe pata mundësinë t'i qasem një pjese të madhe të artifakteve më të shumëllojshme ku ishte e qartë se kishte një dominim të kulturës matriarkale. Kishte rituale dhe ceremoni ku gratë kishin gjithë fuqinë, bazuar në faktin e padyshimtë që ato krijonin jetë me trupin e tyre.

Ndoshta jo çdokush e di se gjatë luftërave botërore, gratë nga Mali i Zi dhe Shqipëria, pasi humbisnin burrat e tyre në luftë, do ta përpunonin vetveten deri në atë pikë që bëheshin vetë burra, vishnin rroba burrash, përdornin armë, ndalonin periodat dhe rrisnin mjekër. Ajo që dua të them është se është gjithashtu faji ynë që përfunduam duke u dhënë kaq shumë fuqi meshkujve.

Nuk lodhem kurrë së përmenduri shembullin e Louise Bourgeois, një nga artistet femra më të spikatura të kohës sonë. Ajo filloi t'i fokusohej plotësisht artit dhe karrierës së saj pasi i vdiq shoqi. Pa e kuptuar, ne krijojmë kaq shumë struktura për veten tonë dhe shoqërinë tonë. Ne jemi të vetmet që mund t'i ndryshojmë. Mund të jemi luftëtare në mënyrën tonë unike.

Elena Marinës

Edhe unë shpresoj se do të kemi rastin të flasim me njëra-tjetrën. Dhe më pëlqen shpirti yt luftëtar. Por na duhet të luftojmë që asnjë grua, asnjëherë, të mos i duhet të presë vdekjen e burrit të vet për të shprehur gjenialitetin e saj. As nuk jam e bindur që na duhet të kapim çdo mundësi për të zëvendësuar burrat e të sillemi si ta. Më saktë, duhen të luftojmë që shpërdorimi më i madh, më i gjatë, më budalla i parë ndonjëherë në planet të mbarojë: shpërdorimi i inteligjencës dhe krijimtarisë femërore. Pastaj do të shohim cilësinë e veprave. Të tuat janë jashtëzakonisht krijuese: më bëjnë të dua të shkruaj.

Për dekada me radhë — sa për të dhënë një shembull — jam përpjekur të punoj mbi një roman që ka në qendër performancën që ju dhatë në Napoli në 1974, te Studio Morra. Nuk dua t'ju mërzis me skicat që kam mbledhur deri tani pa dalë ndonjëherë në një zgjidhje: ka gjithmonë diçka që më frikëson dhe më bllokon. Do t'ju tregoj vetëm që supozohej të ishte historia e një gruaje të re napolitane e cila tërhiqet nga një burrë për te ajo galeri, te audienca juaj. Dhe po ju tregoj për këtë këtu që të theksoj faktin që performancat e juaja, më shumë se të tjerët, më duken sikur, brenda një hapësire të kontrolluar, vjen një shtyrje, pastaj pyetja: po tani çfarë ndodh? A shpik me një vetëdije tw plotw të situatave rrëfyese të mundshme?

Marina Elenës

Je duke sjellë një aspekt kaq të rëndësishëm të artit performues, dhe procesit shumë personal përmes të cilit krijoj punën time. Performanca është mediumi që më ka dhënë mundësinë të vendos pak rregulla të sakta që mund t'i ndjek vetëm si artiste, në një kohë dhe hapësirë të dhënë. Si një qenie njerëzore, normalisht nuk do të kisha të njëjtën stamina dhe kurajë që kam kur jam duke performuar.

Po citoj një rresht nga filmat e hershëm të Almodóvar-it: "Jam veç njeri dhe jam shumë i papërsosur." Ajo te e cila unë po mbështetem është energjia e publikut që për mua përfaqëson ndihmën shtesë që më duhet për të vazhduar performancat e mia.

Kur kam një ide për një vepër performuese të re, nuk mendoj ndonjë situatë rrëfyese të mundshme. Kam një listë me udhëzime dhe një kohë të caktuar për to që të shpalosen. Çdo gjë që ndodh në mes bëhet pjesë e veprës, e kështu, dhe e rrëfimit. Asnjë prej tyre nuk është e planifikuar, gjë që sjell një tjetër aspekt të rëndësishëm të veprës sime: unë nuk bëj prova për performancat e mia. Lejoj jetën dhe energjinë të shkojë përmes saj, dhe me këtë dua të them se një tërmet mund të ndodhë, dikujt nga audienca i bie të fikët, ose publiku ndërpret veprën. Nuk ka një rrjedhë të paracaktuar, dhe unë pranoj çdo gjë që del nga ajo që ne normalisht do ta quanim një moment përçarës.

Pastaj ju përmendni vajzën e re që çohet në galeri nga një burrë më i madh në skicën e romanit tuaj të bazuar te "Ritmi 0", dhe shkaktoni një kujtim që unë e kam hequr tërësisht dhe nuk kam ndarë me askënd deri tani. E mbaj mend shumë gjallërisht që gjatë performancës te Studio Morra, kishte një burrë të vjetër të vogël i cili ishte gjithmonë rrotull meje gjatë atyre gjashtë orëve. Në një pikë madje u afrua aq shumë, pavarësisht se nuk më preku kurrë ose nuk mori pjesë aktivisht në vepër. Sidoqoftë, mund ta dëgjoja frymëmarrjen e tij mbi lëkurën time. Besoje ose jo, ai ishte i vetmi person në dhomë të cilit ia kisha frikën.

Nga ana tjetër, te "Ritmi 0" nuk u ndieva kurrë si viktimë. Ishte vendimi im, dhe vetëm i imi, që të isha një objekt mes 72 artikujsh të tjerë që zgjodha, të cilët përfshinin një pistoletë dhe një plumb. Vendosa që publiku mund të bënte çfarë të donte, duke përfshirë të më vriste, pavarësisht se brenda asaj kohe që unë dhashë. Pas gjashtë orësh, kjo e drejtë iu hoq.

Më në fund, ju sollët një aspekt tjetër të rëndësishëm të kurbës krijuese: si ju, unë kam vepra që i kam pasur në kokë por nuk i kam performuar kurrë. Përse mendoni se ndodh kjo?

Elena Marinës

Nuk e di. Të vësh në vijë procesin krijues, rindërtimi i besueshëm se si një histori fillon, zhvillohet dhe i vjen fundi është një ndërmarrje e mundimshme, e ndoshta e pamundur. Më duhet të them, në fakt, se nuk i besoj vërtet atyre që diskutojnë me detaje konceptimin e veprës së tyre. Sipas eksperiencës time është çështje shkrepjesh, përplasjesh, paraqitje fragmentare që ikin në teatrin e trurit.

Shumica e këtyre fragmenteve lënë shenja të zbehta. Të tjera tërheqin çdo gjë me vete, historia shkon drejt fundit. Sërish të tjera vazhdojnë të ndryshojnë drejtim, ti i ndjek, humbet, ndonjëherë të vijnë befasisht nga një kënd i papritur dhe të lëndojnë. Parapëlqej këto të fundit, gjithmonë, dhe rezultati është që unë i braktis shumicat e veprave të mia. Shpesh është sepse i konsideroj përtej aftësive të mia (shkrimtarja, siç po thoja, mund të mbështetet vetëm te vetja e vet, publiku vjen më vonë). Por në disa raste këmbëngul, pres, dhe filloj sërish. Për librin që ishte më rezistent ndaj shkrimit tim m'u desh të prisja një dekadë: quhet "Bija e humbur". Dhe shkrimi i tij më frikësonte, nuk isha e sigurtë se do ia dilja mbanë.

Kështu që, po, mendoj se disa prej veprave të cilat nuk i arrijmë struken në trurin tonë dhe presin për momentin e duhur. Janë aty, ne skicojmë fragmente të tyre, por forca dhe kuraja jonë nuk janë të mjaftueshme. Nuk është serioze. Ato shfaqen shkurtimisht, dhe dikush tjetër i plotëson në vendin tonë. Nuk jemi të domosdoshme.

Ky shkëmbim, dhe kërkimi për pikat tona të kontaktit ka qenë vërtet një kënaqësi, Marina, faleminderit.

Përktheu nga anglishtja Enxhi Hudhri

72 objektet e përdorura te performanca "Ritmi 0", ekspozuar te Palazzo Strozzi, Firence, 2018.

Në këtë performancë, Marina, për gjashtë orë ka ndenjur pa lëvizur, ndërkohë që audienca mund t'i bënte ç'të donte me këto objekte.

Luan Starova e të tjerë romancierë

KUJTIMET BURIMORE – MJET ÇLIRIMI DHE INDIVIDUALIZMI KRIJUES

Nga Virion Graçi

Në përvjetorin 80-të të Luan Starovës, shohim sërish se jeta dhe krijimtaria e tij e përfaqësojnë njëra-tjetrën, jeta na çon lehtësisht te vepra e tij letrare, sikurse, leximi i romaneve të "Saga Ballkanike" na e jep një biografi të autorit, takimet e tij të para me botën. Sikurse ndodh në letërsinë e arrirë, librat e L. Starovës nuk marrin përsipër të tregojnë gjithçka, por çdo gjë e treguar është autentike dhe përgjithësuese, emocionuese, me konotacione të forta historike e filozofike.

L. Starova është tipik romansier i shkrimit autobiografik. Në letërsinë shqipe është vështirë t'i gjesh një të ngjashëm për nga prurjet dhe cilësia në këtë lloj shkrimi, prandaj do ta vendosim në shoqërinë e shkrimtarëve Margerit Dyras, Albert Kamy, Zhan Pol-Sartr, autorë të pranishëm e me ndikim në sistemin tonë letrar, ardhur nëpërmjet përkthimeve cilësore.

Shkrimi autobiografik te autorët e sipërpërmendur dëshmohet së pari si liri njerëzore, si pohim me gjuhën e artit i të vërtetave vetjake e familjare, sado të pa lavdishme a të pa denja qofshin ato në raste të caktuara; njëherësh, pasuria e shburgosur e kujtesës, çlirimi i kujtimeve nga e shkuara e largët - në të tashmen e narrativës fiksionale, i jep formë të re e fizionomi origjinale zhanrit përkatës, romanit, nëpërmjet të cilit lënda intime, bota diskrete e anonime e fillesave vetjake, shndërrohet në afresk i gjallë e tërheqës për publikun/lexuesit. Të tillë janë për nga konceptimi dhe tonet narrative romanet "Dashnori", (Dyras), "Fjalët", (Sartre), "Njeriu i parë", (Kamy); unikalë janë në letërsinë shqipe e përtej saj edhe romanet e "Saga Ballkanike" të L. Starovës.

Sikurse L Starova, edhe Dyras, Kamy, Sartr janë rritur e afirmuar në mjedise të huaja për ta. Dyrasi-në Indokinë, Kamy në Algjeri dhe Sartr është lindur e rritur në Francë, por gjyshi i tij është me origjinë gjermane, nga krahina e aneksuar e Alsas-Lorenës.

Dyras, Kamy, Sartr kanë ndeshur në të kaluarën e tyre problemin e heshtjes në familje, defektet në të folur, me pasojë moskomunikimin normal: në familjen e Kamysë pothuajse nuk bisedohet kurrë, nëna e tij nuk flet, ka kryesisht një komunikim me veprime, me gjeste. E njëjta heshtje e dëshirë këmbëngulëse për të mos u shprehur, për të mos u shpjeguar, karakterizon edhe heronjtë e tij kryesorë. *Heshtja më e sigurt është kur flasim*, perifrazon Kamy Kierkegorin te "Miti i Sizifit", duke përligjur nga pozita filozofike këtë tipar dallues të personazheve të tij që vjen prej miteve familjare. *Procesi i mendimit ndërpritet kur fillojmë të flasim*, shprehet Kamy ironikisht po te "Miti i Sizifit". Edhe Mërso, heroi te "I huaji", nuk shfajësohet në gjyq, nuk dëshiron të marrë fjalën për t'u mbrojtur, *jo se është tip i heshtur*, sipas tij, *por nuk ka ndonjë gjë që ia vlen të thuhet*. L. Starova, sythin "Gjuha e nënës sime" te "Librat e babait" e nis me thënien e S. Bekett: "Heshtja është gjuha jonë amtare".

Babai dhe xhaxhai i Sartrit kishin probleme me të folurin, me mbajtjen e fortë të gojës. Sartr e përshkruan fëmijërinë te "Fjalët" si një përpjekje të madhe për t'u bashkuar me ligjërimet e rrjedhshme të librave.

Në familjen e Dyrasit, gjithashtu mbizotëron heshtja dhe moskomunikimi torturues, jo për shkak defektesh të lindura. Shkruan Dyras duke stigmatizuar marrëdhëniet e deformuara midis anëtarëve të familjes së saj: *Asnjëherë mirdita, mirëmbrëma, gëzuar vitin e ri. Asnjëherë faleminderit. Gjithmonë gojëkyçur. Të mos kesh nevojë të mos flasësh kurrë. Gjithçka të mbetet memece, e largët. Ajo ishte një familje prej guri, e ngurtësuar në mënyrë të tillë që nuk e çante njeri. Çdo ditë provonim të vrisnim veten, të vrisnim. Ne jo vetëm që nuk shkëmbenim një fjalë po nuk e shihnim dot në sy njëri-tjetrin.*

Heshtja, apo fjala e duhur, fjala e shumëpritur në vend të heshtjes, nga fëmijët e dikushëm, tashmë shkrimtarë të njohur, është e lidhur me autoritetin prindëror, me baballërët, në radhë të parë. Por, nga Dyras deri te L.Starova qëndrimi ndaj tyre është i ndryshëm. Sartr te "Fjalët" për babain: *Ai s'kishte zanat; i bllokuar midis heshtjes së të atit dhe britmave të së ëmës, u bë belbacak dhe jeta i shkoi duke luftuar me fjalët.*

L.Starova është në kushte të njëjta biografike: Tëhuajësimi i familjes shqiptare në një mjedis me prirje asimiluese dhe ksenofobe, jepet po ashtu nëpërmjet rrudhjes së indentitetit nga ana e kryetarit të familjes, babait. Poliglot në një lagje dhiarësh, me universitet në një lagje analfabetësh, ai struket në gjuhën e tij të brendshme, nuk ka dobi praktike ta shpalosë unin e tij. Përkundrazi bëhet i paditur, mbyllet në vetvete, në librat e vjetër, në nevojat ditore të familjes: *Duket se ai zotëronte një gjuhë të brendshme të vetën, së cilës ia besonte nga ato mendimet e tij që ishte më pak e mundshme të gjenin shprehje me ndonjërën nga të folmet me të cilat komunikonte me botën*

Si karakteristikë tjetër të përbashkët, autorët francezë kanë mungesën e autoritetit atëror në fëmijëri. Dyrasi, vajzë e një mësuesi matematike nuk ka njohur kujdesin dhe autoritetin atëror; 14 vjeçe ajo ka mbetur jetime nga babai, në vijim nuk ka kush kohë dhe dëshirë t'i tregojë asaj diçka për të. Dyras nuk shfaq kureshtje a keqardhjeje për mungesën e tij edhe kur e rijeton të shkuarën pas shumë vitesh, në moshë të thyer. Kamy dhe Sartr po ashtu janë rritur vetëm prej nënave, kanë pasur baballarë të cilët nuk i kanë njohur kurrë; ata vetë nuk ushqejnë keqardhjeje a ndjeshmërie pozitive në lidhje me etërit e panjohur, të munguar. Shkruan Sartr për të atin: *Atë e njoh me të dëgjuar,*

njëlloj si Maskën e Hekurt apo kalorësin e Enoit, dhe çka di për të s'ka kurrfarë lidhje me mua: edhe sikur të më ketë mbajtur në krahë, sikur të më ketë kundruar me sytë e tij të çelët, që sot ia kanë ngrënë, askush nuk e mban mend: të gjitha këto dhimbje dashurie kanë humbur. Ky baba nuk është as edhe hije, as edhe një vështrim: ai edhe unë kemi rënduar ca kohë mbi të njëjtin dhe, dhe kjo është e tëra

Kamy ka qenë një vjeç kur e ka humbur babain, vrarë në luftë, por ai niset rrugës për ta kërkuar origjinën e tij gjysmë shekulli më vonë, nëpërmjet gërshetimit të trillimit romanor me lëndën e mirëfilltë autobiografike. Zbulimit të së shkuarës i kushton romanin "Njeriu i parë." Kamy vuan mungesën e kujtimeve të drejtpërdrejta, por e rindërton imagjinativisht figurën e babait, përshkruan largimin e tij nga shtëpia për në ushtri, mënyrën si ai kapërcen për herë të fundit rrugicën pranë shtëpisë për të mos u kthyer më.

Kamy babanë e sheh si mëtonjës përkatësie, prej të qenurit pasardhës i tij, ai, francezi i Algjerisë, duhet të hidhet në krahët e gjuhës dhe letërsisë franceze: *Ai ishte njeriu i parë ngaqë ishte i varfër dhe kjo nuk u ka dhuruar e përcjellë kurrë gjë me vlerë qënieve njerëzore.... ishte në ekzil, larg vendit të vet, po jetonte në gjuhën e vet. I vetmuar dhe i qëndrueshëm.*

Më tej Kamy shprehet: *Njëzetenëntë vjeç, duhej të kish qënë i brishtë, i vuajtur, i nderë, kokëfortë, sensual, ëndërrimtar, cinik, kurajoz...në një familje ku flitej pak, ku nuk shkruhej e as lexohej...*

Margerit Dyras ka një situatë më të veçantë; babai nuk arrin të depërtojë kurrë në vetëdijen e saj, as për t'u mohuar as në formë kujtimesh pohuese; objekt i fortë dashurie dhe frymëzimi lirik për Dyrasin është *vëllai i vogël*, i vdekur para kohe për shkak të varfërisë, për të ajo ruan dhe shfaq gjithë ngrohtësinë e saj njerëzore; autoritetin e babait në familje e luan *vëllai i madh*, atë do me verbëri e ëma, për atë është gati të sakrifikojë dy fëmijët e tjerë më të vegjël, si dhe veten e saj: *Të gjitha bashkësitë, qofshin ato familjare apo diçka tjetër, për ne ishin të urryera, poshtëruese. Ne qemë të bashkuar rreth parimit të turpshëm. Duhet të jetoj. Ky parim ishte shkaku që ne gjendeshim në thellësinë më të errët të historisë sonë të përbashkët, në atë të të qenit që të tre fëmijë të atij njeriu të ndershëm, nënës sonë, të cilën shoqëria e kishte vrarë. Ne ishim në bisht të shoqërisë që e kishte shtyrë nënën tonë drejt dëshpërimit. Për shkak të asaj që i kishin bërë nënës sonë aq të dashur, aq të çiltër, ne e urrenim jetën, ne e urrenim njëri-tjetrin.*

Ngjashëm e izoluar është dhe familja Starova, jo prej ligësisë së anëtarëve të saj, por për shkaqe shoqërore-etnike: *Të ardhur së voni, me një gjuhë dhe besim tjetër, por nën të njëjtën ideologji, të ngarkuar me libra, thjesht si të ishim hedhur në këtë qytet buzë lumit, ne për një kohë të gjatë kishim mbetur si një ishull i vetmuar.*

Autori rrëfimtar, duke e parë historinë e familjes së tij me sytë, ndjeshmërinë dhe logjikën e një fëmije, dimensionin diakronik të saj ia beson të atit. Niveli kulturor, peripecitë e jetës plot me shtegtime e shpërngulje për shkak të luftërave ballkanike, e lejojnë babanë e autorit të mbajë e të rrëfejë barrën e trashëgimisë dramatike të familjes: *Mendimet e tij përfundonin te liqeni i madh në brigjet e të cilit kish rrjedhur fëmijëria dhe rinia e tij e ku shpresonte të kthehej në pleqëri. Shpresë mashtruese ballkanike.*

Tëhuajësimi i familjes shqiptare në një mjedis me prirje armiqësore, asimiluese dhe ksenofobe, jepet po ashtu nëpërmjet bjerrjes së indentitetit nga ana e kryetarit të familjes, babait. Megjithëse poliglot në një lagje dhiarësh, megjithëse me universitet në një lagje analfabetësh, ai struket në gjuhën e tij të brendshme, nuk ka dobi praktike ta shpalosë unin e tij. Përkundrazi bëhet i paditur, mbyllet në vetvete, në librat e vjetër, në nevojat ditore të familjes: *Duket se ai zotëronte një gjuhë të brendshme të vetën, së cilës ia besonte nga ato mendimet e tij që ishte më pak e mundshme të gjenin shprehje me ndonjërën nga të folmet me të cilat komunikonte me botën.*

Motivet autobiografike merren më endje nga Dyras







në disa romane; Kamy e Sartr I shpërfaqin mitet familjare me nga një roman; L. Starova e ndërton një korpus romanesk me qerthullin familjar autobiografik, si epos familjar dhe si histori - epope groteske e dramatike ballkanase, e shtirë bollshëm në kohë e hapësirë, përtej çdo fati të përvetshëm njerëzor.

Te romani "Librat e babait" protagonist është babai si *Njeriu i parë* i një bote të re në kaos e konflikte të reja dhe si *Njeriu i fundit* i një bote të vjetër, në zhdukje prej kaosit, luftrave, antagonizmave, ideologjive radiakale. Te romani "Librat e babait" mbizotëron rrëfimi fragmentar-piktoresk, njësitë e shkurtëra memuaristike, të letrarizuara, romani tjetër, "Koha e dhive" karakterizohet nga intensiteti emcional, pasuruar me digresione anësore krahas temës kryesore, përthyer shpesh e mjeshtërisht në prizmin e ironisë, autoironisë, groteskut. Në romane të tjerë të L. Starovës ruhet e pasurohet më tej kjo fizionomi stilistike-narrative.

Në "Saga Ballkanike" rrëfehet me empati familja, nëna, motrat, babai, përpjekjet e tyre duke nisur që nga mbijetesa si qenie të gjalla dhe përshkruhet mënyra e re e riorganizimit të jetës. Mjedisi vendës, maqedonasit, të huaj dhe armiqësorë për familjen e porsaardhur nga Shqipëria, është po aq në një proces të gjatë e të vështirë riorganizimi, nën një regjim të ri shtetëror, me parime të reja ekonomiko-sociale. Futja e ish Jugosllavisë në rrugën e komunizmit ndryshon rregullat e përditshme të njerëzve. Kufizimi i pronës private, reformat e njëpasnjëshme sociale-kulturore, lënë pasoja në marrdhëniet ndërnjerëzore. Skena kryesore ku shpalosen ngjarjet dhe përthyhen fatet njerëzorë është lagjja. Nga njësi elementare organizative e jetës urbane, lagjja bëhet makrokozmos, njësia më e madhe shprehëse në romanin e L.Starovës, vatër kuptimore ku reflektohen tendencat, ndodhitë, prirjet e përgjithshme të gjithë federatës jugosllave. Duke pasur si dekor dhe pikënisje parathënëse lagjen maqedonase, drama e familjes shqiptare arrin të rrëfehet katërcipërisht brenda mureve të shtëpisë. Atje personazhet i shprehen vetvetes, njëri-tjetrit, në formë dialogu e monologu të brendshëm. Kryetari i familjes, babai - i vetmi autoritet dhe prijës për anëtarët e tjerë, kërkon nga lagjja kompromiset e para dhe bën lëshimet përkatëse. Ajo që fillon të rrudhet është shenja identitare: gjuha shqipe. Nuk do të kenë libra shqip, as shkollë shqipe dhe komunikimi në gjuhën amatare është mundësi që ngelet brenda katër mureve të banesës. Ajo që mund t'i kërkohet anës tjetër, maqedonasve është e drejta për të mbijetuar si qenie fiziologjike, buka dhe qumështi i dhisë për të ushqyer të vegjëlit. Nga përplasja midis një familjeje dhe një shteti në situatë lufte etnike, klasore e politike, kuptohet cila palë do të tjetërsohet e do të zhytet pak nga pak në një muzg anonimati. Metamorfozën e pësuar në identitet, njëri nga anëtarët e familjes, romancieri L.Starova e përdor artistikisht duke e bërë figurë bazë të strukturës romanore: groteskun; nëpërmjet groteskut, identitetin e diktuar nga rrethanat shtërnguese, e zhvesh nga pompoziteti, nga përmasa serioze-autoritare, e ul prej fronit emancipues ku e ka çuar propaganda e shtetit totalitar, e paraqet ashtu si ishte për njerëzit e "huaj" - i dhunshëm dhe butaforik.

Përkimet mes fakteve biografike të shkrimtarëve janë të shumta; të ndryshme janë procedimet artistike të secilit dhe qëllimet e rikthimit në vendin e dikurshëm të ngjarjeve, në shtresëzimet e herëshme të kujtesës. Nëse shkrimtarët francezë iu janë kthyer miteve familjare për t'i demontuar, për t'i stigmatizuar, secili për ta ndarë identitetin vetjak - nga rrethi i ngushtë klanor/familjar, L. Starova, historinë e familjes dhe ikonat e saj i bën mjet identifikues në kohë e hapësirë, u jep peshë simbolike. Me lirinë dhe mundësitë shprehëse që ka krijimi letrar romanor, L. Starova përbashkohet me mitet e tij familjare; në këtë mënyrë, babai i tij, vatra prindërore, vëllazëria biologjke bëhen, në miniaturë – sinonime me familjen e madhe e munguar - me botën shqiptare në radhë të parë dhe, mandej, sinonime me njerëzimin, me krejt gjindjen njerëzore.

"PARAKALIMI" – NJË FRAGMENT DRAME E A. PASHKUT

Nga Behar Gjoka



Trashëgimia letrare e dramatikës së Anton Pashkut, përpos dy tragjedive moderne, siç edhe i pati përcaktuar vetë shkrimtari, përkatësisht Gof dhe Sinkopa, shqyrtuar në të gjithë elementët e vetë, nga studimtaria e shqipes, përfshin edhe fragmentin e dramës *Parakalimi*, një tekst relativisht i shkurtër, krahasimisht me dy tekstet e tjera të autorit. Prania e këtij fragmenti drame, krijon një situatë të re dhe jo pak të ndërlikuar, për trashëgimin dramatike të autorit, e cila duhet të marrë një përgjigje:

a - Natyra e këtij teksti dramatik, në të gjithë treguesit, sidomos si dialogim dhe replikë ndërmjet personazheve të episodit, që pamëdyshje tregojnë shenjat thelbësore të tipologjisë së dramaturgjisë, parë në marrëdhënien e ngushtë me dy veprat e tjera, që i përkasin tragjedive moderne, pra me këtë tekst të shkurtër dramatik, pasurohet tipologjia e zhanrit të lëvruar prej Pashkut.

b - A ka ndonjë mundësi hipotetike, që autori ta ketë përfunduar si tekst drame, pra që më në fund të kemi të bëjmë me një dramë në të gjithë përmasën e vetë, dhe dikur në një të ardhme të afërtë, të na bjerë në dorë, pikërisht doreshkrimi i plotë i dramës, që do të përplotësonte kështu rolin e plotë të Pashkut në shkrimin dramatik?

Ky fragment teksti, që është ribotuar në vitin 2005 në Prishtinë nga shtëpia botuese Faik Konica, ndërkaq e përmbledhur bashkë me prozën për fëmijë, por edhe me disa nga tregimet fantastike, siç i pati emërtuar vetë shkrimtari, të shkruara në dy variante gjuhësore, pra në gegnishte dhe në gjuhën e njësuar, që në fakt përbën një anë tjetër të kontributit të shkrimtarit, që do të kërkonte verifikim dhe interpretim krahasimtar, të kësaj dysie gjuhësore, pra të shkrimit të prozës edhe me gjuhën e njësuar, por edhe me variantin e gegnishtes. Ky fakt shënon ndërkaq edhe dy versione të mirëfillta letrare, çka përbën edhe vlerën më të madhe të tyre, vlerësinë estetike, për momentin përmbyll pjesën përfaqësuese të dramaturgjisë moderne të realizuar prej shkrimtarit. Nga ana tjetër, me shumë gjasa, më tepër e shtruar si një hipotezë, që do të kërkonte hulumtime të gjera, si do të ishte drama e përfunduar, ose si janë në të gjithë hapësirën e tekstit, elementët kryesorë dramatikë. Nëse ka gjasa, që ta zbulojmë ndonjëherë në doreshkrimet e autorit (gjë që do të gjurmohet pranë familjarëve të tij), mbase edhe të vijimit të këtij teksti, që për nga stilemat dhe ngjyresat shqiptimore lidhet me tipologjinë e shkrimit dramatik të autorit. Në pikëpamje të llojit letrar, pra të tipologjisë shkrimore dramatike, ky tekst do të duhet shqyrtuar dhe verifikuar, se a është pjesë e konceptimit të autorit, si tragjedi moderne, të emërtuar nga vetë shkrimtari, pra sikurse dy tekstet e tjera, të cilat i kemi të plota, apo më së shumti i përket tipit të dramës, siç e pati shënuar vetë autori, diku në fillim të fragmentit? Emërtimi nga vetë shkrimtari, pra vetëm si një fragment drame, ashtu si edhe ka emërtuar si tragjedi moderne, dy tekstet e tjera dramatike, të cilat i kemi të plota, dëshmon më tepër se është tejkaluar përcaktimi i këtij teksti si lloji letrar, si dhe pjesa tjetër, duke e zgjidhur vetë problemin e llojit letrar të këtij fragmenti, që më tepër paraqitet si një tekst drame.

Filozofi jetësore

Kolizioni dramatik, që dihet se shënon një nga shenjat ekzistenciale të dramatikës si gjini unike letrare, pavarësisht llojit dhe tipologjisë, i pranishëm në fragmentin e dramës Parakalimi, bazuar vetëmse në tekstin dialogues, që na ka rënë në dorë me atë hapësirë tekstologjike, si dhe në mënyrë të veçantë me nëntekstin rrezonues të tij, që bart dhe përçon, më në fund qartësohet se i përket rrafshit etik dhe filozofik jetësor. Pra, në hapësirat e tekstit të fragmentit Parakalimi, shfaqet një pamje konkrete dhe e bazuar në thelbin mental të njeriut, krejt të zakonshëm të popullit, mbi shanset e jetës. Filozofia mentale jetësore e njeriut të thjeshtë, krejt të zakonshëm, që rreket të mbijetojë në këtë realitet, të vrazhdë dhe telendisës, madje siç na shpaloset në tekstin e këtij fragmenti drame, veçanërisht kjo ndjesi e pazakontë, artistikisht përftohet nga kjo përplasje e ashpër e dy koncepteve reale:



Së pari: Kali i bardhë, që duket se na vjen këtu si një simbolikë e gjetur dhe funksionale, i cili bart mbi supet e veta, po kaq edhe një mesazh të rrokshëm mental të popullit, të mençurisë së rrokshme popullore, të fatit të bardhë. Me shumë gjasa, bart dhe përçon diçka më tepër të uratës dhe garantimit të fatbardhësisë, së qenies njerëzore, që ndërkohë përfaqëson vetëm njërën anë të medaljes, pra të pranisë së mençurisë dhe filozofisë jetësore, e cila shenjohet me një formë të gjetur të kontrasti të thekur, bardhë e zi, ku ngjyra e bardhë, për shkak të paqtimit dhe ardhmërisë, që sjellë me vete, është më e pranishme dhe më e dëshirueshme për vetë qenie njerëzore.

Së dyti: Fatin e zi, po kaq të vlertë si detaj artistik, që e ndjekë fatin e njeriut në çdo hap që hedh, si individ dhe komunitet, si me thënë kjo gjetje stilistike, e një antiteze bardhë e zi, përfaqëson atë pjesën e mistershme, pra kalin e zi, i cili në mentalitetin e filozofisë popullore, paralajmëron fundin e zi, kobin dhe katastrofën. Por, paragjykimi mbi mbrapështinë që bart ngjyra e zeza, shpaloset prej këtij fragmenti të tekstit dramatik, ku vjen e plotë zezona, madje si një fund i pashmangshëm i vijimësisë së qenies njerëzore. Në këtë përplasje konfliktuale, të ashpër sa nuk rrëfehet, të madhe ngjyrash të forta, ku ngjyra e zezë që përthkeson kontrastin përballë të bardhës, është edhe më e fortë dhe po kaq më shkatërruese, njëherit, si dëshmi e rrokshme e paragjykimit mbi spektrin e ngjyrave, sepse vërtetë e zeza, të tmerron, por e bardha e akulltë e borës, a nuk ndikon në jetën e njeriut po kaq fortë?

Vënia përballë e këtyre dy koncepteve, të jetës si mbijetesë dhe të filozofisë mentale popullore, që në hapësirat e fragmentit, rrinë përballë dhe materializojnë kontrastin e fortë, me shumë gjasë e dy ngjyrave të forta dhe të përndezura, që përfaqësojnë një marrëdhënie mentale dhe paragjykuese, të hershme dhe bashkëkohore, të spektrit bardhë e zi, të cilat në këtë episod shkurtimor, vijnë përmes kalit të bardhë dhe të zi, si dhe vetë ato janë dy ngjyra të cilat, shëmbëllehen dhe çnjgjyrosen në njëra-tjetrën, një vështrimi ky tipik i mjediseve shqiptare, por edhe i rajonit të gadishullit tonë. Në fakt, e bardha dhe e zeza, të vëna përballë, përfaqësojnë dy simbolika, të ndryshme dhe të përkundërta, të shqiptimit të rrokshëm letrar, çka ka bërë që kolizioni dramatik, limfa ekzistenciale e veprave dramatike, të ngrihet mbi një rrafsh etik dhe filozofik, thellbësisht jetësor dhe po kaq edhe realist në formësimin e situatës dhe dialogut ritmik. Po ashtu, në konceptin e fatit, me shumë gjasa të fatalitetit, që sendërton kontrastin, përmes dy ngjyrave, bardhë dhe zi, një ndërthurje që nuk shpie në shkrirjen e ndërmjetshme, por vetëmse në pak zbehje të secilës prej këtyre ngjyrave,

Vijon në faqen 9

KAFJA E FUNDIT ME PJETËR ARBNORIN

Nga Uran Butka



Një ditë para se të shkonte nga kjo botë, Pjetër Arbnori më mori në telefon. Pimë një kafe?- më pyeti. Te Kullat. -Mirë, i thashë dhe u nisa.

Për çudi nuk lamë orë të caktuar. Në lokalin lluksoz të katit të dytë prita veç disa sekonda. Ishte veshur me një kostum gri të hapur në të bardhë, që i shkonte shumë dhe e tregonte më të ri. Fytyrëqeshur dhe i qetë, si gjithnjë. Porositëm kafet.

- Nesër do të shkoj në Itali, më tha. Jam i ftuar në një takim ndërkombëtar. A mund t'i bashkosh të dy temat në një?

- Patjetër.

Të nesërmen, në ditën ndërkombëtare të viktimave, do të bëhej një konferencë në Tiranë, ku do të fliste Arbnori për viktimat e burgjeve komuniste, ndërsa unë për viktimat e jashtëburgjeve.

- Nëse më lejon, do të them edhe për ju diçka, kuptohet për lëvizjen politike socialdemokrate, që u bë shkak për burgimin, - i thashë.

- Fol për ata që s'janë më, për ata që s'ka kush flet, jo për ne të gjallët.

- Unë flas edhe për të gjallët edhe për të vdekurit.

- E di.

U bë një heshtje e gjatë.

I rufitëm të menduar kafetë.

M'u duk sikur dallova në thellësi të syve të tij një hije trishtimi.

- Zoti Pjetër , i thashë, ju kini arritur në jetën tuaj disa kulme. Ishit në burg dhe mund të mos kishit dalë i gjallë. Por ja që qëndruat dhe dolët. Pak i moshuar, burgaxhi dhe punëtor krahu jashtë burgut, por brenda një burgu tjetër më të madh, mund të mos krijonit dot familje. Por ja që e krijuat një familje të mirë dhe kini dy fëmijë të mrekullueshëm. Arritët të bëheshit kryetar parlamenti dhe të delnit s'andejmi me qafë të hollë dhe me faqe të bardhë. Së fundmi, keni botuar disa libra që ju kanë nderuar në fushën e letrave. Jeni një personalitet, që e kapërceni edhe PD-në. I paprekshëm. Atëherë, përse nuk e ngini zërin më fort, zoti Pjetër?

U habita edhe vetë për ato që thashë me një frymë. Siç duket më ishin mbledhur brenda vetes mendimet dhe dolën natyrshëm.

Ai nënqeshi, po nuk foli.

Unë qëndrova në timen:

- Dikur, cari i Rusisë ishte në përplasje me Tolstoin. Gazetat e Perëndimit shkruanin: "Cari s'ka ç't'i bëjë Tolstoit, Tolstoi ka ç't'i bëjë Carit"...Ty Pjetër, s'ka ç'të të bëjë Cari i PD-së!

- Ti mendon se kam frikë? Frikën e kam humbur qysh kur provova burgun, vdekja s'më hyn në sy, se e kam prekur disa herë.

- Edhe në grevën e urisë, për një grimë, shkove e vajte në atë botë.

- E kisha përnjimend.

- Nuk bëhet fjalë, i thashë. Ishte grevë për fjalën e lirë.

- Pikërisht.

- Po kur fjala e lirë shpesh pengohet edhe brenda PD-së, si i bëhet? Mos duhet të heshtim?

- Përballjen kryesore e kemi me shtetin, tha ai.

- Ndërsa unë mendoj se përballjen e parë duhet ta kemi me veten.

- Të përgëzoj për kurajon që ke. Për çdo gjë që s'ecën, ti e nge fort zërin, qoftë edhe ndaj Njëshit. Ndërsa unë kam mënyrën time të të thënit të gjërave. Qetë- qetë. I kam shprehur mendimet në kryesi, por ia kam thënë edhe veçmas Berishës në zyrë, megjithatë ai nuk ndryshon. Ashtu është formuar. Edhe gjatë këtij viti i kam kërkuar takim për punën time, se nuk jam as në qiell, as në tokë, po nuk më ka pritur. Së fundi, më dërgoi një mesazh me celular: "Takohu me shefin e kabinetit, Arben Imamin"!?

- E pabesueshme!

- Ja që është e vërtetë.

- Nuk është më e dobishme t'i themi gjërat vetëm midis nesh, duhet t'i themi me zë të lartë, që të na dëgjojnë edhe të tjerët. Si do ta ndryshojmë mendësinë apo ndërrimin e tyre? Qoftë edhe të Njëshit...

- Kjo gjë nuk bëhet menjëherë, kërkon durim dhe kohë.

- Po kohën njerëzit e bëjnë. Dhe kur koha kalon, çdo gjë bëhet edhe më e vështirë, ndoshta e pakohë. Aq më tepër që në PD po bjerret demokracia dhe theket autoritarizmi i Njëshit.

- Shqiptarët ende shkojnë verbërisht pas më të fortit, pas njëshit, jo pas arsyes.

U nder mes nesh një heshtje e mundimshme. Për herë të parë, në thellësi të tij vura re një trishtim të pashprehur. Asnjë herë ai nuk ishte thyer, ndoshta as tani, por gjithsesi mërzia e tij e dëlirtë më preku.

- Kur unë kandidova për kryetar i PD duke rivalizuar Berishën, Berisha ma largoi nga komisioni I numërimit të votave përfaqësuesin tim në atë komision. E dërgoi me shërbim në Shkodër, megjithëse ishte ditë e "dile"...

- E di. Kjo ndodhi edhe me mua, katër vjet më pas, kur kandidova për kryetar te PD. Përfaqesuesin tim në komisionin e numërimit të votave e hoqi nga komisioni. Shkak u bë flala ime në kongres, kur u duartrokita me thirrjet "Butka, Butka!" Atëherë Berisha thirri Ritvan Boden dhe i tha që ta hiqte përfaqesuesin tim mbikqyrës , kryerarin e PD te Kolonjës. Arsyeja është se ai, edhe kur është i sigurt që fiton, ka frikë nga vota e lirë, ka frikë nga kundërshtari zgjedhor, edhe kur ai nuk e rrezikon.

- Këtë ngjarje nuk e di, - tundi kokën në mënyrë mohuese , Pjetri. Di që kandidove për kryetar në një moment të vështirë për PD, kur PD-ja rrezikonte të mbetej vetem me nje kandidat, Berishën, pas largimit të Pollos.

- Megjithatë, ti je i fortë dhe i paprekshëm, i thashë sa për t'i ngritur humorin. Sa për të tjerët, si dihet se çdo të ndodhë.

- Askush sot nuk është i paprekshëm, por në mënyra të ndryshme. Edhe unë. Cari i PD-së ka ç't'i bëjëPjetër Arbnorit. Dhe, besa, i ka bërë boll, deri sa e ka lënë jashtë parlamentit dhe pa punë, pa rrogë. Është përjashtues. Ndërkohë, dua të punoj, qoftë edhe në administratën e PD-së, se jam në gjendje të mirë shëndetsore, por edhe sepse i kam fëmijët të vegjël.

Heshtje.

U ngritëm.

- Kur do të nisesh? – e pyeta.

- Nesër.

- Të vesh e të vish shëndoshë!

Po ai nuk u kthye.

Kishte ligjëruar në në konferencë ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut, që e kishte pike të dobët dhe devizë, mandej ishte operuar nga prostati, por për fat të keq bëri trombozë pasoperatore.

Iku pa pritur dhe i dëshpëruar nga kjo botë, Pjetër Arbnori.

Rexhep Ferri

KUSH E RRËZOI LIRINË NGA KALI?

ese

1.

Gjatë luftës e pas luftës së fundit kush e rrëzoi lirinë nga kali?
Jo vdekja, po njeriu!
Nëse do ta quajmë liri, a liri për njeriun qenka kjo!
Nga inati liri po i themi.
Dua të them edhe diçka tjetër.
Shi, shi, shi…
Zogjtë e qiellit po qajnë.
Jo shi…
Qentë po lehin, po lehin.
Për të humburit, të vdekurit e të pagjeturit edhe zogjtë e qiellit po qajnë.
Lotët janë për të jetuar.
Katundet, qytetet, toka, u dogjën.
Durimi dhe koha ku janë?
Ne që pahiri shpëtuam gjallë, kur u kthyem gjetëm nga një gjysmë shtëpie.
Shumë të vdekur e të pavarrosur na kishin pritur të kthehemi e t'i varrosim.
Gjatë kohës që i varrosëm të vdekurit nuk na vinte në mendje të përmendim fjalën liri.
Shtatoren e trimit të panjohur, e cila lirinë nuk e kishte parë me sy, si ta pagëzojmë?
Përsëritja hesht.
Kërkon të vërtetën.
Më falni për guximin.
Të shikojmë përpara.
Është mirë të mendojmë për ta mbledhur veten, vetes i thashë.
Mjaft në pritje.
Koha është për të guxuar.
Koha që mund të ndodhë.
Nesër, nesër.
Kur i gjejmë eshtrat e të pagjeturve?
Me syrin e botës pa qiell?!?!

2.

Për t'i vendosur gjërat në vendin e vet, fama patriotike na çmendi.
Herën tjetër do të jetë ndryshe.
Gjatë luftës së kaçakëve e hajdutëve të maleve e piratëve e hajdutëve të detit ka pasur më shumë gjuetarë se veteranë trima e patriotë.
Nuk e di se çka po flas.
Asnjë liri nuk është liri e plotë.
Për artin mistik, narcisoidi vret gjithçka…
Përtej kohës së dimensionit të errët është zia e bukës.
Thënë të vërtetën të gjithëve na kapë frika.
Siç e thashë më lart, asnjë liri nuk është liri e plotë.
Mbreti është mbret.
Duhet ta dijmë.
Pse të gënjejmë.
Kush do ta paguajë lirinë.
Askujt nuk i bëhet vonë.
Pritni pak.
S'mund të jetë e vërtetë.
Jeta është një arsye për t'u zgjuar në mëngjes.
Zemrën e çmendur fama patriotike e çoi peshë.
Më shihni kush jam?!
Jam e nuk jam.
E di që po mashtrohem.
Kur i mbyllim sytë, hapet mendja.
Kjo hapje e mendjes më befason.
Shoh atë që nuk e kemi parë.
Përtej shkronjave dhe fjalëve ç'marrim vesh?
Për çka është fjala?

3.

O, ish Njeri!
Nuk e kisha frikën tënde, e kisha frikën time.
Në mënyrë të paqartë.
Për tregtarët e flamujve mbeta humbës.
Në mënyrë të paqartë kishim qenë të pastër.
Të njohur e të panjohur.
Nga inati historinë e kuptoj me trishtim.
Në rrafshin e lutjeve njihemi mirë.
Liria kuptohet dhe dihet.
Vetëm mashtrime.
Qetësinë e lirisë së panjohur nuk duhet ta humbasim as në gjumë e as të zgjuar.
Qetësia e lirisë të shpie në një botë ku vetëm fizikisht plakemi.
Gjysma tjetër e jona është atdheu mitik.
Për një mit të ëndrrave që nuk e rrëfejmë.
"Gropat e syve i kemi të mbushura me dhe".
Kërkush nuk di të na tregojë ku jemi e çka mund të shohim.
Njeriu mes njerëzve vetëm për vetminë flet mirë.
Mendoj se çmenduria po i afrohet rrugës së qiellit.

4.

Nga poli i veriut iku dimri.
Arusha e bardhë i dha fund frikës.
Nga frika nuk fiton askush.
Bota përtej kohës ende është e paqartë.
Një ditë dhe dimensioni i tretë i një dite pa diell dhe i një nate pa hënë, kur harrojmë të pyesim veten çka mendojmë për Zotin.
Të gjithë nuk e dimë për çka nuk shihet dhe për çka nuk pyesim ku është.
Nga çasti në çast bota në flakë. Asgjë nuk mund të ndalet.
E gjithë bota është e pushtuar nga kiçi.
Nga frika.
Nga urrejtja.
Nga lufta.
Vetëm ish-Njeriu mendon se kjo është histori suksesi.

5.

Me shumë frikë nga historia e çmendur, e me pak dashuri për jetën e njeriut.
Kurrë s'e kam pyetur veten: A po na sheh Zoti?
E arsyeshme ta kuptojmë rrugën që po e ndryshon jetën.
Intelektualët evropianë me buzëqeshje e lot kurrë nuk reagojnë me kohë.
Dervishi i Kukësit që flen nën Urën e Vezirit më tha:
- Po ti ende nuk e paske kuptuar se intelektualët evropianë nuk e kanë pushtetin në dorë.
Ata janë vetëm maska për paradë që kërkohen për ëndrra mashtruese.
Deri te kufijtë e heshtjes jeta është ëndërr e vërtetë.
Mbretëria mbi tokë është çmenduri.
Qëndrimi narcisoid i njeriut nga shpejtësia e vetëtimës i mbylli sytë.
Me flamur të zbritur në gjysmështizë edhe deti mban zi.
Tmerri nuk flet.
Është fama e luftërave të humbura…

6.

Nuk kemi ç'besojmë më.
Ajo kohë i përshtatet së kaluarës.
Në këtë kohë, me një shprehje zemërimi, koha e ka kthyer kokën në anën tjetër.
Universi ndan, bashkon.
Pa gënjeshtra, Evropa mbetet me një shuplakë në fytyrë.
Për historinë pa histori.
Ata që flasin më rrallë jetojnë më gjatë.
Me një shikim më të gjatë gjarpri më tha:
- Unë e pyes ç'është kjo thirrje?!
Gjarpri për ta kuptuar vajin e burrave shkoi.
Nuk i besonte askush.
Larg syrit të keq.
Kemi fituar çka nuk kemi pasur.
Kemi humbur gjithçka që kemi pasur.
Nga historia e pashkruar asgjë nuk më kujtohet.
Nuk ka çmenduri më të madhe se mosnjohja e ditës ditë dhe e natës natë.
Në Teatrin Kombëtar shfaqet drama me titull "Natyra vullgare".
Është shumë personale.
Dënime dhe iluzione pa lejen e askujt nuk llogariten si e ardhme.
Kur njerëzit largohen nga vetvetja bishat bëhen male e malet fusha, e bishat e maleve kafshë shtëpiake dhe qeni besnik për çdo kënaqësi.
Ish-Njeriu nuk turpërohet të bëjë be rrejshëm.
Ndodh shpesh harrohen kohët, vitet.
Largësia kërcënon realitetin.
Uzurpatorët e rinj të shtetit, të ligjit e të pasurisë kombëtare e kanë rrokur me kufi e pa kufi.

7.

Si mendohet të jetojmë?
Asnjë përgjigje.
Shumëkush tha: Është një turp.
E ardhmja do të tregojë se ku kemi shkuar, ku kemi gabuar e ku kemi humbur.
Jeta po i ndryshon fjalët.
Unë nuk po e kuptoj kush e ka gabim.
Rreth llampës së ndezur, rreth dritës sillet fluturzeza përtej kujtesës.
Nga një e treta e jetës nuk mund të zbulojmë diçka tjetër e tjetër.
Lirinë jo!
Liria është e kërcënuar edhe nga lufta, edhe nga paqja.
Më falni për atë që thashë.
Në jetë ka një ndryshim të madh.
Me diçka nostalgjike.
Me diçka të harruar.
Nuk po e njohim më as vetveten.

"Parakalimi"-

Vijon nga faqja 6

bën pjesë edhe një element tjetër përbashkues, pra kali, që dihet më së miri që simbolizon lirinë si veprim dhe ëndërr. Pra, në konceptin e autorit, e dëshmuar në këtë fragment teksti, të dyja ngjyrat, bardhë e zi, janë në garë dhe në vrapim të pandërprerë, gjë që sigurohet nga fakti i përzgjedhjes së kalit, si simbol i lirisë dhe vrapimit, vështruar nëpër të gjitha kohërat, qysh prej antikitetit e deri në kohët moderne.

Dialogu identifikues

Në pikëpamje të teknikës shkrimore, pra të shpalimit letrar, të poetikës së dialogut, por edhe e veprimit, në këtë fragment të dramës së emërtuar Parakalimi, hetohet një tipar përbashkues/afrues, i lidhur ngushtësisht me natyrën e tekstologjisë së tragjedive moderne, qoftë në pikëpamje të identifikimit dhe shpalimit të personazheve, e po kaq të vetë ritmikës me të cilën shkëmbehen replikat. Materia e këtij teksti dramatik, pavarësisht se kemi me një fragment të shkurtër, pra end nuk kemi në dorë gjithë veprën dramatike (nëse ka një të tillë), por duke u nisur vetëmse nga sekuencat e tekstit, përpos të tjerash, na mundësohet:

- Identifikimi tipik i personazheve të fragmentit, si tipa dhe karaktere, si përfaqësues të tipave dhe mjediseve të caktuara, të pranishëm në këtë hapësirë, sepse përgjithësisht ligjërimi dialogues i tyre, replikat e ndezura, në atë ritmikë dhe ngjyresë, veçon dhe tipizon protagonistët e fragmentit, si Vetoni, epiqendra e fragmentit të dramës, Ekremi dhe Nana. Kjo e fundit, në skenën vjen fillmisht si za, e mandej si prani fizike, duke u bërë më interesante si figure e skalitur e këtij teksti, në kuptimin e befasisë që buron nga paprania e pritjes, si figurim karakteri.

- Identifikim i plotë karakterizues, tipikisht gjuhësor, batutat e shkëmbyera kaq rrufeshëm, ku përbashkësia e lavrimit të gegnishtes dhe të gjuhës së njësuar, jo vetëm nuk ka penguar nuancat dallimore, të mënyrave të veçanta të ligjërimit, përkundrazi ka qenë një mënyrë e gjetur, estetike dhe karakterizuese, e tipizimit dhe karaketerizimit të tyre, si tipa dhe figura të skalitura, që bartin psikologjinë e kohës. Kështu zani i Nanës, përpos të tjerash, në fakt në atë kontekst dramatik, na sugjeron një prani fantastike, të natyrës së jashtëzakonshme, teksa shprehet:

- Prrallën? ... At kalin e bardhë si bora e paske pa në andërr?! Tiparin e jashtëzakonshëm, si tonalitet dhe ngjyresë fantastike, cilësi letrare e rrokshme në një pjesë të krijimtarisë së autorit, pra në prozë dhe dramatikë, që e përpush frazën në një gjendje të ngritur estetike. Ky tipar shkrimor bëhet më i prekshëm në tregimet fantastike, por e ruan me funksion letrar kur shprehet si Nana, teksa thotë:

Kali i bardhë edhe ma tutje hingëllonte në kodër. (2005: 311), që përfaqëson vetëm njërin krahë të simbolikës së ngritur, në situatë dramatike në këtë fragment, pra vetëm të bardhën dhe fatbardhësinë. Nga ana tjetër, vetë pohimi i Vetonit, në njërin nga episodet, një figurë mirëfilli realiste, që ndërkaq bart atributet e një situim tjetërsojshëm:

- Sot asht afati i fundit për me dorëzue njifarë punimi në redakësi. , që duket se e zbret situatën dramatike të këtij fragmenti, në realitetin konkret, në kohën reale të një ngjyrese autobiografike, madje duke krijuar gjasën, që mundet me bisedu shlirshëm, pa drojë dhe ngurrim, për kuajt e bardhë dhe të zinjë, të cilët përveçse janë një vështrim metaforik krejt i rrokshëm, shpërfaqin një situatë dramatike simbolike, që e anëson fragmentin nga ngjyresat e tragjedive moderne.

Pyetësori "Librat e jetës sime"

FRANO KULLI

Libri me të cilin dua të mbahem mend?

Fjalori i veprës së Fishtës, me fjalë dhe shprehje frazeologjike nga kolana e veprës së tij.

Libri që po lexoj ndërkohë

"Antologji me tregime italiane"; Italo Calvino, Dino Buzzati, Umberto Saba, Domeniko Rea Achile Campanile, Grazia Deledda etj. I jam rikthyer mbas leximit të para do viteve.

Libri që më ka ndryshuar jetën

Është e vërtetë e njohur qyshsekur, që librat kanë fuqi të magjishme mbi formimin e personalitetit të njeriut. Dhe, padyshim, që njeriu lexues e ka përbrenda vetes përftimin e magmës së librave të lexuar; ajo e ndjek atë përgjatë gjithë jetës, është si të thuash si një gen i shtuar, i përftuar në gjallesën e tij. Unë s'mund të veçoj një të tillë, po mund të përmend disa: Sergej Esenin "Lirika", Ndre Mjeda "Juvenilja", Eduard Bagrickij "Nata e fundit", Frederik Rreshpja, "Në këtë qytet" , Walt Whitman: "Fije Bari"...

Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

"Shqipëria një dhe njëmijë", Indro Montanelli, publicistika e Fishtës, shkrimet e Konicës, proza e Migjenit...

Libri që më ndryshoi mendjen

Nuk besoj se mund të ketë libër që ke lexuar dhe diçka nuk të ka ndryshuar në mendje.

Libri i fundit që më bëri të qaj

"Letër gruas së vdekur", Gjovalin Gjadri, më ka bërë të përlotem. Këtë e mbaj mend si ndodhi të freskët, të para pak më shumë se një viti, ndoshta.

Libri i fundit që më bëri të qesh

"Don Kishoti", "Ushtari i mirë Zhvejk"... më kanë ba me qeshë gjithë jetën. Kur më është vjetrue e qeshura u jam kthyer përsëri. Duke i alternuar me "barceleta italiane". Kurse e qeshura që mban më gjatë në leximet e viteve të fundit është ajo që kam përftuar prej trilogjisë romaneske të Stefan Çapalikut "Secili çmendet simbas mënyrës së vet". Ndër më të mirëpriturit libra të 3-4 viteve të fundit. Sigurisht, për shumë më shumë se të qeshurën... Kurse "Një antologji e vogël e jetës", përposë një eseje të gjatë ka edhe njëqind e pesëdhjetë barcaleta të zgjedhura shqiptare. E ta "mban gazin n'dërrasë".

Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende

Janë disa, po ti mos më turpëro edhe më, duke më kërkuar të bëj listën e tyre. Po ndjesinë më të fundit të turpit po ta them."Quo vadis" të Henryk Sienkiewicz e kam lexuar vetëm para do muajsh, një përkthim i plotë dhe i shkëlqyer i Laura Lekës.

Librat që kam dhuruar:

Unë, jo vetëm libra nga të mijtë, sigurisht për miqtë, por, duke qenë botues kam dhuruar edhe libra të të tjerëve. Ndonjëherë, rrallë, ka ndodhë që edhe jam penduar. Bie fjala për kolanën në 5 vëllime të Anton Harapit. Kam dhuruar kopjen e bibliotekës sime, me idenë se do të blej tjetrën për vehte, po ja që më ka rrëshqit e...sot s'kam ku e gjej se nuk është më në treg. Etjerë e tjerë këso dore. Pa përmendur këtu kolanën e Fishtës, në 10 vëllime, bie fjala, po ai është botim i yni... E të dhurosh libra aty ku bëhen libra është gati si të ftosh kalimtarin, që rruga i bie andej pari kah baçja jote për me hanger do kokrra fiq.(una moda vechia, e di...)

Libri me të cilin dua të mbahem mend

Fjalori i veprës së Fishtës. Një fjalor me fjalë dhe shprehje frazeologjike nga kolana e veprës së tij. Me nja rreth 11 mijë leksema e terma të spjeguara, ku fjalëformimi zë peshë dhe është një prurje tepër e vlertë për gjuhën shqipe.E kam çmuar si një pjesë komplementare të domosdoshme për ta njohur e shijuar veprën shumëdimensionale të poetit kombëtar. Për fatin e keq të *blackout*-it (ndërprerjes) gjysëshekullor që ajo pati.

Del nga shtypi për punë ditësh.

Libri që me bën të ndihem mirë

Libri që s'ma ofron këtë ndjesi...e heq nga dora pa e lexuar.

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar:

Libri shqip, në përgjithësi. I pakvlerësuar e jo i përzgjedhur mirë prej ne botuesve, i nënvlerësuar prej politikave kulturore, i llapaçitun (përzjerë uji me baltë) prej propagandës mediokre të mediumeve, i mungesës së kritikës letrare që do të mund të orientonte sadopak në selektimin e "miellit" prej "krundeve".

Mbetet, për fat vetëm nuhatja, ende e mirë e lexuesit, që librin e mirë shqip e përpin.

”Shënime për novelën "Princi i gjurulldisë" të autorit Endri Vajella

Koha letrare dhe koha historike, në një novelë

Nga Namir Lapardhaja

“...Kur Shqipëria është bërë lëmsh e lëmë, një njeri del nga mazgallat e saj dhe i futet në histori. Ai ngjitet në të përpjetën e karrierës me një frymë rrufeje, nëse mund të ketë karrierë brenda një vorbulle. Brenda 6 muajsh ai, njeriu me xhurdi e me brekushe, vesh kapotën e gjeneralit. Pas pak del si komandant i përgjithshëm. Për të thonë se e kanë kapur xhindet, thonë se është i marrë, ndërsa dikush e karakterizon si Princ i Gjullurdisë.

Udhëheqës intrasigjent në një vend pa rrugë, peng i fatit të tij të shënuar nga lart, ky është Haxhi Qamili, më i famshmi, më i shquari dhe, pa dyshim, më i madhi analfabet i Shqipërisë në vitet 1914-1915...”

Kështu nis rrëfimi i ngjarjeve në novelën “Princ i Gjullurdisë”.

Po të heqësh emrin e Haxhi Qamilit në fragmentin e mësipërm, do të shohësh se në këto 100 e ca vjet shtet shqiptarë, nuk kanë qenë të paktë të marrët, të paaftët dhe të çoroditurit, të cilët i kanë rënë këtij vendi kryq e tërthorë, duke bërë rrëmujë, duke manipuluar, duke bërë marrëzi e prapësi, duke u shfaqur si shpëtimtarë dhe atdhetarë, si baballarë të kombit dhe si të përzgjedhur, si të përndritur dhe si të pagabueshëm.

Më shumë se sa me një emër konkret, kemi të bëjmë me një fenomen, “cikli i të cilit patjetër do të përsëritet...të paktën edhe për 100 vjet, sepse këtu, më shumë se sa shkure, harlisen përralla aziatike dhe bizantine”.

Që në titull na jepet një kontrast i fortë. “Gjullurdia”, si zhurmë e madhe, potere, nuk mund të qëndrojë e pranëvënë me fjalën “Princ”. Vet fjala e zgjedhur shërben si çelës për të shprehur mendjen tonë të rrëmujshme. Nëntitulli, “Letrat e Haxhi Qamilit”, na tregon se ngjarja do të tregohet nëpërmjet letrave.

Koha letrare, për të cilën flitet në vepër, është Shqipëria e viteve 1914-1915, kurse koha historike, në të cilën është shkruar, është 27 dhjetor 1997-mars 1998.

Janë dy periudhat e mbrapshta në të cilat ka kaluar vendi.

Mos, vallë, autori bën aluzion dhe heq paralele mes të dyja?

Nuk përjashtohet si mundësi, por personalisht besoj se një vepër që të jetojë duhet të përfshijë një shumësi leximesh dhe interpretimesh.

Për Umberto Eco-n, teksti është i thurur me shenja dhe hapësira të bardha që duhen mbushur dhe ai që i ka krijuar parashikonte që ato do të mbusheshin dhe i ka lënë të bardha për dy arsye: 1. Sepse teksti është një mekanizëm dembel, që jeton me vlerën e shtuar të kuptimit që i futet nga marrësi; 2. Një tekst kërkon që dikush ta ndihmojë të funksionojë.

Autori i “Princit të Gjullurdisë” na merr prej dore, na shtron rrugën dhe na drejton për tek bëmat e protagonistit të tij, ku, nëpërmjet 30 letrave, një prologu të shkruar nga Edmond Konn (1915), një tjetër anonim i përzgjedhur nga autori anonim i veprës, një epilogu, që shërben si amanet i Haxhi Qamilit, po pa i shkuar ngjarjeve deri në detaj, na portretizohet një figurë donkishoteske dhe qesharake, i cili, ndonëse me disa nota drejtësie brenda vetes, dëmi që shkakton nëpërmjet rrugës së gabuar që ndjek, është shumë më i madh se sa dobia. Rrëfyesi na përcjell tek ato dhe na e lë neve interpretimin, duke dashur të na bëjë bashkëpjesëtarë të ngjarjes.

Kemi të dhëna konkrete, personazhe, data dhe ndodhi të njohura në histori, mirëpo autori i tyre, duke qenë njohës mjaft i mirë i letërsisë, ka zgjedhur të luajë deri në fund, sepse një tekst është padyshim rezultat i një strategjie të caktuar, të zgjedhur nga vet autori, dhe lexuesi duhet të jetë i aftë për të bashkëpunuar në aktualizimin dhe kuptimin e tekstit, ashtu si autori e ka menduar.

Autori krijon një botë fantastike, të cilën e merr shumë seriozisht, duke e ndarë atë qartë nga realiteti.

Siç thoshte Frojdi, “nga bota artistike joreale dalin pasoja shumë të rëndësishme për teknikën artistike, sepse shumë gjëra që si objekte reale nuk do të na jepnin kënaqësi, në kuadrin e lojës së fantazisë për dëgjuesin dhe shikuesin e krijuesin bëhen burime kënaqësie, megjithëse në fakt janë ngacmime munduese”.

Le të ndalemi për pak dhe të shohim se çfarë ishte në të vërtetë revolta që shpërtheu në Shqipërinë e vitit 1914 dhe se si ajo është parë nga bashkëkohësit.

Në ndihmë do të thërrasë një mendje të ndritur të kombit, një aktor të rëndësishëm të kohës dhe një atdhetar të madh, Midhat Frashërin:

“...Opinioni dhe përshtypja e përgjithshme kanë qenë se shqiptarët myslimanë ishin revoltuar kundër një mbreti të krishterë dhe se kudo në Shqipëri kishte një revoltë që rridhte nga fanatizmi fetar... Në fakt, revolta kishte shpërthyer në Shqipërinë e Mesme, në rrethinat e Durrësit dhe, më saktë, në krahinën e Shijakut, Tiranës, Krujës, Kavajës dhe Peqinit.



Nuk bëhej fjalë, pra, aspak për një revoltë të përgjithshme për të gjithë Shqipërinë; ishte një lëvizje lokale në fillim dhe aspak e diktuar nga ndjenjat e fanatizmit fetar. Motivet e kësaj lëvizjeje u bënë më të shumta dhe më komplekse seç mendohej.”

Më tej Frashëri thotë se për të kuptuar origjinën e ngjarjeve të atij viti, duhet parë konteksti i Shqipërisë së kohës, rrethanat historike si edhe situatës së brendshme dhe të jashtme.

“Ishte një Shqipëri e pakësuar në 2/3 e territorit të saj dhe akoma duhej pasur parasysh humori i keq i grekëve, serbëve dhe i Fuqive të Mëdha, të cilat i mbronin ata dhe i inkurajonin.”

“Ky humor i keq, - vijon më tej ai, - u shfaq në një mënyrë shumë të përgjaktë: serbët hakmerreshin ndaj 30 fshatrave midis Elbasanit dhe Dibrës dhe grekët ushtronin tërbimin e tyre në më tepër se 300 fshatra të jugut të Shqipërisë; krahinat.... të Gjirokastrës, Delvinës, Tepelenës, Kurveleshit, Përmetit, Skraparit, Kolonjës, Leskovikut, ishin kthyer në shkretëtirë dhe në pjesë të shkatërruara.”

Qeveria e Vidit u tregua e pafuqishme ndaj kësaj situate të re të krijuar në të gjithë territorin e vendit.

Midhat Frashëri thotë, gjithashtu, se në këtë situatë “duhet shtuar mungesa e aksesit midis Fuqive të Mëdha, përfaqësuesit e të cilave formonin Komisionin e famshëm ndërkombëtar të Kontrollit në Shqipëri: antagonizmi ndërmjet këtyre përfaqësuesve ishte mëse i dukshëm dhe rivaliteti i tyre ushtrohej në kurriz të Shqipërisë”.

Pas kësaj optike realiste, le t’i kthehemi ngjarjeve ficionale të novelës sonë.

Stili konician, rrëfimi lakonik, ironia therrëse, humori i zi, na tregojnë se kemi të bëjmë me një shkrimtar me shije të holla artistike.

“Princi i Gjullurdisë” është vepra më e mirë e shkruar nga Simon Vrusho.

Nëse botuesi nuk do ta kishte vendosur me shkronja të vogla në kopertinën përmbyllëse të botimit të dytë se emri Endri Vajella është pseudonim i Simon Vrushos, do të kishte rrezik që ne të mos e merrnim vesh kurrë të vërtetën.

Ndonëse i fshehur pas anonimatit, Simoni kishte vizionin dhe aftësinë për të na treguar se armiku ynë kryesor është injoranca dhe fanatizmi, se marrëzia nuk ka një kohë dhe një vend të caktuar.

Ajo jeton brenda nesh dhe mund të shfaqet në çdo moment.

Unë e imagjinoj se si mund të ndihej sot nëse do të ishte gjallë Simon Vrusho dhe të shihte se si personazhet e tij kanë nisur sërish të enden lart e poshtë nëpër Shqipëri, këtë radhë me damkën e të “mallkuarit” mbi shpinë, duke rrezikuar të përsërisin vetveten, veçse këtë herë tragjedia ia ka lënë vendin komedisë, duke përhapur marrëzi dhe duke u mbështetur nga “dum babsat” e rinj.

DANISHI

tregim nga

Istref Haxhillari

Në atë stinë qytetin e mbështillnin tufa të dendura mjegulle të hirtë me damarë kaltëroshë të spërdredhur. Masivet e mëdha rridhnin përmbi kala, gëlltisnin pallatet, lëpinin syprinën e dallgëzuar të ujit, mbanin të nënshtruar tokë dhe ujë.

Rrjedhat e mjegullës ishin ndër dhuratat e liqenit vjetarak.

Danishi i rrëgjuar kockë e lëkurë çapitet rrugëve, pa ndonjë drejtim të caktuar, thjesht nga e çojnë këmbët. Me thesin e vjetër prej kërpi, hedhur në sup, zvarritet trotuareve pa shikuar njeri. Krahun e djathtë e ka humbr në moshën e fëmijërisë. Askush nuk e di ndodhinë e trishtë, fashitur thellë kohës së largët. Atij s'i kujtohet ose nuk do ta përmendë, si shumicën e andrallave të jetës së tij të gjatë. Në sytë pa ngjyrë, futur thellë zgavrave, pasqyrohet vuajtje e madhe, uria e përditshme. Ndoshta më shumë se kaq.

S'i ndan brengat me të tjerët, nuk ankohet, as lyp.

Njerëzit kthejnë kokën, thua nuk ekziston. Pamja e tij njëlloj u vret sytë, i ligështon, ndaj i shmangen si mortajës. Danishi vazhdon të jetojë në mjerimin e vet pafund me lëngatën e shpirtit të panjohur, të pa rrëfyer...

Anidi e shikon çdo ditë nëpër kazanët e plehrave. Rrëmon, fut rrëmujshëm në thes çdo send të dobishëm, sidomos ato ushqimore. Me krahun e vetëm në garën e pabarabartë të jetës lufton sipas mënyrës së tij t'i mbijetojë një bote tejet indiferente dhe përbuzëse.

Vjeshta rrëzëlluese kapërthyer me mjegullën e dendur në një ndeshje të shurdhër, nuk i bën përshtypje, madje nuk e di tamam në është pranverë apo vjeshtë. Era memece, lavire e paskrupullt e provokon, i gudulis thinjat e hirta tëmthave. Përmbi grumbullin e mbeturinave, gjethet e blirit me buzët e verdha lëpijnë lëkurën e rrudhur, të zbuluar.

Anidit nuk i ngjall neveri si të tjerëve. Në muzgun e bronztë të një dite të tillë e ndaloi gati me pahir.

- Më njeh?

Ai deshi të largohet, po tingulli i zërit të ngrohtë e bindi.

- Jo, nuk të njoh.

- Anidi. S'e thoshe dot emrin, më thërrisje Ani.

Burri i moshuar i hodhi sytë e ujshëm, të shpërqendruar, u mendua një copë herë, tundi kokën në shenjë mohimi, u mat të largohej, por ai s'e la. E pyeti si jetonte, në se kishte njeri të afërt. Danishi nuk e dëgjonte. Shikonte andej - këtej si i mbytur në punë të ngutshme. Po e pengonin kot së koti.

Pamja e lemerishme përtej mjerimit prekte cakun e marrëzisë.

Anidit i bënë përshtypje veçan sytë e shuar të çngjyrosur, pa asnjë shprehje njerëzore. Vetmia e pazakontë strehuar te ai trup i rrëgjuar e pikëlloi. Shkëndijëzat e kujtimeve të përcëlluara në hirin e harresës u zgjuan si bletë zemërake. Vitet kulluan harrimin e gjatë, përjetimet e largëta buisën nga thellësia e kohës shkollore...

Vite të shkuara ishte roje në konvikt. Ndonëse rrotull të tridhjetave, të vegjlit e thërrisnin xha Dane, të rriturit Danish. Dora e vetme bënte me lehtësi të habitshme çdo lloj pune. Priste dru, ndizte zjarret nëpër dhoma, ndihmonte kuzhinieret. I kudogjendur, zvarriste mbi kurriz si tani një thes mbushur me ushqime, e çonte ku i thoshin. Nuk pushonte kurrë. Kur prehej diku qosheve të oborrit, me dorën e vetme shtrëngonte pavetëdije copa qymyri nga togu përreth magazinës.

Natën hynte nëpër dhoma, mbulonte grindavecët që rrëshqisnin batanijet në netët e acarta të qytetit të liqentë, u lëvizte kokën gërhitësve zhurmëmëdhenj, mbyllte dritaret hapur nga era.

Jetën e tij e mbështillte një mister i pa kuptuar. Askush nuk e dinte kur flinte, ku banonte, kishte shtëpi, njerëz të afërm. Konvikti ishte vendi i punës, vatra ku fillonte e mbaronte universi i tij. Qëndronte aty të dielave, ditët e festave, pushimeve të verës kur konvikti rikthehej sërish në kamp pushimi. Vazhdonte njëlloj, me të njëjtin ritëm monoton punën e tij të çmuar. Mjediset e konviktit humbnin diçka kur mungonte ai, nxënësit pyesnin njëri - tjetrin me sy. Konviktorëve të larguar nga shtëpia dhe njerëzit e afërm, Danishi u kujtonte prindërit. Ndonëse fjalëpakë, jo fort i afruar, e donin, ndiheshin mirë kur e kishin pranë. U sillte ndërmend shtëpinë, ndillte ca kujtime të ëmbla e të shtrenjta, lënë pas diku larg...

Dita e parë e shkollës gazmonte nga zhurma e nxënësve. Sillte risi, çelte një vit tjetër me të panjohura të këndshme. Përqafoheshin të malluar me njëri - tjetrin, tregonin jetën e verës, bërtisnin plot hare.

Gazmendi i asaj dite të bukur u ndot papritur.

Një djalë i panjohur muskulor i zuri derën Lenit, nuk e linte të futej në konvikt. Mbështetur pas parmakut anësor e kërcënonte haptas. Shqetësimi shpërhapej si hije e zezë në tërë hapësirën e shkollës. Adoleshentët vështronin të merakosur shoqen zënë në çarkun e së keqes. Asnjëri s'guxonte të përballej me horrin mendjemadh dhe thikat kërcënuese ngjeshur rripit të mesit.

Hareja ngeci te porta e shkollës.

Danishi paqësor i kërkoi butësisht të hiqte dorë nga ajo punë e mbrapshtë. Tjetri nuk i vuri veshin, vazhdoi të tijën. Leni e skuqur e turpëruar, dridhej e tëra me sytë nga oborri i shkollës. Danishi u afrua, deshi ta largojë me të mirë po tjetri, pa e shikuar drejt, ia ktheu ashpër:

- Ik dorac, se do të hash ndonjë që të vijë mendja rrotull?

Mbi ballin e qetë të rojës u formuan rrudha të thella, damarët e llërës së vetme të përveshur lëvizën si gjarpërinj zgjuar nga dremitja e gjatë. Zemërimi u kacavar me thonj të lyer nëpër copëzat e qymyrit të kuzhinës. Nxënësit nuk e kishin parë kurrë në atë gjendje të frikshme burrin e mirë, rojën e urtë të konviktit, që nuk i bënte keq askujt.

Lëshoi ngadalë thesin. Kur askush nuk e priste, me shpejtësi rrufeje e goditi befasisht në mjekër me një grusht që do ta kishte zili çdo kampion boksi. E majta e tij mbartte fuqinë e përbashkët të dy duarve. Guximtari i paskrupull u shtri përtokë i larë në gjak. Si vuri re Danishin të afrohej për të çuar deri në fund punën e nisur, iku i tmerruar me vrap duke sharë.

Të gjithë u mahnitën nga guximi i rojës. Trimi i shfytyruar vajti të lante surratin e gjakosur. Xha Dania, pafolur, si të mos kishte ndodhur asgjë, rrëmbeu thesin, u qas pranë grumbullit të qymyrit ku rrinte të shumtën e kohës. Shndërrimi i çuditshëm, i vetëtimtë u mbeti në kujtesë për një kohë tejet të gjatë. Shpesh e kujtonin me admirim sa herë e sillte rasti nëpër rrjedhat e spërdredhura të kohës.

Kështu e mbante mend Anidi këtë burrë të thjeshtë e të mirë. Ç'fat i mbrapshtë e kishte gremisur në ditë të hallit?...

Teksa kujtimet, si rrjedha mjegulle zevzeke, i sollën kohën e shkuar, Danishi i ktheu shpinën, gërmonte gjithë zell plehrat në një rit mjeshtëror të neveritshëm.

Anidi uli kokën i trishtuar, zënë në faj.

Ata sy të pajetë, pasqyrë lebetie, ngjanin me një humnerë të çuditshme, që nuk kthen jehonat e zërave, i mban brenda me xhelozi, i ndrydh në gjirin e vet. Njerëzit do të shkundeshin nga lemeria po ta dëgjonin të çliruar kumbimin e asaj klithme të honshme...

Vjeshta indiferente fshikullonte qytetin buzë liqenit me rrjedha mjegulle tinëzare.

Mbrëmje prilli në një qytet të ngujuar nga pandemia

Cikël poetik nga Anton Papleka

PLACE DE LA CONCORDE

Place de la Concorde
Nga ku rrugët nisen
Si fijet e gjata
Të mjekrës së një Magu oriental
Të shpërndarë në kraharorin e qytetit...

Place de la Concorde, 11.6.2021

VERË

Të mërzitur nga të ftohtit dhe vetmia e dimrit
Drurët sajojnë hijet e tyre
Si Adami që krijoi nga brinja e tij Evën
Dhe ata çiftëzohen faqeza të gjithëve
Tërë ditën e lume
Nën syrin xheloz të Diellit përshkënditës...

Bois de Boulogne, 20.6.2021

VAKSINIM

Shiringa
Gjigante
E Kullës
Eiffel
E mbushur
Me vaksinën
E dritës
Së Parisit
Shpon
Supin
E rrumbullakët
Të qiellit të kaltër
Për ta imunizuar
Kundër pandemisë
Së natës së errët...

Paris, 4.7.2021

PEMËT E THARA

Sipas një balade shqiptare

Ditën që kishte pritur të dashurin
Pas një ndarjeje të gjatë
Ajo kishte dalë herë pas here te pragu i shtëpisë
E përvëluar nga dëshira

Përkundër padurimit të saj
Ajo kishte mundur ta shihte të dashurin
Vetëm pasi ai kishte kaluar midis pemëve të mbjella
Në oborr të shtëpisë
Dhe kishte mbërritur para pragut

E zemëruar kundër gjethnajave të pemëve
Që e kishin penguar ta shihte më shpejt të dashurin
Duke ia rrëmbyer disa minuta
Kur ajo mund të ishte gëzuar nga mbërritja dhe pamja e tij
E dashura u kishte lëshuar mallkimin pemëve
Duke i nëmur që ato të thaheshin menjëherë

Për çudinë e saj
Sapo e kishte nxjerrë nga goja fjalën e fundit
Pemët e gjelbëruara në oborr të shtëpisë
I kishin humbur menjëherë frutat e gjethet
Ishin tharë në këmbë si të ishin djegur nga rrufeja

E dashura që kishte nëmur pemët e gjelbëruara
Ngaqë e kishin penguar ta shihte më shpejt të dashurin
Nuk e kishte lexuar mitin për Psikenë dhe Erosin
Të shkruar nga Apuleu
Ajo nuk dinte gjë për dashurinë midis Tristanit dhe Izoldës
Nuk dinte gjë për dashurinë midis Dantes e Beatriçes
Midis Petrarkës e Laurës
Ajo nuk i njihte as emrat e tyre
Por besonte se dashuria ka një forcë të mbinatyrshme
Ajo besonte se një njeri i dashuruar është i barabartë
Me një hyjni
Siç e dëshmojnë pemët e thara nga mallkimi i saj
Që shekujt e mëpastajmë me karvanet e reve të tyre
Nuk mundën t'i gjelbëronin sërish

Ato pemë janë të dënuara të mbeten të thara përjetësisht
Në kopshtin e një balade
Kushtuar dashurisë njerëzore që është e barabartë
Me dashurinë e perëndive...

MBRËMJE PRILLI NË NJË QYTET TË NGUJUAR NGA PANDEMIA

Mbrëmja e prillit iu afrua në majë të gishtave qytetit të heshtur
Me rrugë e sheshe ku shëtiste vetëm hëna
Me këmbët e saj gjatoshe e thatanike si gjymtyrët
E statujave të Giacometti-t
Buzë rrugëve bari rritej si mjekra dhe flokët e të burgosurve
Që dergjeshin në qelitë e kullave mesjetare
Lulet u ngjanin gurëve të çmuar dhe stolive prej ari
Të mbyllura në hambarin e një karavele të mbytur
Të gremisur në thellësitë humnerore të oqeanit
Ku nuk mund të mbërrinin vështrimet dhe duart e njerëzve
Trëndafilave nuk u kujtohej më se ata mbanin erë të mirë
Se ishin simbol i dashurisë i xhelozisë apo i pafajnisë
Pemët e parqeve midis të cilave kishin lodruar fëmijët
Zinin të monologonin si princi Hamlet
« To be or not to be ?"
Pëllumbat qaheshin se e kishin harruar ngjyrën e tyre
Dhe kërkonin të takonin një njeri për t'ua thënë
Bilbilat i kapërdinin dredhulet e zërit për të protestuar
Kundër spektatorëve të tyre që kishin braktisur
Sallat e parqeve e të pyjeve
Takimet grumbulloheshin te hyrjet dhe stacionet e metrosë
Duke pritur mbërritjen e të rinjve për t'i marrë për vete
Në hapësirë vërtiteshin andej-këndej lasso-t e përqafimeve
Duke u orvatur të kapnin mustangët e paarritshëm
Të zbrazëtisë e të mungesës
Të puthurat e zjarrta kërkonin me dëshpërim
Buzët e të dashuruarve që mungonin
Pastaj shkonin të zhyteshin në ujërat e ftohta
Të Senës së vënë në pranga nga urat e saj
Të Senës që e përdridhte trupin midis brigjeve prej betoni
Duke lypur përgjatë moleve të shkreta
Lëmoshën e lundrimit të një anijeje turistike
Për t'i dhënë fund agjërimit të këtyre kreshmëve të papritura
Sena i përgjërohej më kot për ndihmë Kullës Eifel
Ku ashensorët e ndalur dukeshin si kovat e zbrazura të noria-s
Buzë një lumi të shterrur nga një thatësirë e skajshme

Ose kishin ngecur si kujtimet dhe mendimet e nguro-
sura
Në rrudhat e trurit të një personi që ka rënë në
koma...

Paris, 21.4.2020

MARRËDHËNIET SEKSUALE DHE MARRËDHËNIET TEKSTUALE

Qysh nga shpikja e shkrimit
Marrëdhëniet seksuale të njerëzve janë shoqëruar
Nga marrëdhëniet tekstuale të librave ose anasjelltas
Mbizotëron mendimi se marrëdhëniet tekstuale
Janë po aq të natyrshme sa marrëdhëniet seksuale
Ose anasjelltas
Nuk ka çifte pa marrëdhënie seksuale ashtu siç nuk
ka libra
Pa marrëdhënie tekstuale ose anasjelltas
Librat që ngjizen nga marrëdhëniet tekstuale janë
po aq
Të natyrshme sa fëmijët që ngjizen nga marrëdhëni-
et seksuale
Ose anasjelltas
Ngashënjimi i marrëdhënieve tekstuale është po aq
I papërballueshëm sa ai i marrëdhënieve seksuale
Ose anasjelltas
Personat që kanë lidhje intime janë të prirur të kenë
Marrëdhënie seksuale ashtu si librat që kanë përm-
bajtje
Të përafërt janë të prirur të kenë marrëdhënie tek-
stuale
Ose anasjelltas
Nuk mund të thuhet se marrëdhëniet seksuale
Janë vetëm me natyrë trupore kurse marrëdhëniet
tekstuale
Janë vetëm me natyrë shpirtërore ose anasjelltas
Mohimi ose ndalimi i marrëdhënieve seksuale
Do të çonte në shterpësi ose në shuarje të njerëzimit
Ashtu si mohimi dhe ndalimi i marrëdhënieve tek-
stuale
Do të çonte në shterpësi dhe në shuarje të letërsisë
Ose anasjelltas
Marrëdhëniet seksuale të njerëzve dhe marrëdhëniet
Tekstuale të librave nuk bëjnë gjë tjetër veçse imito-
jnë
Polenizimin e bimëve çiftëzimin e kafshëve të yjve
E të mjegullnajave
Marrëdhëniet seksuale dhe marrëdhëniet tekstuale
Janë pasqyra magjike falë të cilave shumëfishohen
Vazhdimisht njerëzimi dhe letërsia...

DORA E PANJOHUR

Sa herë që shpirti im i kapitur e ka ndier veten
Si ai që ecën në një diell përvëlues
Që është gati ta braktisë vrapimin e tij e të largohet
nga pista
Duke harruar gjithçka: emrin jetën e vrapimin e tij
Që befas sheh një dorë të panjohur t'i afrohet
T'i japë një shami të pastër e të freskët
Për të fshirë ballin e tij ku djersa rrjedh çurg
T'i japë një pagure të mbushur me ujë burimi
Të cilin e pi me gllënjka të mëdha
Dhe pasi e pi atë ujë të kulluar e të ftohtë
E ndien veten të përtërirë e të gjallëruar
Të vendosur të sfidojë shterjen e fuqive dobësinë
Mosbesimin
Pa u shqetësuar nëse kurora e dafinave
Do të rrethojë ballin e tij apo atë të një tjetri
Madje pa menduar fare për fitoren a për disfatën
Duke pasur në kokë vetëm idenë
Për t'i shkuar deri në fund vrapimit të tij

Asnjëherë shpirti im nuk e diti çfarë ishte
Ajo dorë e panjohur...

Meditim për Vath Koreshin në ditët e Festivalit të Filmit në Tiranë

Nga Olta Gaçe

Produksioni i Pare Zyrtar me sistemin e Ri te Financimit te Kinematografise ne Shqiperi eshte filmi shqiptar " Dasma e Sakos", me skenar te shkrimtarit Vath Koreshi dhe regji te Vladimir Priftit.

Shkrimtari Vath Koreshi u dimensionua ne tregimin e shkurter, me ndjeshmeri te holle prej poeti. Ne rrafshin e romanit te shkurter shkelqeu si pakkush.Tregimet ishin paraprijese. Por ato nuk mund ta perkufizonin teresisht Vathin. Keshtu, Vathi levroi romanin e shkurter , duke bere risi te vertete artistike. Ai shkelqeu me romani " Ulku dhe Uilli". Ky roman ka nje vesk buzikian, ka nje intrigim inkadeshent per situatat dhe te ardhmen , nje heroizem te heshtur, por te patjetersueshem . Ky roman ka pasur nje admirim te madh te lexuesve , jo vetem ne Shqiperi , por edhe ne Kosove. Romani "Nje grua me te verdha ne pyllin e Budhas", ka qene per Mua libri me i vecante dhe me i papritur. "Gjej nje grua veshur me te verdha" e barazvlefshme me " Gjej nje flamur qe t'ju prije ne rrugen e shpetimit nga vuajtja! Perndite zoterojne vdekjen, kurse njeriu ka ne dore dashurine".

Opusi i Vath Koreshit , nuk mund te kuptohet pa skenarin kinematografik. Ai qe shkrimtari me i sukseshem i skenarit ne Shqiperi. Ne njefare menyre, Ai do te mbetet si nje patriark i skenarit, krijues i nje shkolle.

Vathi qe me i thelle, me i vemendshem , se skenari nepermjet artit te kinematografise, mund te kete nje ndikim shume here me te madh sesa librat.

Filmat me skenaret e Vath Koreshit, e kane te gatshme regjisuren, ato tashme jane Emblematike.

Janë 21 filma me skenar të shkruar nga shkrimtari i paharruar Vath Koreshi.

Novela "Dasma e Sakos" eshte shkruar ne periudhen komuniste. Linja te tera te kesaj novele moren drejtime dhe mesazhe qe iu flisnin diteve te sotme. Abuzimi me pushtetin ishte ai ku Vath Koreshi ndaloi me shume . Personazhi i Sakos nuk donte tjeter vec martese dhe familjeqe i mungonin dhe qe i mbeten imagjinare. Diku vjen nga thellesite e fushave, por asnjehere nuk behet konkrete. Dukej sikur Shqiperia ishte ne ankand. Drama dhe zhgenjimi qe peson Sako nga nje nuse palaco eshte dhe metafora si zhgenjim qe pesuan njerezit nga periudha komuniste.

Me kete lloj skenari Vath Koreshi qendronte ne krye te asaj elite te letersise qe shkruante kinema.

Kete kapercim midis letersise dhe kinemase , Vath Koreshi e bente me mire se shume te tjere.

Vath Koreshi me pozicionin e Tij si deputet ne vitin 2002-2006 kerkonte qe kultura te kishte marredhenie te tjera edhe nepermjet parlamentit. Ne kete drejtim Vath Koreshi ishte nje figure determinante per komunitetin e kineasteve.

Librat dh e Filmat e shkrimtarit Vath Koreshit do te jene perhere te gjalle. Ai do te vije ne portat e kujtesave te gjeneratave, qofte edhe me petkun e Haxhiut te Frakulles.



PAQËNDRUESHMËRIA E HANËS

tregim nga

Ballsor Hoxha

Kërkon të dijë, tërë kohën, e flenë vetëm nja gjysmë ore në 24 orë, kërkon të dijë ç 'është shpirti? Dhe vazhdimisht i duket se dridhet hëna, se dridhet si para rrëzimit. Dhe bie ballorja e saj nga dridhja. Por kur e pyet veten, i paralizuar, memec, me kalljen e egër në trup, sidomos kur e dëgjon të qeshurën e Lules dy muajshe, vajzës së tij, kur e pyet veten ç'është hëna, apo "pse e lidhi me shprtin", i kujtohet shpërthimi në veturën e tij, me familjen e tij, - familje -, ditën kur Lulja kishte mbushur dy muaj, rrugës për festë në shtëpinë e prindërve të tij. I kujtohet dhe paqëndrueshmëria e lules. E Lule vetë e ka emëruar vajzën e tij.

Ishte paralizuar. Përjetë, ditën e mbushjes së muajit të dytë të lindjes së vajzës, Lule. Në shtëpinë e prindërve për festë atë ditë.

Në shtëpinë e tyre, i shqetësuar, krejtësisht i rënë disi brenda vorbullës në vete, që kallej dhe ngritej si kallje e fuqishme, kishte qenë në korridor kur kishte filluar të paralizohej. Lulja fjetur në kauçin e kuzhinës, ende në pelena, ky në korridor, matej ta shikonte vajzën duke fjetur, apo të dilte jashtë ndizte një. Kishte mbetur për një kohë të gjatë, çuditshëm të gjatë, pa lëvizur, dhe duart, këmbët dhe zemra përnjëherë duke iu dridhur. Këmbët prerë, dhe cigaren e bërë gati në gishtat që nuk i ndjente, pa asnjë paralajmërim, pa asnjë shenjë, pa asnjë dhembje para kësaj.

Natën para dy mujorit të Lules, para ditës së paralizës, kishte mbetur zgjuar tërë natën duke e dashur Lulen derisa ajo flinte, në trupin gjysmë të zhveshur të gruas së tij. Ishte i për-kapur në vogëlsinë e frymëmarrjes së saj të vogël, gjë që e bënte të ndjehej sikur shikonte nga diku tejet thellë tejet larg. Hundën të vogël, të imë dhe të gjallë, në të njëjtën kohë ndiente kthimin e botës, përmbushjen e botës, dhe njëlloj dashurie të frikshme. Por edhe kishte filluar t'i ikte mendja në tmerr pikërisht nga vogëlsia e frymëmarrjes së saj. Por edhe i dukej se arrinte mbi botën. Dikur, në tërë dashurinë ndaj asaj vogëlsie të pambrojtur që merrte frymë kishte filluar ta mbroj me të qenit zgjutë pranë saj. Në mëngjes, fjetur padashje, pa vullnet, kishte parë një ankth kur e kishin prerë gjelin e themelit për shtëpinë e prindërve, dhe kur e kishin spërkatur me gjakun e tij themelin. Por gjeli, nuk kishte qitur asnjë zë, me qëllim. Dhe ishte zgjuar me të kuptuarit, sikur për herë të parë, se Lulja ishte vajzë. Vajzë, ndryshe nga ai. Ishte i largët, tej botës nën ndjenjën e ëndrrës, në mëngjesin e ditës kur ishte paralizuar.

Duke vozitur për në shtëpinë e prindërve, të nesërmen, kishte qenë i qetë, çuditshëm për gruan e tij, çuditshëm i qetë, duke bluar në kokë, asnjë zë. Dhe dëgjonte si në vëzhgim frymëmarrjen e Lules. Përnjëherë i ishte blloku truri, dhe pastaj e kishte kapur një dëlir. Pas ëndrrës, si vizione, si vinjeta i kishin shpërthyer asociacione të tmerrshme si krateri i tokës së çarë: Lulja e rritur, dhe pikërisht kjo absurdi më i madh në tërë jetën e tij; Lulja e vogël dy muajshe (atë ditë) pikërisht absurdi më i madh në tërë jetën e tij; pastaj gjeli i ëndrrës me pupla të rruara nën kësulë, si në Mad Max; fryma; gruaja plakë; dhe në fund hënës duke i rënë copa të ballores së argjendësisë së saj. Duart duke iu dridhur tepër mbi timon, duke vozitur, kishte ndezur një cigare, dhe kurrë më parë nuk e kishte ndier më bukur shijen e saj. Gruaja e kishte përmendur se tani ishin me Lulen në veturë.

Pas paralizës, gojën memece, kanë kaluar vite, i quan tradhti të gjitha ato që bëjnë përreth tij. Mjekët i quajnë vetëdijësime dhe prishje të tyre; pastaj mjekë të tjerë i quajnë progres dhe regres, pastaj ka dhe të tjerë që i marrin sikur lëvizje të mendjes së tij të shituar diku dhe nga dikush dikur. Prindërit dhe familja nuk dinë dhe as nuk kanë ndonjë mendim.

Ç' është e vërteta këto janë vetëm dhembje që herë përhapen në trurin e tij, apo në mendjen e tij, dhe herë shuhen, Në vete ndjehet duke u kallë egër.

Ç' është e vërteta ajo që ndodh tani shpesh, është se e humb realitetin, dhe çdo gjë merr pafund kuptime dhe asnjë kuptim. Në të vërtetë ajo që e frikëson më së shumti është kur, në karrigen e paralizës, memec trupi duke iu dridhur, në fytyrat e të vetëve sheh tejpërtej, pa ndonjë spirancë apo lidhje, pikërisht për shkak të njerëzisë së tyre. E tmerron lëkura. Dhe pikërisht në këto shikime të tejshme, sheh dhe ndjenë sa lehtë mund të pritet lëkura, sa lehtë mund të thyhet ashti. Pyetet dhe kërkon me gjeste ta shtrëngojnë për të ndjerë ashtin e tij. Lulja qanë nganjëherë, dhe është për atë sikur çarje. Nuk e sheh, as nuk e njeh, as nuk e do, e do tinëzisht, kur flenë apo kur është duke luajtur vetë.

Por të shumtën e herave, kur dëgjon të qarën e Lules, qanë dhe vetë për të mos e dëgjuar. Njëjtë sikur me premtimin para se të paralizohej.

Kur të gjithë bëheshin bashkë në shpjegimet dhe diagnozat e tyre, të gjithë tmerroheshin. Paraliza ishte shkaktuar sepse ishte tmerruar që kishte një vajzë dy muajshe. Në të vërtetë të gjithë e dinin nga përvoja se e kishte nga lumturia.

Ç' është e vërteta nuk ka ku të kthehet, apo ku të shkoj, apo si të shërohet, qoftë edhe të shëroj veten, apo edhe të qetësohet nga kallja brenda, e qoftë edhe nga paraliza. Ishte martuar dhe sidomos ishte bërë prind i bindur në fuqinë e njeriut dhe në fuqinë e njerëzimit, në humanitetin dhe në fytyrat e lumtura të njerëzve, pas kthimit. Ishte i bindur se tërë që i duhej ishte qetësia, e se qetësia ishte vetë Lulja, siç thoshte para se të lindte ajo, lulja fëmija lulëzimi i harmonisë së botës.

Ndonjëherë, për shkak të kalljes brenda tij, temperaturave tejet të larta e dërgonin në mjekët të cilët përmes barërave ia krijonin njëlloj amullie. Kish prej tyre që e analizonin dhe trajtonin me të gjitha metodat, por e tëra përfundonte në vullkane dhe furtuna të tmerrshme të tij.

Ç' është e vërteta e kishin pasur edhe në hoxhallarë, dervishë e priftërinj, të gjithë njëjtë, kishin pasur momentet e tyre të shfryrjes së lutjeve e duave të tyre në të dhe asgjë tjetër.

Ç' është e vërteta edhe e kishin shty të lëvizte një guri diku në një lum, me gjithë dhembjen e të lëvizurit të duarve, mbajtur nga nëna e tij. Në të vërtetë ishte dashur të rrotullonte një guri në një lum në anën e kundërt të tij.

Ç' është e vërteta nëna e tij nuk linte rrobë të tij pa i marrë ndonjë copë të vogël, askush nuk e dinte pse ajo e bënte këtë dhe kush e udhëzonte. E paraliza përkeqësohej.

Ç'është e vërteta familja e tij vetëm së voni kishin filluar të kuptonin, nëse kishte diçka që mund të kuptohej, nëse kishte diçka që mund të dihej. Mirëpo edhe tash, po e njëjta familje ikte nga ai, dhe i bënte gjithfarë dredhira për ta shmangur, sepse as nuk mund të përballnin dhembjen dhe as të përballnin atë që kuptonin.

Kur ishte paralizuar, kishte humbur vetëdijen për disa ditë dhe nuk mund të kthehej pikërisht aty ku ishin vajza dhe gruaja e tij.

Pra ditën e paralizës, me cigaren në gishtat e tij që i dridheshin tej mase, kishte qen i ndarë në dysh mu në korridorin e shtëpisë së prindërve të tij, ardhur aty për të festuar dy mujorin e Lules. I mbetur në korridor për kohë relativisht të gjatë, dhe duke mos ditur nga t'ia mbajë. Nuk dinte si të kthehej, kudo, ku kishte qenë, jashtë për të ndezur cigare apo te Lulja. Dhe i dhembte, i dhembte kjo vuajtje, i dhembte aq shumë sa që me mundim të madh kishte mbështetur ballin në murin e korridorit për t'u ftohur. Por dhembja nuk ndalon, i shtohet me çdo moment të kaluar në korridor. Familja e shikojnë të çoroditur nga dridhjet e tij

të dukshme. Gruaja e thirr por e dëgjon si prej larg. Lulja qeshet krejtësisht papritur dhe qetësohet në shtratin e saj. Në të vërtetë herën e parë ka qeshur kur ka filluar çarja, dridhja paraliza.

Më në fund, ende cigaren mes gishtave, sikur plak para ditëve të fundit të vdekjes, ishte shkëputur nga bllokada dhe ishte nisur te Lulja. Rrugës për në kauçin e kuzhinës ku flinte Lulja kishte parandier trishtim të thellë dhe i ishte troshitur cigarja mes gishtave në dridhje. Lulja kishte qenë fjetur. Lulja. E kishte përqafuar dhe përqafimi i kishte ndjellë ethe të tmerrshme. Ia kishte shikuar fytyrën e vogël dhe ishte habitur duke shikuar hundën e saj, hundën e saj aq të vogël dhe aq me karakter dhe aq të imë, gjë që e kishte urryer nga një frikë që e dridhte. Përnjëherë i afruar tek veshi, duke ndjerë se po vdiste, po thellohej, po kthehej, sikur në fetus.

Kat mbi kat të dhembjeve. Ishte afruar dhe kishte mundur të shmanget nga ajo vorbull dhembjeje në korridor, i ishte afruar Lules me të vetmin besim se duke krijuar një dhembje më të dashur dhe më të arsyeshme do të mund të shtypte dhembjen që e kishte kapur. Donte t'i premtonte.

I ishte afruar Hanës!, derisa ajo në muajin e saj të dytë flinte e pavetëdijshme për asnjë nga këto. Është gjumi, është gjumi i Hanës! që e tmerron më së shumti, që e kishte tmerruar më së shumti. I ishte afruar edhe më afër dhe ia kishte puthur hundën e saj të vogël, që i ishte bërë më e madhe se vetë ai, se vetë hëna dhe bota. Dhe ajo ishte përmendur në gjumë. "Kush e di çka mendoi tani". "A mendon?". "Çfarë tmerri". Kishte menduar para Hanës!.

Pastaj, më në fund, i ishte afruar veshit të Lules, i afrohet aq afër sa kur flet ia prek veshin e majtë me buzët e tij.

"Hana" i kishte thënë, ia kishte ndërruar emrin. Pyetur pse, pas paralizës, në kalljet e tij të egra e dinte tani se gjithmonë kishte dashur t'ia linte emrin Hana, por , e kuptonte i paralizuar, tërë kohën para lindjes së saj në ndërdije i ishin kujtuar foto të Neil Armostrongut, e zeza e hënës, vetmia e saj, askushsia e saj. I ishte kujtuar tërë njerëzimi i rritur me hënën, me lëkurën e saj të argjendtë, të kallur në qetësi, e prapa ajo askushësi, e mendonte shpesh tanimë i paralizuar. Kishte tërë jetën për të menduar tanimë. Ishte tërë ajo që i kishte mbetur.

Dhe, mu aty para saj atë ditë, kishte vazhduar "të premtoj se do të thërras Hana përgjithmonë". E kishte kapur paraliza tanimë, ishte ndalë pak, i goditur mu në tru. Pastaj përnjëherë njëfarë çlirimi kishte kaluar në trurin e tij dhe kishte thënë vetëm edhe një herë para se të mbetej memec përgjithmonë "po të premtoj".

"Në netët e ngadalta", kur e dëgjon "Thousand Kisses Deep" të Lonard Cohen, mendon për këtë fjalë të fundit të tij "të premtoj", i paralizuar, e kujton derisa ajo tanimë është rritur pesë vjeç me biçikletën e argjendtë, "nuk ka shpirt" këlthet, i frikësuar nga fjala e thënë, "nuk ekziston", ka vetëm frymë. Frymë që dridh hanën.

Dhe bijnë copa të ballores së argjendësisë së hënës.

PENDËL ZOGU

tregim nga

Mehmet Elezi

Ulur në kafen e vockël, në katin përdhes të një ndërtese me tulla balte, ndoqi për së largëti skenën e mbrame. Pa ia hequr sytë zogut. Qe kafja e parë private e lagjes, e hapur pas përmbysjes së regjimit.

Binte në sy blloku i mermertë i kokës së tij të madhe me ballë të naltë, të tejdukshëm. Dhe me kaçurrelat e holluara, aq të brishta sa mund të mendoje se janë flokë bore, prit kur të shkrihen. Po priste shokët për kafe. Patën qenë katër, kishin mbetur tre. Më në fund zogu frushulloi dhe u ul në skaj të tavolinës përballë. Flatrat lëkundën ajrin, shishja e zbrazur e ujit u dridh e ra.

Ai mori frymë i lehtësuar.

-Biri im, i tha zogut. Ti e di, të kam nxjerrë drejtpërdrejt prej trupit tim, prej mishit tim. Mos dil kështu, të vrasin. Të pjekin në hell.

Zogu zgjati qafën e hollë, *ciu-ciu.* Dhe filloi kallëzimin, me ndodhinë e parë të atij mëngjezi. Sa kish dalë me fluturue.

Prokurori i lartë E. K. priti me ia hapë derën shoferi dhe zbriti. Duke ngjitur shkallët e hyrjes ballore, iu bë se dëgjoi një zë të njohur, të nëpërtymtë. Shtrëngoi nën sqetull çantën dhe këqyri me bisht të syrit. Mbi murin rrethues të oborrit qe ndalur një zog elegant, i veshur me pendla ngjyrë hiri dhe të kaltra. Për një imtë u mëdysh. Pëllumb jo, është fazan i ri, zogëz? S'kish parë kurrë fazan të gjallë për së ngjati, përveçse në pjatë. Zëri i nëpërtymtë vinte andej nga zogu. Qafa lozanjare e shpendit ia kujtoi Elën. Nuk po e zbërthente dot Elën. Kishte ardhur aty si praktikante. Sa afrohej maturisht dhe i jepte shenja sikur ia kishte qejfi një intimitet me shefin, po aq maturisht rrëshqiste e i zhdukej disa ditë nga sytë. I linte në zyrë një erëmirë të rrallë, për të cilën ai nuk qe i sigurt qe parfum apo thjesht erëmimi i shtatit, i krejt qenies së saj. *Ko-koo,* ia bëri zogu, si pula kllukë që paralajmëron mos m'i trazoni vezët. Prokurori i lartë E. K. e dëgjoi prapë jehonën e atij zërit. Fër-fër u dha krahëve zogu e u ndal te hyrja ballore, mbi bas-relievin me simbolin e peshores. Dëbojeni që andej, urdhëroi E. K. policin e rojes, me një lëvizje dore. Polici i bëri shenjë pastrueses, trembe me bisht të fshesës (unë nuk jam këtu me i tutë pulat!). Pastruesja po lexonte një kumt në telefon.

Ko-koo-ja e shpendit të rrallë e ndoqi përgjatë hollit, deri te ashensori. Bashkë me një hakërrimë të largët. Do të të var në shesh të qytetit!, gëmushej dikush brenda guackave të *ko-koo*-ve paqësore të shpezës pa emër. Kallëzo lidhjet! Do të të var kështu siç je, lidhur këmbë e duar. Ja, me këtë litar që ke në qafë tashti. Vërr!, ia shtrëngonte litarin rreth fytit. Zë i plasaritur, me ushtimë, si zërat e regjistruar gjatë përgjimeve telefonike me teknikën e vjetër. Prokurori i lartë E. K. nuk u ndie mirë. Në *ko-koo*-të e zogut njohu zërin e vet të asaj kohe. Po ngërmohej zëri i tij i asaj kohe. Mos po më lëviz shtypja e gjakut? Dëbojeni atë zog, kishte urdhëruar. Polici kishte rrudhur krahët, nuk jam këtu me tutë pula.

Shpendi elegant nuk priti me e përzanë. Shpupurisi krahët dhe u ndal te hyrja e oborrit të shkollës, në anën tjetër të bulevardit. Ki-ki-ki!, iu afrua një djalë sa grima, me duar rreth gojës. Pse bën ki-ki-ki!, nuk është gjel, ia veshi shoku në palcak të qafës. *Ko-koo,* ua ktheu zogu. Grimcani rrudhi qafën, ndjeva zë burri, zogu foli si burrë, nuk dëgjon një zë të trashë që gërthet? Po gërthet nëndrejtori, o rrotë, filloi mësimi. U turrën në pikë të vrapit. Djali qe i bindur se kish dëgjuar një zë tjetër. Andej nga shtylla ku rrinte zogu.

Kish kaluar ora, kur te sheshi me shtatoren dhe emrin e një shtetari të madh perëndimor vezulloi tehu i sirenës së policisë. U shfaq makina e një qeveritari të lartë. Do të përurohej Qendra për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut. Qeveritari i rëndësishëm shoqërohej nga ministrja e brendshme me një tatuazh të vockël në qafë majtas, ndoshta flutur, dhe zyrtarë të tjerë. Në oborr të Qendrës spikatte shtatorja *I burgosuri në ditën e parë të lirisë* dhe një citat nga Vaklav Haveli. Shtatorja kishte ngrirë me këmbët mbështetur në ajër. Afrohu, i tha qeveritari i lartë skulptores së shtatores. Talent i florinjtë, shqiptoi duke ia rrahur butazi shpatullat vajzës, që s'i kish kaluar të tridhjetat. E shikoni? Heroi i kësaj nuk e ve këmbën në tokë, fluturon. Fluturon në liri!

Tha këto fjalë dhe u prish në fytyrë, a thua i theri mesi? Pati përshtypjen se ajri po ia kthente si shpellë jehonën e zërit. Të zërit të tij të dikurshëm. Ai e njohu pëshpërimën e vet të dikurshme. Flet kundër, i çuçllonte dikujt në errësirë zëri i tij i dikurshëm. Shkruan poezi kundër. Lavdëron poetin Gj. F., kundër. Zëri i tij i asaj kohe ishte fshehur nën guacka *ko-koo*-sh të një shpeze. Shpeza rrinte në rrapin përballë, në një degë. *Ko-ko-koo.* Me puplat e groshme, të kaltra dhe të përhime, mos është prej porcelani? Qeveritari i rëndësishëm rrudhi ballin. Rojet e sigurisë e përkapën kumtin, shpendi qafëgjatë shkakton bezdi, e di shefi pse. E përzunë. Ta kisha therur unë bre, shqiptoi një gojë e gjerë, pa dhëmbë, e paluar nën një kasketë ngjyrëkafe, tërë lyrë. Ndiqte i lumturuar qeveritarin e lartë.

Ky kishte qenë udhëtimi mëngjesor i zogut. Me tri ndalesa.

Ti tashti di shumë gjëra, zog, i tha burri me bllok mermeri mbi shpatulla. Je pjesë e mishit tim. Ke parë e dëgjuar, ke regjistruar nga kujtesa e mureve. Ti di për shembull, që. *Ko-koo,* tha zogu i rrallë, di. Ai ta vuri litarin në fyt, do të të var në shesh të qytetit, kallëzo lidhjet. Ti zog di për shembull që. *Ko-koo,* tha zogu i rrallë, di. Ai pëshpëriti për ty diku në terr. Është armik, tha. Shkruan poezi kundër. Lavdëron poetin Gj. F., kundër.

Burri me fjolla të rralla bore në vend të kaçurrelave, që priste shokët në kafen më të hershme të lagjes, kish qenë në *fllad.* Domethënë në burg. Nëntë nga dhjetë vjetët e fundit të regjimit tashmë të përmbysur i kish bërë aty. Një muaj pa fituar lirinë, se si i bie në dorë një kokërr vezë. Pse ta ha këtë vezë? Një është, si qe si s'qe. Më mirë i shtoj një jetë kësaj bote. Kjo botë ka vend për të tërë. E ruajti vezën. E mbajti tri javë vezën nën sqetull. Dritë në dritë nën sqetull. Duke u kujdesur si për syrin, mos me rrëshqitë, mos me u thye. Sqetulla e tij qe mësuar me vezë. Por me vezë tjetërsoj, të sapoziera, që ta pjekin mishin për së gjalli. Pas njëzet e një ditësh nën sqetull lëvizi një jetë. Një qenie shpurdhi, gëzhytra u ça. U zgjat një sqep i bukur. Dhe cicëroi: erdha!

Tashti jetonin bashkë, në të njëjtën banesë. Zogu dhe burri që e kish prurë në këtë botë, e kish çelë duke e ngrohur si pula kllukë. Tri javë rresht, nën sqetull.

-Po ky zog, paska dalë vullnetar?, tha pronari i kafes. Shumë mirë ka bërë, furra ja ku është, edhe rakinë e kam të mirë.

-Mos dil kështu zog, tha burri me kokë mermeri. Ti di shumë, të vrasin. Jo ata si ky i kafes sonë këtu, jo, ky veç fjalë ka. Janë të tjerë ata, që. Nuk bëzajnë, por.

Shpendi i larmë, me qafën hollake curril, përplasi flatrat e u ngrit. Iu shkëput një pupël e argjentë. Pendla valëzonte në ajër, pa vendosur ç'drejtim me marrë. Filloi me i shkrue në ajër kujtimet e veta.

Franca Rame

PËRDHUNIMI

Përktheu: Anxhela Lepuri

Në qendër të skenës vendoset një karrige, në të cilën do të ulet aktorja. Për të luajtur këtë pjesë është e domosdoshme që aktorja të veshë pantallona.

Dëgjohet një radio... por vetëm pas njëfarë kohe e ndiej... Vetëm pas njëfarë kohe kuptoj se dikush po këndon.

Po, dëgjohet një radio... muzikë e lehtë: qiell, yje, zemër, dashuri... dashuri...

Ngjeshur në kurriz, kam një gju, vetëm një... sikur ai që më qëndron nga pas të jetë duke e mbajtur tjetrin mbështetur përtokë... më përthyen duart, shumë fort, duke mi kthyer mbrapsht. Sidomos të majtën.

Nuk e di përse nis e mendoj se mos ndoshta është mëngjarash. Nuk po kuptoj asgjë se ç'po më ndodh. Kam hijen e dikujt, i cili është duke humbur mendjen, zërin... fjalën.

Ndërgjegjësohem për gjërat, me një lehtësi të pakuptueshme.

Zot, çfarë lëmshi!

Si hipa mbi këtë kamion? Hipa vetë me këmbët e mia, duke i hedhur njëra pas tjetrës, pas shtymës së tyre? Apo më hipën ata, duke më ngritur peshë?

Nuk e di.

Është zemra, që më rreh fort pas brinjëve, ajo që më ndalon të arsyetoj... është dhimbja në dorën e majtë, që po bëhet kaq e padurueshme.

Pse po ma përthyejnë kaq shumë? Unë as nuk po përpëlitem.

Shitohem.

Tani, ai që më qëndron nga pas nuk e mban më gjurin mbi shpinën time... është ulur rehat... më mban mes këmbëve... kaq fort... siç bëhej njëherë e një kohë, kur u hiqeshin bajamet fëmijëve. Është i vetmi imazh që më vjen në mendje.

Pse më shtrëngojnë kaq shumë? Unë nuk lëviz, nuk bërtas, nuk bëzaj.

Radioja këndon, jo dhe aq fort.

Përse kanë vënë muzikë? Përse e ulën zërin? Ndoshta sepse nuk po bërtas.

Përveç atij që më mban nga pas, janë edhe tre të tjerë.

I shoh: nuk ka dhe aq dritë... hapësirë po ashtu... ndoshta për këtë më mbajnë gjysmë të shtrirë.

Më duken të qetë. Të sigurt. Çfarë po bëjnë? Po ndezin një cigare.

Po tymosin? Tani? Përse më mbajnë kështu dhe ndërkohë tymosin?

Ka për të ndodhur diçka, e ndiej... Marr frymë thellë... dy a tre herë. Nuk vij në vete... Kam vetëm frikë. Më qaset njëri, një tjetër struket në të djathtën time, tjetrin në të majtën. Shoh flakërimën e cigareve.

Po i thithin shumë shpejt.

Më afrohen.

Po, ka për të ndodhur diçka... e ndiej.

Ai që më mban nga mbas, shtriqet i tëri... i ndiej përreth trupit tim. Nuk më ka shtrënguar më tepër, më ka tërhequr vetëm muskujt, si për të qenë gati për të më bërë zap.

I pari që më afrohet, më vendoset mes këmbëve... në gjunjë... dhe mi hap.

Është një lëvizje precize, që ngjan e njëkohshme me atë që më mban nga pas, sepse këmbët e tij vendosen bash mbi të miat për të më bllokuar.

Unë kam veshur pantallona. Përse mi hapin këmbët kur kam pantallonat mbathur?

Ndihem më keq se të isha lakuriq!

Nga kjo ndjesi më shpërqendron diçka që nuk e kuptoj menjëherë... një nxehtësi mbi gjoksin e majtë, si fillim e dobët dhe mandej akoma më e fortë, derisa bëhet e padurueshme.

Një ndjesi djegie...

Cigare...

Cigare... mbi golf, deri nën lëkurë.

Ja përse kishin nisur të tymosnin!

E gjej veten duke menduar se çfarë duhet të bëjë një njeri në këtë gjendje. Unë nuk mundem të bëj asgjë, as të dënes... Më duket sikur jam e përvarur, ngjeshur pas një dritareje, e detyruar të shoh çfarëdolloj gjëje të tmerrshme.

Ai që gjendet i ngjeshur në të djathtën time ndez cigaret, i thith nja dy herë dhe ia kalon atij që qëndron mes këmbëve.

Digjen shpejt.

Era e leshit të djegur mesa duket e shqetëson të katërtin: me një brisk më presin golfin, nga përpara, gjatazi... më presin edhe reçipetat... më presin edhe lëkurën në sipërfaqe: gjatë ekspertizës mjekësore do të konstatojnë njëzet centimetra.

Ai që më qëndron mes këmbëve më merr gjinjtë mes duarve, edhe djegiet i ndiej të ngrira...

Tani... më zbërthejnë rripin e pantallonave dhe të gjithë turren të më zhveshin: ca nga këmbët, ca nga koka.

Ai që më mban nga pas po eksitohet, e ndiej që fërkohet pas shpinës sime.

Tani... njëri... më hyn brenda.

Më vjen të vjell.

Duhet të rri e qetë, e qetë.

Përqendrohem te fjalët e këngëve... zemra është gati të më plas, nuk dua të dal nga pështjellimi në të cilin ndodhem.

"Lëviz, kurvë. Më kënaq!"

Nuk kuptoj asnjë fjalë... nuk njoh asnjë gjuhë. Një tjetër cigare.

"Lëviz, kurvë, më kënaq!"

Bëhem gur.

Tani... është radha e të dytit... goditjet e tij janë edhe më të vendosura. Bëhem për vdekje.

"Lëviz, kurvë, më kënaq!"

Brisku që shërbeu për të më prerë golfin më kalon shumë herë para syve. Nuk e ndiej në më pret a jo.

"Lëviz, kurvë, më kënaq!"

Gjaku më kullon nga faqet tek veshët.

Është radha e të tretit. Është e tmerrshme të ndjesh tek kënaqen brenda teje kësi kafshësh të shpifura.

"Po vdes, - arrita të them. – Jam e sëmurë, vuaj nga zemra!"

Besojnë, nuk besojnë, debatojnë.

"Le ta zbresim. Jo... po..." Kërcet një dackë mes tyre...

Më shtypin një cigare mbi qafë... këtu... për ta fikur.

Ligem në çast.

Ndiej që më lëvizin. Ai që më mbante nga pas më vesh me lëvizje precize. Më vesh ai, unë nuk mundem për asgjë. Ankohet si kalama sepse është i vetmi që nuk bëri dashuri... më falni... i vetmi, që nuk zbërtheu pantallonat... por ndiej ngutin e tij, frikën e tij. Nuk di si të më vesh golfin e prerë, më fut këmbëzat e pantallonave dhe kamioni ndalet që të zbres... dhe zhduket.

Me dorë mbaj xhaketën e mbyllur mbi gjoksin e zbuluar. Është gati terr. Ku ndodhem? Në park?

Më vjen ligsht... në kuptim që jam gati të më bjerë të fikët... jo vetëm për dhimbjen fizike në të gjithë trupin, por për fëlliqësinë... për poshtërimin... për zemërimin... për mijëra pështymat që mu hodhën fytyrës... për spermën që ndiej të më përvaret.

E mbështes kokën te një pemë... edhe flokët më dhembin... Po, mi tërhiqnin që të ma mbanin kokën në vend.

E përshkoj fytyrën me duar... qelbet në gjak.

Ngre jakën e xhaketës dhe shkoj. Eci... nuk e di për sa kohë.

Pa kuptuar, gjendem përballë policisë.

Mbështetur në murin e pallatit përballë, rri duke parë hyrjen nuk e di për sa çaste... njerëzit që hyjnë e dalin... policët....

Mendoj se çfarë duhet të përballoj nëse hyj tani... Dëgjoj pyetjet e tyre... shoh fytyrat... buzëqeshjet e shtirura...

Mendoj e rimendoj...

Më pas vendos...

Do të kthehem në shtëpi... do të kthehem në shtëpi...

Do i denoncoj nesër.

Shuhet drita.

Fundi i spektaklit.

TEDDY BEARS

esse nga

John Green

Përktheu Andreas Dushi

Vendosa ta përkthej këtë esse të John Green, marrë nga libri i tij i fundit "The Anthropocene Reviewed" botuar sivjet, pasi tregon shumë për natyrën njerëzore, mbizotërimin e saj në botë, egoizmin e njeriut dhe problemet që ai i shkakton gjallesave dhe vetë gjallërisë.

Në anglisht, fjala *bear* (ari) vjen nga një rrënjë gjermane, *bero*, që do të thotë "ai ngjyrë kafi" apo "ajo gjëja kafe". Në disa gjuhë skandinave, fjala *ari* rrjedh nga "mjaltëngrënës". Shumë gjuhëtarë besojnë se këto emra janë zëvendësues, krijuar ngase të thoje apo të shkruaje troç fjalën ari konsiderohej tabu. Ashtu sikurse në botën magjike të Harry Poterit ishin mësuar të mos thonin asnjëherë "Voldemort", evropianët veriorë nuk para e thonin troç fjalën ari, ndoshta sepse besohej se të thuash emrin e vërtetë të ariut do ta grishje ndonjërin. Sidoqoftë, kjo tabu ka qenë tejet e efektshme pasi sot kemi mbetur vetëm zëvendësueset e fjalës ari – në thelb, ne i quajmë ato "Ti-e-Di-se-Kushi".

Megjithatë, ne për arinjtë jemi një rrezik më i madh sesa ata janë për ne. Për shekuj me radhë, evropianët i torturuan arinjtë në një praktikë të njohur si *kafsho-ariun*. Arinjtë lidheshin në një cep dhe mandej sulmoheshin nga qentë deri kur ata të lëndoheshin apo vriteshin ose ato vendoseshin në një ring me një buall për t'u ndeshur gjer' në vdekje. Mbretëroët anglezë e dashuroni këtë: Henri VIII kishte një guvë ariu në Pallatin e Whitehall-it.

Referenca për *kafsho-ariun* shfaqen edhe te Sheksipiri, ku Makbethi qan sepse armiqtë e tij *e lidhën në një hu; nuk iki dot/ si një ari pra gjer në fund luftoj* (përkthimi i Fan Nolit). Kjo është një pjesë veçanërisht me interes. Qysh nga koha e Shekspirit, arinjtë janë zhdukur në Britani për ndoshta njëmijë vjet, dyfishin e atyre që janë vrarë nga njerëzi. Për të luftuar kursin "si ari" nuk mund t'i referohemi sjelljes së ariut në botën natyrore, vetëm dhunës së vuajtur nga arinjtë, përcaktuar nga njerëzit në një spektakël.

Edhe pse shumë njerëz e quajtën *kafsho-ariun* një "mënyrë të vrazhdë dhe të ndyrë të kalimit të kohës", sipas shënimmbajtësit John Evelyn, kryesisht objekti i saj nuk ishte dhuna ndaj kafshëve. "Puritanët e urrenin *kafsho-ariun* jo ngase i shkaktonte dhimbje arinjve, por sepse i jepte kënaqësi spektatorëve," shkroi Thomas Babington Macaulay.

Do të ishte e pasaktë atëherë, ta kërkonim tërësisht dominimin tonë mbi arinjtë në fenomenin e fundit. Akoma është pak e çuditshme që fëmijët tanë tani, kryesisht përqafohen me një version prej pellushi të asaj kafshe që kishim frikë t'ia thonim emrin.

***

Kjo është historia e *Teddy Bear* sikurse thuhet zakonisht: Në nëntor të vitit 1902, Presidenti i ShBA Teddy Roosvelt shkoi për gjueti arinjsh në Mississippi, çka ishte diçka e jashtëzakonshme për t'u bërë nga Teddy Roosvelt. Qentë e gjahut ndoqën një ari për orë të tëra para se Roosvelti të dorëzohej e të kthehej në kap për drekë.

Guidieri i gjuetisë së Roosveltit atë ditë, një njeri i quajtur Holt Collier, vazhdoi të ndiqte ariun me qentë e tij ndërkohë që presidenti drekonte. Collies kishte lindur skllav në Mississippi dhe pas Emancipimit u bë një nga kalëruesit më të kualifikuar. (Ai gjithashtu vrau më shumë se tre mijë arinj gjatë jetës së tij.) Kur Roosvelti ishte larguar, qentë e Collierit rrethuan një ari. Collier fryu një trumpetë për të vënë në dijeni presidentin, por para se presidenti të kthehej, Collieri po gjuante ariun me fundin e një pushke pasi ai po i copëtonte njërin prej qenve.

Në çastin kur presidenti arriti në skenë, ariu ishte i lidhur për një pemë dhe thuajse pa ndjenja. Roosvelti rrefuzoi ta qëllonte, pasi ndiente të ishte një veprim që s'i shkonte për shtat një sportisti. Fjalët e mëshirës së presidentit u përhapën përqark vendit, veçanërisht pas një vizatimi nga Cliffort Berryman në *Washinton Post* që ilustronte ngjarjen. Në vizatim, ariu rishfaqej si një arush i pafajshëm me një fytyrë rrumbullake dhe sy të mëdhenj që shihnin Roosveltin me një dëshpërim zemërbutë.

Morris dhe Rose Michtom, emigrantë rusë që jetonin në Brooklyn, panë këtë vizatim dhe u frymëzuan që të krijonin një version prej pellushi të tij, quajtur "Teddy's Bear" (Ariu i Tedit). Ariu u vendos në dritaren e dyqanit tyre të ëmbëlsirave dhe u bë një *hit* i menjëhershëm. Kureshtshëm, një firmë gjermane prodhoi një *teddy bear* të ngjashëm në të njëjtën kohë dhe të dyja kompanitë përfunduan duke u bërë shumë të suksessheme. Kompania gjermane e artizanatit *Steiff* ishte krijuar disa dekada më herët nga Margarete Steiff dhe nipi i saj Richard dizenjoi *teddy bear Steiff*. Nga 1907, ato kanë shitur përafërsisht një milion në vit. Po atë vit, sërish në Brooklyn, Mitchomët i përdorën shitjet e *teddy bear*-it të tyre për të krijuar kompaninë *Ideal Toys*, e cila krijoi me punë dore një grup të madh të lojërave më të njohura të shekullit XX, nga *Kurthi i Miut* deri te *Kubi Rubik*.

Teddy Bear i sotshëm ngjan pak a shumë me atë të 1902: trup ngjyrë kaf, sy të errët, një fytyrë të rrumbullakët, një hundë e vogël e këndshme. Kur isha fëmijë, një *teddy bear* që fliste i quajtur Teddy Ruxpin u bë i njohur por çfarë unë pëlqeja rreth *teddy bears* ishte heshtja e tyre. Ata nuk më kërkonin asgjë e as nuk më gjykonin për shpërthimet e mia emoionale. Një ndër kujtimet më të gjalla të fëmijërisë është datëlindja ime e dhjetë. U tërhoqa pas në dhomën time pas një feste rraskapitëse dhe u përqafova me një *teddy bear*, por kuptova se nuk po funksiononte sërish: çfarëdo qoftë ajo që dikur më sillte qetësi nga kjo krijesë e butë dhe e heshtur, nuk po e bënte më. Kujtoj të mendoja se nuk do të isha kurrë më fëmijë, çka ishte hera e parë të kujtoj atë ndjesi të zgjeruar që të thotë se nuk mund të kthehesh sërish në atë që je. Sarah Dessen dikur shkroi se shtëpia "nuk është një vend, por një moment". Shtëpia është një *teddy bear*, por vetëm një *teddy bear* i caktuar në një moment të caktuar.

Arinjtë e imagjinatës sonë janë bërë gradualisht më të ëmbël e më përqafues qysh nga dalja për herë të parë e *teddy bear*. Winnie the Pooh, shfaqur për hrë të parë në 1926; Paddington Bear në 1958. Personazhe si Funshine Bear dhe Love-A-Lot Bear kanë vështrim ëmbëlsisht agresiv në librin e ilustruar me tituj si *Caring is what counts* dhe *Your best wishes can come true*.

Në një botë më të gjerë, të paktën ata që jetojnë ndër qytete filluan t'i shihnin arinjtë ashtu sikurse mendojmë se i pa Roosvelti: krijesa që duhen mëshiruar dhe ruajtur. Nëse harroj të fik dritat kur dal nga dhoma, ime bijë zakonisht bërtet "Ba', arinjtë polarë!" pasi ajo është mësuar se minimizimi i shpenzimit tonë të energjisë mund të pakësojë gjurmët tona të karbonit e për rrjedhojë, të mbrojë habitatin e arinjve polarë. Ajo nuk frikësohet nga arinjtë polarë; ajo frikësohet nga zhdukja e tyre. Kafshët që dikur na tmerronin dhe që për shumë kohë i tmerronim, tani zakonisht shihen si të dobëta dhe vulnerabël. Ariu i fuqishëm është bërë, si shumë krijesa të tjera në botë, i varur nga ne. Mbijetesa tyre i përket urtisë apo mëshirës tonë, ashtu sikurse ariu në Mississippi i quajtur Roosvelt duhet të jetë i këndshëm.

Në këtë kuptim, *teddy bear* është një kujtesë e fuqisë mahnitëse të humanizmit bashkëkohor. Është e vështirë ta kuptosh sa mbizotëruese është bërë specia jonë, por ndonjëherë e gjej më ndihmuese ta konsideroj atë në vazhdën e masës: Pesha e të gjithë njerëzve që jetojnë momentalisht në botë është rreth treqind e tetëdhjetëepesë tonë. Kjo është e quajtur biomasa e species tonë. Biomasa e deleve, pulave dhe lopëve që jetojnë është rreth tetëqind milion tonë. Dhe bashkimi i biomasave së të gjithë gjitharëve dhe zogjve të tjerë në tokë është më pak se njëqind milionë tonë. Të gjithë balenat, tigrat, majmunët, drerët dhe arinjtë, po edhe patat e egra kanadeze, sëbashku peshojnë më pak se një e treta e peshës tonë.

Për shumë specie kafshësh të mëdha në shekullin XXI, e vetmja dhe më e rëndësishmja arsye e mbijetesës së tyre është nëse ekzistenca e tyre është e vlefshme për njerëzit. Por nëse ti nuk mund të jesh i dobishëm për njerëzit, gjëja e dytë më e mirë që mund të jesh është i këndshëm. Të nevojitet një fytyrë shprehëse, idealja sy të mëdhenj. Të vegjlit e tu duhet të na kujtojnë të vegjlit tanë. Diçka që duhet të na bëjë të ndihemi fajtor për zhdukjen tuaj nga planeti.

Mundet *këndshmëria* të mbrojë një specie? Dyshoj. Pjesa e historisë së origjinës së *teddy bear* që zakonisht nuk tregohet është se menjëherë pasi Roosvelt për arsye sportive rrefuzoi ta vriste ariun, urdhëroi një anëtar të grupit të tij të gjuetisë t'ia çante fytin e kështu ta çlironte ariun nga mizoria. Asnjë ari nuk u shpëtua atë ditë. The tani janë më pak se pesëdhjetë arinj të mbetur në Mississippi. Shitjet në rang botëror të *teddy bear* ndërkohë, nuk kanë qenë kurrë më të larta.

DALLGA E MADHE NË KANAGAWA:

Mona Liza e Japonisë

Dr. Bledar Kurti

Tetori është muaji i lindjes së Katsushika Hokusai (1760 –1849), një prej artistëve më të shquar japonezë, i cili u njoh nga mbarë bota përmes gravurës së tij *Dallga e Madhe në Kanagawa,* 神奈川沖浪, e kryer rreth viteve 1829-1833.

Teksa perëndimi ishte i zhytur në eksplorimin e mistereve të imagjinatës artistike, dhe artistët haseshin me sfidat kompozicionale dhe përshtatjen e artit me kontekstin e kohës, në lindje të globit, në Japoninë e largët me një kulturë unike dhe magjepsëse, një artist do shprehte madhështinë e artit përmes gravurave, duke shpalosur forcën e natyrës, përmes një teknike dhe efekti që do magjepste mbarë globin dhe do kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në artistët më të shquar të kohës dhe ata të mëvonshmit.

Japonia kishte shekuj e vetë-izoluar nga pjesa tjetër e botës, por kultura e saj e pasur dhe e mrekullueshme, u bë e njohur për perëndimin në shekullin e 19-të. Për shkak të tregtisë shumë thesare japoneze përfunduan në tregjet perëndimore, përfshirë edhe porcelanin e shumëkërkuar japonez. Por, mallra të tilla kaq delikate kërkonin një paketim të kujdesshëm, ndaj tregtarët japonezë përdornin çdo mjet e material për t'i paketuar. Përveç kashtës, tallashit, ata përdornin edhe letra me ilustrime për të ambalazhuar mallrat. Dhe përmes këtyre letrave me ilustrime, perëndimi u njoh me figurat dy-dimensionale të krijuara nga artistët japonezë. Dhe pas këtij kontakti me artin e lindjes së largët, arti perëndimor nuk do mbetej më i njëjtë.

Gravurat e Hokusai-t janë më të njohurat në artin japonez, por ndikimi që ato patën ishte edhe më i madh në artin perëndimor. Ai u njoh dhe u admirua gjerësisht në Evropë, dhe me imazhet e tij ofroi një alternativë të re ndaj modelit ekzistues. Arti i Hokusai-t, si edhe ai i disa artistëve të tjerë japonezë, shërbeu për të përforcuar prirjen e artit evropian drejt një formalizmi të ri, i cili synonte krijimin e pikturave monumentale të frymëzuara nga elementet e rastësishme të natyrës. Thjeshtësia në peizazhe dhe kompozime, tashmë ishte një mision për artistët evropianë ndaj Hokusai e ndihmoi thellësisht atmosferën e ndryshimit dhe eksperimentimit evropian. Me artin e tij, Hokusai u erdhi në ndihmë mjeshtërve evropianë të krijonin një art më novator e më modern.

Gravura *Dallga e Madhe në Kanagawa*, ose e njohur thjesht si *Dallga e Madhe*, është e krijuar sipas teknikës japoneze të klisheve të drurit, përmes së cilës, me mjete të thjeshta, mund të arrihej krijimi i imazheve me cilësi të lartë dhe me kontrast të mprehtë. Kjo teknikë niste me vizatimin në letër nga artisti, ngjitej mbi një pllakë druri, zakonisht qershie, gdhendej me daltë si relief, lyhej me bojë shkrimi dhe mbi të vendosej një letër e pastër e cila shtrëngohej me morsë. Klisheja e drurit krijonte imazhe tek letra vetëm përmes pjesëve të lyera me bojë. Rezultati ishte një panoramë e njëtrajtshme me forma dhe linja tejet të theksuara.

Ngjyrat e gravurave të kryera përmes kësaj teknike ishin të kushtëzuara, ndaj edhe *Dallga e Madhe në Kanagawa, ka vet*ëm katër ngjyra. Në të shpaloset një dallgë e madhe porsi kthetrat e një dragoi, e cila godet e kapërcen tri barka peshkimi, *oshiokuri-bune.* Dallga është në dalje të bregut të Kanagawa, ditët e sotme Yokohama, dhe është konsideruar prej kritikëve si një tsunami, megjithatë artisti ka dashur më shumë të theksojë forcën e natyrës, dramën e lidhjes midis detit dhe njeriut, dhe për më tepër të krijojë një skenë përshkruese për malin që duket në sfond.

Me kreshtën e zbardhur nga dëbora, me formën trekëndore të mprehtë e të përsosur, mali i përtejmë, në qendër të imazhit, është mali Fuxhi, më i larti në Japoni, i konsideruar si një mal i shenjtë. Ai njihet si simbol i identitetit japonez, personifikim i bukurisë dhe është shumë i lidhur me kulturën vendase. *Dallga e Madhe në Kanagawa,* është një nga imazhet e serisë *Tridhjetë e Gjashtë Pamje të Malit Fuxhi,* në të cilat Hokusai krijoi peizazhe të shumta nga këndvështrime të ndryshme të malit Fuxhi. "Brenda malit Fuxhi banon vetë Hokusai. Madje Mali është Hokusai, dhe Fuxhi është artisti," shprehen kritikë të ndryshëm të cilët e shohin malin përtej identitetit japonez por më shumë si një botë shpirtërore të vetë artistit.

Në tri barkat e mposhtura nga dallga gjigande vërehen me dhjetëra rremtarë të cilët të dridhur nga frika mbahen fort në anët e varkës. Nga një përllogaritje e bërë në raport me gjatësinë e barkave dallga është përafërsisht dymbëdhjetë metra e lartë. Harkimi i krijuar, shkuma dhe pikat e ujit janë të krijuara mrekullisht. E gjithë skena është tejet emocionuese. Njerëzit në barka janë peshkatarë të cilët po kthehen në shtëpi pasi kanë shitur peshk në Edo, Tokion e sotme. Nuk mund ta kuptojmë dot fatin e tyre, nëse ata i mbijetojnë apo jo asaj dallge gjigande, por skena në vetvete është drithëruese duke shpalosur një forcë të jashtëzakonshme të detit.

Hokusai ishte gjithmonë i interesuar dhe i pasionuar nga lëvizja e ujit. Ai u përpoq të kapte ritmet karakteristike të ujit në të gjitha aspektet qoftë të shpejtësisë apo edhe heshtjes, rrjedhjes dhe rënies, stuhisë apo edhe të qetësisë. Ndryshe nga trajtimi që Hokusai i ka bërë zhdërvjelltësisë së ujit, Mali Fuxhi duket i vogël dhe i qetë, në krahasim me malin e ujit që ngrihet fuqishëm në plan të parë. Hokusai pati një ndikim të madh në artin evropian por ndërkohë edhe koncepti perëndimor mbi perspektivën, një element themeltar që nga koha e Rilindjes, duket se kishte një ndikim të madh në artin e Hokusai-t, dhe kjo dallohet lehtësisht tek kjo panoramë, përmes perspektivës lineare, me shkallën e zvogëluar të malit në sfond dhe theksimin e dallgës në plan të parë. Edhe ngjyra blu e përdorur në gravurë, e njohur si bluja prusiane, ishte e pazakontë në Japoninë e asaj kohe, dhe ishte e importuar nga Evropa.

Ndikimi perëndimor në artin e Hokusai-t erdhi si rrjedhojë e studimit të gravurave dhe pikturave perëndimore, ndër ato materiale të kufizuara që ishin në dispozicion në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë në Japoni duke e përshtatur këtë stil tejet kureshtar në përsosjen e tij logjike brenda formatit japonez. Në vitin 1796 Hokusai kishte patur mundësinë të studionte nën mjeshtrin Shiba Kokan, pionierin e madh të pikturës dhe gravurave të stilit perëndimor. Ai u përpoq të imitonte peizazhe holandeze dhe franceze, duke mësuar të gjitha dredhitë e tyre të perspektivës dhe pasqyrimit real të hijes; më vonë ai shndërroi skenat në peizazhe të vendit të tij. Vizioni evropian kurrë nuk e la atë deri në fund të jetës. Hokusai krijoi një seri peizazhesh të frymëzuara dukshëm e në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gravurat evropiane të bakrit, megjithatë tematika dhe stili i ngjyrosjes mbetën mjaft japoneze. Dhe falë origjinalitetit të Hokusai-t, seria e gravurave të malit Fuxhi shënuan kulmin e peizazhit të pavarur japonez.

Kur Japonia hapi dyert ndaj perëndimit pas vitit 1854, gravurat e Hokusai-t dhe të bashkëkohësve të tjerë japonezë mbushën tregjet e artit evropian. Kopje të shumta nga veprat e Hokusai-t u blenë nga Vincent Van Gogh dhe Paul Gauguin dhe modeli i sheshtë i këtyre gravurave të stilit *ukiyo-e, q*ë do të thotë *piktura* të një bote pluskuese, u përdor nga Manet, Whistler, dhe nga artistët impresionistë si Monet, Renoir, Degas, ata të mëvonshmit si Gustav Klimt, e të tjerë. Kënaqësia artistike që shpaloste Hokusai në vogëlsitë dhe thjeshtësinë e jetës së përditshme tërhoqën vëmendjen dhe shërbyen si shtysë për artistët evropianë, duke bërë disa kritikë të mendojnë se modernizmi filloi me Hokusai-n. Dallga e Madhe gjendet tek qielli i veprës *Nat*ë *Me Yje* e Van Gogh, ku shihet spiralja e reve njësoj si ajo e Hokusai, por edhe në piktura të tjera të artistit holandez duke dëshmuar kështu frymëzimin e Van Gogh nga arti japonez. Gjithashtu kjo gravurë frymëzoi edhe Claude Debussy, për të kompozuar simfoninë e njohur, "La Mer" (Deti).

Gravurat e Malit Fuxhi i ofruan botës, e sidomos asaj perëndimore, një përmbledhje të jetës së përditshme të Japonisë, vendit të artistit, shpalosur përmes aspekteve më njerëzore dhe prekëse. Ai shërbeu si një interpretues i natyrës dhe jetës së bukur japoneze. Ai e shtriu në një shkallë më të gjerë forcën dhe fleksibilitetin e gravurave të drurit. Dhe, nga pikëpamja artistike, ai krijoi kompozime me fuqi të jashtëzakonshme që frymëzuan artistët evropianë të cilët tashmë po i shihnin në një këndvështrim të ri forcat elementare të linjave, ritmit dhe hapësirës në pikturë. Hokusai nuk reshti së punuari deri në ditën e vdekjes së tij më 18 prill 1849, duke lënë pas një arsenal prej tridhjetë mijë veprash gjatë karrierës së tij.

Në krye, në të majtë të gravurës është shkruar me kaligrafi japoneze titulli i veprës dhe emri i artistit. Në fakt, Hokusai përdori rreth tridhjetë emra artistikë. Në atë kohë ishte e zakonshme në Japoni që njerëzit të ndryshonin emrat katër apo pesë herë, por Hokusai, i cili nuk lindi me këtë emër, përdori me dhjetëra emra gjatë nëntëdhjetë viteve të jetës së tij. Për të kuptuar edhe më mirë natyrën dhe jetën e artistit duhet përmendur edhe fakti që ai jetoi në rreth nëntëdhjetë shtëpi të ndryshme gjatë jetës. Hokusai ishte gjithnjë në lëvizje, në përpjekje kolosale të vazhdueshme, në kërkim të një arti të përkryer dhe një njohje të thellë të botës, natyrës, hyjnores dhe shpirtit.

Hokusai e kaloi jetën duke studiuar dhe promovuar vlerat njerëzore, si edhe duke eksploruar thellësisht botët natyrore dhe shpirtërore, duke përdorur malin e famshëm vullkanik Fuxhi si një simbol i mbrojtjes dhe i pavdekësisë. Ai përjetoi shumë tragjedi personale, jetoi për vite të tëra në varfëri, por kurrë nuk hoqi dorë nga përpjekjet e tij të vazhdueshme për të arritur përsosmërinë në artin e tij.

Plaku i Çmendur Për Të Pikturuar, ia vuri ai emrin vetes në fund të jetës së tij. Dhe vërtetë ai ishte i tillë. Ai e ndoqi thirrjen e artit çdo ditë të jetës duke iu përkushtuar me të gjithë qenien e tij njohjes së atributeve të artit, fytyrave të tij, e cila përmes kësaj gravure na shpaloset në formën e forcës dhe egërsisë së natyrës. Hokusai ishte i dashuruar me natyrën. Në poezinë e tij të fundit, një haiku në formën tradicionale shtatëmbëdhjetë rrokeshe, ai shkroi:

Edhe si fantazmë
Fryma ime do të dëshirojë të bredhë
Nëpër fushat e verës.

Hokusai ia kushtoi të gjithë jetën artit, dhe i kaloi të gjitha ditët e jetës së tij duke vizatuar e duke mos u rendur pas kënaqësive e qejfeve të zakonshme. Ai ishte njeri i mbyllur dhe as nuk pinte verë as tymoste duhan, siç ishte e zakontë në atë kohë, por vetëm ushqehej sa për të mbajtur frymën gjallë. Gravurat e tij shpalosën një art të mrekullueshëm të lindjes së largët, dhe ato janë dëshmitare sesi Hokusai kishte një talent të lindur për të përshkruar bukurinë e natyrës japoneze, jetën e njerëzve të zakonshëm, historitë, legjendat, besimin, dhe kulturën mahnitëse të Japonisë.

Dallga e Madhe në Kanagawa njihet si *Mosa Lisa* e lindjes së largët, por tek kjo gravurë ne nuk mahnitemi nga buzëqeshja e një gruaje por yshtemi nga buzët e natyrës të shpalosura përmes një dallge sa të frikshme aq edhe të bukur dhe krenare.

Kur njerëzit flasin për Japoninë, mendja u shkon në kulturën e saj të pasur e mahnitëse, tek samurait, geishat, kimonot, sake, dhe padyshim tek *Dallga e Madhe*. Hokusai, falë talentit dhe pasionit të tij për natyrën dhe identitetin japonez, i ka lënë botës si trashëgimi një kryevepër e cila ka shërbyer më së miri ndër shekuj si një urë lidhëse midis kontinenteve dhe skajeve gjeografike të globit, e duke i treguar botës se sa i bukur është arti, dhe se sa mrekullueshëm mund të shpaloset ai përmes çdo kulture, teknike, dhe tematike.

NË BIBLIOTEKË

nga Muç Xhepa

Janar. Ftohtë. Heshtje e trishtë në bibliotekë. Kujtim Bevapi, mik i besuar, nuk është në punë. Në fakt, ai ka ditë që është zhdukur. Ulur te rreshti i mesit, pranë derës, po praktikoj ushtrime me folje frazale. Libri i gramatikës, që ma dha para pak ditësh Kujtimi, s'lejohet të merret në shtëpi. Është kopja e vetme që ka biblioteka. Salla është e shkretuar. Jashtë mbrëmja zbret ngadalë. Errësira futet në korridorin e ngushtë e bashkë me të një kostumgri. Takohet me Havanë, legjendën e bibliotekës. Bisedojnë kokë më kokë. Hedh sytë nga dera dhe i përqendruar vështron përmes xhamave. Largohet dhe vendin e tij e zë një tjetër kostumgri, më i errët. Kokë e trup njësh, fytyrë deformuar. Të fut tmerrin. Qëndron më gjatë me Havanë. Ajo bën me gisht nga salla. "Likantropi – njeriu-ujk" afrohet te xhami i derës. Më sheh përmes tij. Hap derën, shkon në krye të sallës. Ndalon te raftet e mbyllura me çelës. Brenda fjalorë të huaj, të vjetër, relikte të një kohe të artë, e përmbysur tani. Vështron nga ana e murit të porsa lyer me gëlqere. Del jashtë.

Mëngjes pa diell. Kujtimi është kthyer në punë përsëri. Dalim jashtë bibliotekës. Te fundi i shkallëve, në anën e majtë të saj, që shikon nga Banka e Shtetit, më afrohet të më tregojë diçka në besë.

- Mos u duk për ca kohë këtu, - i dridhet zëri. - Po kërkojnë të kapin dikë. As vetë nuk e dinë ç'po bëjnë.

Ndez cigaren, më afron paketën.

- E kam humbur fare, ti nuk e ndez. Po kërkojnë të më çmendin.

Kujtimit i kanë bërë presion. Kanë kërkuar ta thyejnë. Diçka është shkruar kundër "pushtetit popullor" në sallën e bibliotekës. Kanë ditë që janë lëshuar si ujqër për të shqyer viktimën e radhës. Kujtimi mendon se është lojë e tyre.

- Kur duan të godasin, realizojnë planin, tmerrojnë njerëzinë ose rekrutojnë dikë, i kryejnë vetë veprimet dhe mjerë ai që është piketuar.

Mesditë. Fund qershori. Ditë me diell. Bibliotekës i është kthyer jeta. Salla është e mbushur me nxënës dhe studentë. Duhet të vish herët të zësh vend. Ulur te parvazi pa xhama, në të djathtë të hyrjes, bisedoj me Eldën dhe Amardën. Dy vajza të talentuara të shkollës së muzikës, jo vetëm në muzikë, por talente edhe në gjuhë të huaja. Afrohet Aleko Rada. Vajzat largohen. Aleko më tregon me mburrje në ç'mënyrë kishte hapur raftin e fjalorëve dhe kishte rrëmbyer njërin prej tyre, pa u diktuar nga askush. Hap çantën e më tregon fjalorin.

- Vëre përsëri në vend! I duhet të tërëve.

Përpiqem ta bind. Leko qesh dhe këndon vargun "Chi non lavora non fa l'amore". Me zë baritor. Është i apasionuar pas Çelentanos dhe e imiton bukur. Me fytyrë të gjatë, gojë e dhëmbë të mëdhenj, flokët prerë si ai, i duket vetja "Çelentano" i Elbasanit. Fut fjalorin në çantë e ulet në parvaz. Hapet dera e bibliotekës me të kërcitura. Del Havaja e shfytyruar. Më drejtohet me zë të lartë:

- Përse rri me këtë njeri të poshtër? Ky nuk është shoku yt. Unë të njoh ty dhe familjen tënde!

Aleko ngrihet në këmbë dhe i hakërrehet.

- Ik moj bu...!

Bën të zbresë shkallët, por Havaja i del përpara.

- E di çfarë na tha për ty qelbësira? - Havaja më drejtohet përsëri mua. - Muçi ka vjedhur fjalorin e anglishtes!

Aleko shtyn Havanë me çantë dhe duke e sharë me fjalë të ndyra zbret shkallët rrëmbimthi. Nuk e takova më kurrë atë monstër.

Pasdite. Në tryezën e parafundit pranë dritareve lë të hapur metodën e gjermanishtes, librin e dytë, bashkë me lapsin te faqja që po mësoj. Në sallë janë disa studentë në tryezat e para. Jashtë s'ka njeri. Ulem në parvazin te hyrja kryesore; fryn erë dhe i nxehti nuk ndihet shumë. Pas pak kthehem të vazhdoj studimin. Në vendin tim është ulur një kostumgri. Diçka po shkruan në faqen e librit që lashë të hapur. Ai nuk ishte në sallë më parë. Nga dera kryesore nuk hyri. Diku kishte qenë i fshehur. Qëndroj te dera dhe vështroj i tensionuar nga korniza me xham. I pashqetësuar, kostumgriu vazhdon të shkruajë në libër. E njoh: është operativi Sulo "kinezi".

Operativi Sulo ishte një rrondokop, i shëndetshëm, me flokë të zinj, të rënë në ballë, sy të tërhequr, si prej aziatiku; mbahej me të madh. I zbulonte armiqtë sapo t'u shihte shkrimin. Për Sulon tregohej një anekdotë në Elbasan: "Kishte shkuar të zbulonte vjedhësin e një lope në fshatin e parë mbi qytet. Pasi e kishte pyetur tërë fshatin dhe i kishte vënë fshatarët të shkruanin emrat e tyre, Sulo kishte arritur në përfundimin se hajduti nuk ishte nga ai fshat. Mjelësja e lopëve, kur ishte pyetur nga kryetari i kooperativës se për cilin dyshonte të ishte grabitësi, menjëherë i ishte përgjigjur e revoltuar:

- Shoku kryetar, atë nuk e gjeti dot operativi kinez! Nga ta di unë?

Kryetari ishte mërzitur me mjelësen, ndërsa fshati qeshte çdo herë që vidhej diçka në fshat. Kështu, operativit të lartë të Neronit i kishte mbetur nofka "kinezi".

Kur Sulo "kinezi" bën të ngrihet, unë hyj menjëherë. Qesh kur më sheh.

- Çfarë shkruajte në libër? - e pyes dhe i zë rrugën. - Çfarë janë këto numra? - qesh me cinizëm.

Më vështron në sy. Më teston durimin.

- Merre lapsin dhe prishi!

I zgjas lapsin. Kinez, me gomë në fund.

- Ulu, ulu mos bëj zhurmë! Po na dëgjojnë!

Kalon në karrigen tjetër duke më hapur vendin. Studentët kthejnë kokat dhe na ndjekin me kureshtje. Më njohin kush jam, por dinë edhe çfarë është brenda kostumit gri.

- Është targa e makinës së Ramizit, - flet sikur po tregon për shoferin e komunales.

- Cilit Ramiz? - e pyes i nervozuar.

- Sekretarit të Parë, që vjen sot në Elbasan, te pallati "Metalurgu".

- Fshije menjëherë!

Numrat lëtyren, humbasin formë. Sulo "kinezi" heq prangat që ka bërë gati për mua.

Kujtim Bevapi, Bujar Hudhri, Muç Xhepa

MARQUEZ PËRBALLË MARQUEZ

Nga Arta Marku Qëndro



*"Pavarësisht nga natyra e shoqërueshme dhe rehatia në dukje që i jepte jeta publike, babai ishte njeri privat, ndonjëherë edhe i mbyllur [...] P*ërherë dyshonte në të qenët i famshëm dhe në suksesin letrar *[...] Na kujtonte ne dhe vetes, se as Tolstoi, as Prusti apo Borgesi nuk arritën të merrnin çmimin Nobel sikundër edhe tre shkrimtarët e tij të parapëlqyer Virxhinia Vulf, Huan Rulfo dhe Graham Grin. Shpesh i dukej se suksesi i tij nuk ishte diçka që e kish arritur vetë, por* ***diçka që i kishte ndodhur****".*

***

Është babai, shkrimtar i madh njëkohësisht, fat i pak bijve.

Them është, pasi, sadoqë në prill të vitit 2014 u nda nga bota e të gjallëve, vazhdon të jetë në biblioteka e sidomos në duar lexuesish, nëpërmjet librave të tij, historive, personazheve dhe kjo është diçka e pandryshueshme.

Gabriel Garcia Marquez sapo është rishfaqur. Nën titullin "*Lamtumirë Gabo dhe Mercedes*" (botimet Onufri 2021, përkth. Engjëllushe Shqarri), nuk rrëfen ai, si gjithnjë, për personazhet apo veten. Rrëfimi i takon të birit.

Rodrigo Garcia, njëri prej djemve të shkrimtarit, shkruan skenarë, por është kaq e natyrshme që kësaj here t'i kushtohet një tjetër lloj rrëfimi. Një autorrëfim që e vë birin përballë atit. Një rrëfim i nevojshëm, i domosdoshëm. Për rrëfimtarin padyshim. Por sidomos për të tjerët. Sepse "*babai u përkiste shumë edhe njerëzve të tjerë*".

NË TË DY ANËT E VDEKJES

"*Nuk ka gjë më të mirë sesa një gjë e shkruar mirë*" e pat dëgjuar të atin të thoshte. E ka ngulitur fort në kujtesë, paharrueshëm edhe një lloj porosie: *"Nëse jetoni dot pa shkruar, mos shkruani*". Birin nuk e shqetëson ndonjë dilemë sadoqë përballë shkrimit markesjan nuk mundesh veç të ndihesh i vogël. Momenti është special: vdekja në mes. Padyshim ka mundimet e veta ky lloj shkrimi. "*Të shkruash rreth vdekjes së njerëzve të dashur duhet të jetë e vjetër sa vetë shkrimi megjithatë ngasja për ta bërë më krijon një lëmsh në fyt*". Por s'ka rrugë tjetër. Jo vetëm se është dikush që nuk jeton dot pa shkruar. Mbi të gjitha sepse vetë shkrimtari i madh "*një nga gjërat që urrente më së shumti ishte se Vdekja qe e vetmja gjë në jetën e tij për të cilën nuk do të mund të shkruante*". Sigurisht, Vdekja është ajo që gjithnjë e merr situatën në dorë, nuk e lejon njeriun të vendosë përkundër vullnetit të saj. Kush e ka provuar e di mirë. Kësisoj, s'mbetet veç t'i takojë birit ta bëjë teksa është i bindur se i ati do t'ia falë shkrimin.

Shkrimet janë të ndryshme, s'mund të ngjajnë. Jo vetëm se njëri është shkrimtari i madh e tjetri jo. Së pari dallimi qëndron te këndvështrimi: njëri e sheh nga jashtë, tjetri, nëse do të ishte e mundur, do ta shihte së brendshmi. S'ka si të ketë përputhje.

Sidoqoftë rrëfimi ia vlen.

***

"Mëngjesin e një ditëjave të marsit 2014 i telefonoj nënës dhe ajo më thotë se babai ka dy ditë që ka zënë shtratin me rrufë. Nuk është diçka e pazakontë për të por ajo më siguron se kësaj here është ndryshe. "E ka prerë të ngrënët dhe nuk do të çohet. Nuk është vetvetja. Nuk ka fuqi [...] Kësaj here nuk do t'ia hedhim", është prognoza e saj".

Të shkruash për vdekjen është sfidë. Një sfidë, ndoshta, e krahasueshme për nga pesha, me ballafaqimin me të, me luftën me të, me mendimin se *Vdekja* është më e fortë. Ne asnjëherë nuk e perceptojmë apo përjetojmë vdekjen si diçka që na përket mirëfilli. Njëfarësoj njeriu mund ta shohë tek i afrohet vdekjen e tij, por kurrë takimin e njëmendtë. Epikuri nuk i trembej: *nuk do ta takoj kurr*ë, thoshte. *Kur jam un*ë *nuk* ë*shtë ajo. Kur t*ë *jet*ë *ajo, nuk jam m*ë *un*ë. Por këndvështrimi filozofik është tjetër gjë e ballafaqimi në realitet është tjetër. Sidomos është frikësuese vdekja ngase "*rrallëherë qëllon të na zhgënjej*ë" – e di mirë edhe rrëfyesi i lamtumirës së Marquez-it. Sidoqoftë, pasi ajo e ka marrë prenë e saj e është larguar me të, dikush tjetër mund të ulet e të shkruajë mbi çfarë ka parë e përjetuar.

Cila është vlera?

Është e ndryshme nga hera në herë, nga rrëfimi në rrëfim deri edhe varësisht faqes së ndryshme të prizmit përballë të cilit je. Vdekja është "*një ndodhi që nuk vjetërohet kurrë*". Gjithnjë ndryshe, gjithnjë e re, gjithnjë e panjohur sidomos.

Frikën nga vdekja përpiqemi ta mundim nëpërmjet ngulitjes në kujtesë të kohërave kur ajo nuk ishte. Një arsye e rëndësishme për shkrimin, kjo. Për Rodrigon aq sa për të gjithë që shkruajnë, sa herë shkruajnë një rrëfim të ngjashëm me atë të Rodrigos. Lexuesit munden të heqin paralele me veten, me rrëfimet e bëra e ato të pabëra. Me rrëfimet e pezullta që kushedi një ditë, dikush, ndoshta, do t'i bëjë.

Në çdo rast, rrëfimi për vdekjen është i stërpikur me copëza leksionesh jete. U vlejnë të gjithëve, e kujtdo qoftë vdekja. Kur është e Marquez-it akoma më shumë.



PYETJE & PENGJE

"Kur vëllai e regjistron babain në spital administratorja brof nga emocionet sa dëgjon emrin e tij: *"O Zot i madh! Shkrimtari? A ju vlen keq t'i telefonoj kunatës e t'ia them?" Ai i përgjërohet të mos e bëjë dhe ajo pranon me gjysmë zemre. Babain e vënë në një dhomë relativisht të izoluar,* në fund *të korridorit,* për ta mbajtur larg syve të botës por, pa kaluar mirë gjysma e ditës mjekët, infermierët, sanitarët, teknikët, pacientët e tjerë, punëtorë të mirëmbajtjes e të pastrimit, mbase edhe kunata e admin*istratores fillojnë e kalojnë para derës së dhomës së tij për t'i hedhur një sy [...] Gazetarët kanë nisur të grumbullohen jashtë portës kryesore të spitalit... Kjo na e bën të qartë se sëmundja e babait do të jetë pjesërisht çështje publike. Nuk mund ta mbyllim derën plotësisht".*

Jo vetëm nuk mund ta mbyllnin derën plotësisht por do të vinte doemos një kohë kur, përkundrazi, do ta hapnin, me vetëdije. Është fjala për Marquez-in.

Atëherë, cili ishte babai i veshur me mantelin e shkrimtarit të përbotshëm e të gjithëkohshëm?

Si ishte ai përballë djemve dhe gruas?

Si punonte, kur punonte, çfarë zakonesh kishte?

Po manitë, besëtytnitë që shpesh përzihen me ato të personazheve?

Çfarë shkruante e çfarë humbte në pakthim?

Si e gjykonte kohën, ikjen e saj, moshën, pleqërinë që afrohej?

Po pyetjeve të birit si i është përgjigjur?

Po pyetjet që biri kurrë nuk i bëri çfarë pengjesh ngërthejnë në vetvete?

Lexuesve vijojnë t'u përvijohen paralele. Zbulojnë shkrimtarin por edhe diçka nga vetja, aty këtu...

***

Rodrigo e pat pyetur të atin në fund të të gjashtëdhjetave:

-Për çfarë mendon netëve pasi fik dritat?

-Mendoj se pothuaj gjithçka ka marrë fund [...] Një ditë zgjohesh dhe e sheh që je plak. Ja kështu, pa as një paralajmërim. Është *e habitshme.*

Kur mbushi tetëdhjetë vjeç biri ia përsërit pyetjen:

-Po tani si ndihesh?

-Pamja nga të tetëdhjetat është mahnitëse dhe fundi është pranë.

-Të tremb kjo gjë?

-Më trishton pa masë...

Ku ta dish si është pamja nga të tetëdhjetat kur nuk je tetëdhjetë vjeç?

Ku ta dish si do të ndihesh në një moshë që është ende larg?

Çfarë dimë me siguri është e tashmja, ndoshta. Të ardhmen përpiqemi ta përfytyrojmë, ta marrim me mend por me gjasë jemi larg realitetit. Duket sikur pleqëria vjen ngadalë, aq ngadalë qëllimisht që të mësohemi me të. Ata që e arrijnë padyshim janë fatlumët. Por u trishtokan, megjithatë, kur ajo vjen.

Rodrigo flet për mizorinë e pyetjes së tij. Me gjasë, mizore duhet të jetë mungesa e pyetjes. Pa të kujtesës, kujtesës si një pazëll, kish për t'i munguar një gur.

Shkëlqyes po aq sa gjithë të tjerët që të ndihmojnë për ta perceptuar figurën sa më shumë të jetë e mundur, pa hije.

Çfarë është fundi? Si është ai? Se që të mos jetë, është e pamundur.

"*Më vjen keq që nuk i pyeta për shumë hollësi të jetës së tyre, për mendimet më të fshehta për shpresat dhe gjërat që i frikësonin*".

E kush nuk e ka provuar një ndjesi të tillë keqardhjeje, por gjithnjë është vonë për disa pyetje të pabëra. Dhe nuk janë pak. Gjithnjë, nuk janë pak. Rodrigo e dëshmon.

"*Do të doja të dija se si prindërit e mbanin mend veten të rinj ose të kisha ndonjë ide sado të vogël se si e shihnin vendin që kishin në botë dhe kohën kur jetët e tyre ishin të kufizuara në qytetet e fëmijërisë. Çfarë nuk do të jepja për të ndenjur një orë me babain çapkën 9-vjeçar apo me nënën 11-vjeçare, kur nuk kishin si ta përfytyronin jetën e jashtëzakonshme që i priste*".

Pengjet për pyetjet e pabëra fillojnë e përvijohen vetëm pasi vdekja ka kaluar aty pari. Atëherë kur nuk ka më kthim pas. Shkrimi mund të rikuperojë diçka si një fije që lidh njerëz nga dy botët ku gjendet secili: ai që ka ikur e ai që ka mbetur. Është njëfarë terapie, pavarësisht subjektit që ngurtëson në letër. Sikurse për Marquez-in vetë që "*makin*ën *e shkrimit kishte terapinë e tij*". Depërtonte botëve ku mund të hynte vetëm ai. Por jemi te rrëfimi i tjetrit, prej së jashtmi…

LABIRINTE LETËRSIE

"Kur ishim fëmijë nëna na dërgonte ndonjëherë në studion e tij për t'i thënë ndonjë gjë. Ai ndalonte së shkruari dhe kthehej nga ne teksa i përcillnim mesazhin e saj. Na shihte tejpërtej me kapakët e syve gjysmë të mbyllur me një cigare në njërën dorë dhe një tjetër që digjej në tavëll, dhe nuk përgjigjej. Nganjëherë shtoja: më duket se nuk më dëgjove ç'thashë, apo jo? Përsëri nuk merrja përgjigje edhe pasi largohesha vazhdonte të qëndronte në të njëjtin pozicion, me fytyrë nga dera, i përhumbur në labiritin e rrëfimit të tij".

Ndërlikimi i labirintit mund të ketë qenë një arsye pse Marquez-i, lexues i panginjur, nuk i rilexonte kurrë librat e vet. Tashmë jashtë labirintit i trembej rrezikut së gjetjes së të metave gjë që do ta bënte t'i vinte turp. Mund t'ia shkatërronte krijimtarinë. A do të guxonte të përfshihej në një tjetër labirint, tërësisht iracional, sërish?

Gjatë punës, disa labirinte nuk e çonin në degëzime të tjera por para mureve që s'i kapërcente dot. Kthehej pas e dilte jashtë. Thërriste pastaj djemtë që ta dihmonin për të grisur versione të tëra të mëparshme të librave e për t'i hedhur në plehra. Ishte kundër ruajtjes së punëve të pambaruara. Kushedi në ç'labirinte të mundimshme ish endur teksa nuk kish dalë dot matanë.

I rrëfen i biri duke pranuar edhe pjesën racionale. Aty gjendej besimi se disiplina e fortë ishte një nga gurët themeltarë të shkrimit të një romani që mbetej një "*terren i rrezikshëm*". Aty gjendeshin libra autorësh të dashur të cilëve nuk ua mohonte rileximin, gjendeshin fjalorët dhe librat me referenca gjuhësore… "*nuk e pashë kurrë të mos ia dinte kuptimin një fjale në spanjisht*"…

ENIGMAT E PËRJETSHME

Rodrigo Garcia sheh të bijën që ka mbërritur me një tufë trëndafilash të verdhë. Nuk është një zgjedhje e rastësishme e mbesës për gjyshin. Lulet e verdha ishin të preferuarat e tij. I mbante gjithnjë në tryezën e punës. Kurrë nuk ulej të shkruante pa pasur një lule të verdhë. "*Besonte se i sillnin fat*" – pohon i biri. Por tashmë, ç'kuptim ka fati për Marquez-in? Ndoshta e ka një kuptim sepse mundet që vdekja nuk është fundi, kurrsesi një zhdukje. Me gjasë është kalim nga një botë në një tjetër, sadoqë ekzistencën e asaj tjetrës askush, deri më tash, nuk është kthyer të na e zbulojë. Por janë disa shenja të çuditshme, megjithatë:

***

"Vonë atë mëngjes gjetën një zog të ngordhur brenda në shtëpi. Atë që dikur ishte një verandë me pamje nga kopshti, e kishim mbyllur për të krijuar një ambjent për vizita dhe për ngrënie. Muret janë prej xhami kështuqë



mendohet se zogu që ka hyrë *brenda, nuk ka ditur të dalë, është përplasur pas xhamit dhe ka rënë i ngordhur mbi divan, më saktë në vendin ku zakonisht rri babai…"*

Në mesditë, me njoftojnë se "babait i ka pushuar zemra". Ishte e Enjtja e Madhe…

"Pak kohë pasi lajmi i vdekjes së babait u bë publik, sekretarja e tij merr një mail nga një mikeshë me të cilën ka kohë pa folur. Ajo e pyet nëse e dinim *që Ursula Iguaran, një prej personazheve të famshëm të tij po ashtu ka vdekur të Enjten e Madhe. Në mesazhin elektronik ka futur një pjesë nga "100 vjet vetmi" dhe kur e rilexon, sekretarja zbulon se pas vdekjes së Ursulës zogjtë e çorientuar fluturonin nëpër mure dhe binin përtokë të ngordhur…"*

Vetëm Marquez-it mund t'i ndodhë një gjë e tillë? Apo gjithnjë e për gjithkënd ca shenja të çuditshme e të pashpjegueshme fluturojnë rrotull, në ajër? Me gjasë po, veç nuk janë sytë për t'i parë. Realiteti nuk duhet të jetë veç çfarë mundemi të perceptojmë me shqisa. Një shtresë e parë e sipërme, e dukshme dhe e prekshme është e lidhur, me siguri, me njëmijë fije me shtresa e nënshtresa. Ne herë s'e kemi mendjen, herë s'jemi në gjendje t'i dallojmë e të tjera herë harrojmë, harrojmë. Harresën qëllimisht dikush a diçka e ka futur brenda qenies njerëzore për ta bërë të pamundur lidhjen me njëra-tjetrën të fijeve të çuditshme që diçka kishin për të qartësuar. Për ta lënë përjetësisht mbështjellë nga një enigmë, nga ***pakuptueshmëria***. Edhe Marquez-i vetë, nuk mundi të bëjë lidhje mes shtresave e nënshtresave, mes sipërfaqes mbi të cilën jetonte konkretisht dhe nënfaqeve në të cilat endej gjithsesi. Ose ndoshta e ka bërë, por vonë kur nuk mundej më të në na e rrëfente vetë me fjalë të qarta…

Paralelet e lexuesve e pamundur të mos vijojnë të zgjaten faqeve të librit "*Lamtumirë Gabo dhe Mercedes*"…

DASHURIA S'KA SHPJEGIM

Bota është e çuditshme, me fije të padukshme lidh njerëz e përvoja që s'kanë asnjë pikë përkimi mes tyre, mbërritur nga vende e kohë të ndryshme.

Na sot mund të ishim edhe t'panjohun t'vjetër,
Por ka në jetë një shteg që t'lidh përherë
Vetëm me një dhe kurrë me ndonjë tjetër,
Me sy të tillë dhe kurrë jo me të tjerë…

Vargjet që Drago Siliqi i shkroi në Tiranën e gjysmës së parë të shekullit XX, në një formë tjetër i përcjell në fillimshekullin XXI djali i Marquez-it tek vizaton me fjalë siluetën e Mercedesit përballë të shoqit në takimin e fundmë me të:

"Dikur kanë qenë të huaj për njëri-tjetrin, gjë *që tani më duket kaq e paimagjinueshme".*

Shkrimtari i ardhshëm pat qenë 14 vjeç dhe fqinja e tij 10 kur me të qeshur i pat kërkuar të martohej me të duke e bërë të qajë, e trembur. Ishte tepër e vogël. Kushedi çfarë e pat trembur sërish, ditën e martesës që ngurronte ta vishte vellon përpara se të bindej që burri i ardhshëm po e priste te dera e kishës. Pse i paskësh shkuar në mendje rreziku i braktisjes në altar me fustan nusërie?!

Ja tek është tani, 57 vjet e 27 ditë më pas, përballë trupit të të shoqit. "*E vështron në fytyrë, i përkëdhel ballin dhe për një çast është e padepërtueshme*". Pak orë më pas, pavarësisht nga gjithçka, ajo është e lumtur. Kur gjatë ceremonisë presidenti i Meksikës i drejtohet me fjalën *Vejusha* ajo reagon: *No soy la viuda. Yo soy yo (Nuk jam vejusha. Unë jam unë)* – thotë nën zë.

I ka takuar asaj fati që i shoqi TË JETË, përjetësisht. Kanë qenë bashkë për më shumë së gjysmë shekulli. Gjashtë vjet më pas, sërish bashkë do të jenë. Deri atëherë ka vendosur, ndoshta ngase nuk bën dot ndryshe, "*të mos falë askënd që nuk i telefonoi më babait pasi humbi aftësitë qoftë edhe për ta përshëndetur. Lista e të këqinjve është e shkurtër, por po të jesh në të, të ndihtë perëndia*".

Nuk e njeh të tillë tolerancë një histori e madhe dashurie.

EPILOG

"…Çdo pasdreke prindërit merrnin një sy gjumë. Babai na porosiste ta zgjonim nëse kalonte një farë ore […] Po t'i rrije pranë apo ta shtyje pak kur e zgjoje, ai trembej aq shumë sa zgjohej duke bërtitur dhe duke tundur krahët sikur donte të mbrohej nga diçka apo dikush, i tmerruar duke gulçuar. I duheshin disa çaste derisa të kthehej në botë…

Detaje të pazakonshme pranë një babai të jashtëzakonshëm që birit i takon t'i rrëfejë. Asnjëherë deri në fund, ama. Se fundi është i padallueshëm.

"*Njeriu ka tri jetë* – paskësh thënë Gabriel Garcia Marquez – *publiken, privaten dhe të fshehtën*".

E fshehta mbetet përjetësisht e tillë. Madje edhe për njerëz që jetojnë në të njëjtën hapësirë të përbashkët. Se "*Shtëpia është një vend i ndryshëm* për secilin nga pjesëtarët e saj".

Ndaj kurrë pamja nuk mund të jetë tërësisht e plotë. Disa gurë mozaikut do t'i mungojnë gjithnjë. Sa më i vjetër të jetë e sa më madhështor, aq më shumë gurë kanë për t'i munguar, por nuk e turbullojnë pamjen…

Maša Kolanović:

ËSHTË MË E LEHTË TË PËRFYTYROSH FUNDIN E BOTËS SESA FUNDIN E KAPITALIZMIT

Bisedoi Andreja Pançur

Telefoni celular është shndërruar në zgjatim të trupit tonë, nëse mbetemi dy sekonda pa atë, të gjithëve na zë paniku dhe e kërkojmë, sikurse po kërkojmë gishtin ose hundën që na zhduket nga ndonjë çudi. Është drithëruese kur e mendon sesa aparati celular është bërë pjesë e jona, vazhdim i trupit tonë. Që të mos keqkuptohemi, edhe unë e përdor celularin, më lehtëson shumë në disa gjëra në jetë, por shpesh edhe më ngarkon. Nuk jam tip i rrjeteve shoqërore. Ia ngulim sytë atyre ekraneve dhe nuk vështrojmë më fytyrat që na rrethojnë.

Vëllimi me tregime "Pafundësi" vitin e kaluar fitoi çmimin e kritikës dhe atë të publikut, gjithashtu kjo prozë ngjethësisht reale u nderua edhe me çmimin e publikut në Panairin e librit në Pula. Me këtë rast për librin, por edhe në përgjithësi për situatën në shoqëri, biseduam me këtë autore të cilën e vendosin në majën e letërsisë bashkëkohore.

Gjithçka në këtë libër, nëse ndokush nuk është njohur ende me opusin tuaj, sugjeron se bëhet fjalë për një përzierje të Lovencraftit dhe Tim Burtonit duke iu shtuar Kafkën. Por përbrenda, në formën e 12 tregimeve, na pret një ngjethje e veçantë- ajo për të cilën përditë mbyllim sytë dhe e cila nuk gjendet nën krevat apo në dollap. Këta janë brumbujt, gjë që është këtu ngjethëse? Ku arritën, si puna e kockave në titull, te gjejnë edhe Konsum-in?

Brumbujt në librin tim janë metaforë e brishtësisë, tjetërsimit dhe thyeshmërisë së ndërtuar në gjurmët e Kafkës, në mënyrë të veçantë të "Metamorfozës" së tij e cila mund të lexohet edhe si metaforë ekzistenciale e të qënit njeri në kapitalizëm. Gregor Samsi është tregtar shëtitës, lexojmë mbi refleksin e stresit dhe stërlodhjes që ndjek punën e tij, ndërsa për familjen e tij, pasiqë shndërrohet në brumbull, ai bëhet i tepërt. Padobia ekonomike e Gregorit asgjëson kuptimin e ekzistencës së tij. Ai vetë është pasiv dhe nuk ka mundësinë e artikulimit të të folurit. Personazhet rreth tij nuk kanë empati, janë të ashpër me pragmatizmin e tyre, por njëkohësisht edhe ëndërrimtarë pjellorë për jetën më të mirë dhe më të bukur dhe, nga ana tjetër, kanë vetëm "synime të mira". Gjithçka që përbën pjesën fantastike te Kafka më është bërë e afërt nëpërmjet përjetimit të realitetit tonë në të cilin kapitalizmi i shndërron njerëzit në brumbuj që mund të shtypen sapo të shfaqet rasti për një gjë të këtillë. Nga qytetari, punëtori, fshatari dhe inteligjenca e ndershme ose thjesht nga njerëz, kemi rënë në nivelin e blerësve dhe konsumatorëve, sikurse edhe neve na drejtohen në mënyrë dominuese në të folmen publike. Në tregime konsumi shfaqet si lejtmotiv i tmerrshëm i cili "strukturës së ndjesive" të përgjithshme i jep një notë të lehtë. Nga fjala kroate për supermarketin sikurse shpallet nëpër reklama për këtë zinxhir tregtar aferash korruptive, deri te dëshpërimi dhe rrënimi, pasojat e të cilëve goditën më shumë punëtorët e brishtë dhe të pambrojtur, më së shpeshti punëtoret.

Sa e vështirë është të ndërgjegjësohesh se kapitalizmi dhe dëshira për materialen na ushqen dhe njëkohësisht na gërryen nga brenda? A ka mundësi që vetëdija për këtë të lidhet përshembull me të gjithë ngjarjet për vetëdijen mbi ndryshimet klimatike? A po shkojmë drejt asaj që ta kuptojmë se e kemi tepruar me konsumizmin apo jemi një rast i pashpresë?

Është e njohur dhe cituar shpesh fraza e teoricionit marksist Frederik Xhejmson se është më e lehtë ta përfytyrosh fundin e botës sesa fundin e kapitalizmit. Kapitalizmi, madje edhe në kuptimin kulturor, është koncept kompleks dhe shumështresor për të cilin janë shkruar rafte të tërë me libra. Kapitalizmit është e vështirë t'i kundërvihesh ose t'i "largohesh" sepse ai na shkatërron si njerëz ndërsa njëkohësisht i kënaq instinktet tona më të ulëta. Ka gjithashtu prirjen që bashkësinë, solidaritetin dhe "masën kritike" ta shpërbëjë në atome individësh pragmatikë dhe të palidhur me njëri-tjetrin. Për disa kapitalizmi është konsumizmi gjithëpërfshirës pa gërryerje të ndërgjegjes, për disa të tjerë ai është jetë në kufinjtë e ekzistencës. Përkundër gjithë këtyre, besoj te refleksioni kritik që ndërtohet me themel dhe dinjitet. Besoj se shumë individë të këtillë mund të bashkohen në atë masën kritike me efektshmëri politike. Ndryshimet klimatike në fund të fundit u përkasin të gjithëve.

Për çfarë arsyeje në librin "Pafundësi" është shfaqur edhe amësia, kjo kategori e "shenjtë" mbi problemet reale të së cilës flitet, nëse në përgjithësi flitet, sikur të jetë një temë tabù? Përse nuk është diçka dinjitoze të flitet për këtë temë? Përse fëmijët në libër paraqiten sikur janë viruse ose parazitë nga të cilët është e vështirë të largohesh?

Për këtë tregim kam vendosur sepse shoqëria shumë rrallë njeh dhe pranon tërë barrën e amësisë, për këtë nuk është dinjitoze të flitet publikisht, mbështetet vetëm versioni i ideales. Nga ana tjetër, gratë flasin mes tyre për

gjëra të këtilla, e kuptojnë njëra-tjetrën në lidhje me problemin e lodhjes dhe superngarkesës në punën e stërmadhe emocionale dhe fizike e cila, edhe përkundër gjithë parullave për barazinë, megjithatë bie mbi shpatullat e grave ose sëpaku shumicës prej tyre. Me këtë tregim desha të ndërpres qarkun e vetëmjaftueshëm të komunikimit. Ndoshta figurat e fëmijëve këtu duken si njëfarë "dëmi kolateral", por ata duhen kontekstualizuar në naracionin e vetë tregimit në mënyrë që të shihet se ata jo rrallë dalin nga perspektiva e heroinave të tregimit të cilat janë tejet të lodhura dhe jo rrallë nuk kuptohen sa duhet si "fuqia punëtore e papaguar dhe më e ngarkuar me punë" në këtë botë.

Edhe përkundër faktit se shumë veta thonë se aparatet celularë po na tëhuajsojnë, ju, në një mënyrë specifike dhe rrënqethëse, i ngjitni me thelbin e individit, dhe me të cilët lidhemi kaq shumë dhe në mënyrë të pashëndetshme saqë duhen marrë me vete edhe në varr. Si i konsideroni këto pajisje kur shihni sesa është dehumanizuar shoqëria, a mos aparati celular, mjeti më i madh kapitalist që arriti të ndryshojë karakterin tonë, të "dounludohet" sëbashku me identitetin tonë? A vjen në ndihmë ndonjëfarë "detoksifikimi" për të cilin dëshirojmë të flasim të gjithë?

Në gjurmët e metaforës së shndërrimeve që na kanë ndodhur me hipjen në fron të kapitalizmit, aparatin celular e konsideroj si pjesë e këtij shndërrimi në shoqërinë e konsumit. Telefoni celular është shndërruar në zgjatim të trupit tonë, nëse mbetemi dy sekonda pa atë të gjithëve na zë paniku dhe e kërkojmë, sikurse po kërkojmë gishtin ose hundën që na zhduket nga ndonjë çudi. Është drithëruese kur e mendon sesa aparati celular është bërë pjesë e jona, vazhdim i trupit tonë. Që të mos keqkuptohemi, edhe unë e përdor celularin, më lehtëson shumë në disa gjëra në jetë, por shpesh edhe më ngarkon. Nuk jam tip i rrjeteve shoqërore. Ia ngulim sytë atyre ekraneve dhe nuk vështrojmë më fytyrat që na rrethojnë. Me aparatin celular komunikojmë në mënyrë më të pranueshme me të tjerët, por ka ndodhur inflacioni i komunikimit dhe kemi humbur ndjesinë e tjetrit nëpërmjet kontaktit direkt. Në këtë kuptim jam skeptike dhe ndaj idesë se detoksifikimit. Detoksifikimi qëndron te vetëdijësimi, dhe jo t'i kthehemi rutinës së vjetër të vartësisë. E kemi lënë veten të biem robër dhe kjo në njëfarë kuptimi na pëlqen, për këtë, edhe për shumë të tjera, themi se është më e lehtë ta mendosh fundin e botës sesa fundin e kapitalizmit.

Kur flasim për detoksifikuesit, kohët e fundit shumë këshillojnë "vëzhgimin përreth vetvetes", shkëputjen nga gjërat materiale dhe natyrisht, orientimin për blerjen e mallrave *gluten free, paraben free, alkool free*. A është ndjesia që të ndahemi nga vartësia prej kapitalizmit dhe uljes së çmimeve pikërisht një truk tjetër kapitalist? A bëjnë pjesë këtu edhe orvatjet, shpresat e pashpresë për "një të nesërme më të mirë", elementët e së cilës shihen edhe në librin tuaj?

Më shumë i shoh këto si një truk kapitalist, prirje që po shitet mjaft mirë. Mendoj se ndryshimi autentik nuk do të vijë vetëm nëpërmjet ndryshimin të zakoneve të konsumit. Duhet shumë më tepër se kaq.

Keni prekur edhe temën e ustashizmit, ose si të thuash, ajo të bie në sy në tregimet tuaja. Duke patur parasysh se "e dimë" se fashizmi si i tillë është rrënqethës, në ndryshim nga disa motive të tjera që keni prekur, a mund të na shpjegoni përse ai thjesht u dashka të gjendej, dhe në këtë mënyrë, në përditëshmërinë e personazheve?

Tregimet janë vendosur (në kohë) në të përditshmen recente kroate, në të cilën problemi i ustashizmit është larg të zgjidhurit. Ustashizmi na është bërë deridiku i zbutur dhe i pranuar në heshtje. Është ngjethës fakti sesa simbolet ustashe (*e famshmja germa "U" në tregimin "Jetë më e mirë"-shën. im Xh.F.)* janë bërë triviale dhe të përditshme. Në to shihet tipikisht ajo "e keqja banale" kroate. Njerëzit as që i shokon fakti se fëmijët e tyre gjithë gëzim lëshohen teposhtë në rrëshqitëset ku janë gdhendur kryqi i thyer dhe germa "U". Ngjethja shpërthen pikërisht nga pranimi shpirtvogël dhe jokonfliktual dhe sëbashku me këtë edhe minorizimi i krimeve të tmerrshme që fshihen pas këtyre simboleve.

Në një intervistë keni thënë se për të shkruar këtë vepër ju ka animuar nipi juaj pasiqë dëgjoi dhe përceptoi në mënyrë të gabuar lajmin në qendrën tregtare. Po ashtu, te "Liria e Barbit" (Slloboshtina Barbie)-Barbi nga bota e saj "plastike fantastike" krijon këndin e saj të vogël, me prapaskenë tingujt e lajmeve nga fusha e betejës. Si e konsideroni botën e fëmijëve brenda botën ngjethëse të insekteve?

Po, nipi im, atëbotë me kulturë konsumiste me fantazi të paprishur, me rastin e një vizite në një *shopping center* në atë lajmërimin për të gjithë që emetohet nga altoparlantët me zë të këndshëm në vend të frazës "blerës të nderuar" (në kroatisht: "poshtovani ku***p***ci") dëgjoi "brumbuj të nderuar" (në kroatisht: "poshtovani ku***k***ci"), gjë që për mua ishte një moment epifanik me të cilin m'u hap ajo e çara me shikimin mbi botën siç është formësuar në libër. Nipit tim ia detyroj këtë asociacion. Fëmijët në përgjithësi me shikimin e tyre vërtetë të sinqertë mbi botën janë frymëzim i madh për mua, as ata vetë nuk janë të vetëdijshëm sesa i ndriçojnë të çarat e të rriturve. Por gjithashtu vëzhgoj sesi fantazia e tyre madhështore shumë shpejt kolonizohet dhe thahet nga sistemi, konsumizmi dhe forma të tjera të hegjemonisë. Fëmijët, sipas statisatikave, konsiderohen si konsumatorë dhe për këtë shumë të brishtë dhe pothuajse aktorë të pandihmë në arenën e egër të konsumizmit, gjë që aludohet edhe në titullin e këtij tregimi.

Nga "Jamerika", deri te "Liria e Barbit", e më tej deri te "Brumbuj të nderuar", stili juaj pak a shumë ndryshon, arranzhimi i tekstit pasurohet, madje herë herë shtoni edhe vizatime. Si ju duket procesi i "lëmimit" të stilit, sa ndikon në qëndisjen e tekstit puna juaj e përditëshme në Departamentin për kroatistikë dhe diploma për letërsi komparative?

Zakonisht shkruaj në pushimin mes dy punimeve shkencore ose gjysëm kohëshet administrative të punës me të cilën merrem, shkruaj margjinat që hapen në këtë ndërhapësirë. Letërsia dhe të marrurit shkencërisht me letërsinë janë ngushtësisht të lidhura te unë dhe, pa shikimin që kam ndër "të dyja anët", as letërsia ime dhe as puna ime shkencore nuk do të ishin të njëjtat. Te unë gjërat lindin zakonisht në njëfarë gjendje ethesh fillestare, ku më përndjek dëshira dhe nevoja për t'i dhënë formë diçkaje, hedh ndonjë ide në letër në formë lënde të parë, skicoj ilustrime në vija të baqarta. Kur e ashtuquajtura temperaturë bie, atëherë i futem punës delikate të lëmimit dhe luçidimit.

A ekziston ideja mbi ndonjë libër të ri, mbi ndonjëfarë "shikimi" të ri mbi botën, apo ideja varet nga cili këndvështrim shikoni? Dhe në fund, mendoj se gjithsesi këtë duhet ta shkruani, por diku kam lexuar se Miljenko Jergoviçi në recensionin e tij ka shkruar se ju "jeni e detyruar" të shkruani. A jeni dakord me të dhe cili është qëndrimi juaj në lidhje me dëshirën për të shkruar?

Për momentin jam në sferën e shkencës e kësisoj personi im letrar është në hibernim. Mendoj se të shkruarit ka kuptim vetëm nëse pikërisht vjen nga dëshira e cila, me kalimin e kohës, bëhet imponim, dhe jo nga mbajtja e njëfarë "forme fizike" të imazhit publik të shkrimtarit. Shkrimtari bëhet përsëri nga fillimi i tillë me shkrimin e çdo teksti të ri.

Përktheu Xhelal Fejza



RRËFENJA AMERIKANE

BASHKËBISEDIME ME HISTORIANË TË SHQUAR

David McCullough rreth John Adams-it
Jon Meacham rreth Thomas Jefferson-it
Ron Chernow rreth Alexander Hamilton-it
Doris Kearns Goodwin rreth Abraham Lincoln-it
Taylor Branch rreth Martin Luther King Jr.
Robert A. Caro rreth Lyndon B. Johnson-it
dhe më shumë

DAVID M. RUBENSTEIN

Minerva